

Ekskluzivisht për www.pashtriku.org romani më i ri Adem Demaçit



A L B P R O M E T E U

&



Adem Demaçi

R o m a n

IMAGJINATA ËSHTË IMJA
REALITETI ËSHTË JUAJI
AUTORI

Fisi i Prometejve gjatë mijëvjeçarëve u rrudh, u tkurr e u zvogëlua fort, por megjithatë nuk u zhduk kurrë nga faqja e dheut. Në hapësirën e Albërisë, në ditët tona, mbetën Albi me pak shokë që ta vazhdojnë farën e veprën e tyre...

Më dhjetë shkurt dy mijë e shtatë ndodhi hataja. Në qendër të Dardanisë, Alb Prometeu bashkë me vulgun u ngritën në këmbë dhe kërkuan liri, pavarësi, drejtësi e barazi për të gjithë e jo vetëm për perënditë! Mirëpo, shërbëtorët e perëndive u tërbuan dhe në tërbim e sipër, humbën kontrollin dhe vranë dy engjëj-rinosh e plagosën njëqind të tjerë. Ulpiana, kryeqendra e Dardanisë u mbulua e u mbyt me helme e gazra lotsjellës...

Vula e gjakut në Dardani mbeti e pashlyer. Perënditë dhanë urdhër dhe dallkaukët e tyre u munduan, shpejt e shpejt, me dinakëri e dallavere të shlyenin gjakun e derdhur të vulgut, por vetëm sa e zhallavatën dhe e zgjeruan edhe më shumë...

...njëmbëdhjetë perënditë e kohës u mblodhën urgjentisht...

Dikur, në kohët e lashta, perënditë kishin emra kuptimi, ndërsa në ditët e sotme shumë syresh kanë emra kafshësh tokësore, ujore e ajrore. Mos u habitni për këtë dukuri, që sot, jo rrallë; edhe perënditë duan të mbështillen me lëkurat e kafshëve...

...takimi i valë në sallën ovale...

Salla ovale shkëlqente, por atmosfera ishte fort e zymtë dhe e tendosur. Po prisnin Kulshedrën, por ai sikur po vonohej. Gjeli me Diellin flisnin me njëri-tjetrin me zë fort të ulët. Luani, Elefanti, Latini, Majacteku e Keopsi vetëm ngërthenin vetullat, ndërsa Hunja rrinte e vetmuar duke shikuar në një pikë para vetes. Të gjithë flisnin vetëm me sy. Të pllakosur nga kjo gjendje tepër e padurueshme, Balena me Ariun sikur nisën të buzëqeshnin me zor, për të zbutur tendosjen e padurueshme, mirëpo krejt kjo ishte pordhë e ftohtë... Kolltuku i Kulshedrës ende qëndronte i zbrazët. Më në fund u duk edhe Kulshedra. Ishte i mërrolur dhe i thartë. Të gjithë u ngritën në këmbë pa e pasur të qartë përse u ngritën. Ai, shkoi e u ul në kolltukun e vet në krahun e majtë të Balenës, pa thënë asnjë fjalë të vetme.

...fjala e balenës...

Balena, me fjalë fort të zgjedhura përshëndeti të pranishmit. Kërkoi ndjesë për këtë takim tepër të ngutshëm që ishte në frymën e marrëveshjes interne midis perëndive që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore.

Balena dha një raport të shkurtër për atë që kishte ndodhur në Dardani dhe vazhdoi fjalën e vet me një si përmbyllje autokritike:

- Zoti nuk na ka autorizuar të vrasim njerëz që në mënyrë paqësore kërkojnë liri, pavarësi, drejtësi e barazi...Mirëpo, po mendoj me zë para jush që të më dëgjoni të gjithë dhe nëse nuk kam të drejtë në këtë mendim timin të më kundërshtoni, natyrisht, me argumente. Po më duket disi sikur neve, atje në terrenet tona, në strukturat tona politike, ekonomike, policore e informative na janë infiltruar si shumë individë, që nuk po e kuptojnë si duhet e sa duhet qeverisjen tonë, po e përsëris edhe një herë, qeverisjen tonë shpëtimtare me turmat. Këta individë të cilët kanë filluar të shumëzohen si shumë, në detyrat e veta transmittuese sikur po bëhen,

si i thonë asaj fjale, më katolikë se Papa. Si transmituesit tanë, ata janë pasuruar shumë shpejt dhe çfarë është edhe më keq edhe apetiti i tyre për të grumbulluar, me rrugë e pa rrugë edhe më shumë pasuri ka marrë hov të tepruar. Ata, si po më duket, nga frika se mund të humbasin pozicionet e tyre të privilegjuara po i japin vetes kompetenca më të mëdha se që kanë, mund t'i kenë e duhet t'i kenë shërbëtorët.. Ata, aq fort po nxehen në krye saqë po i shkelin rregullat tona të lojës të cilat i kemi caktuar e, me mundime të mëdha i kemi përligjur për turmat. Ne, urgjentisht duhet të bëjmë diçka fort serioze në mënyrë që situata të mos na dalë nga kontrolli...

Balena u ndal paksa. Dhe këtë interval të shkurtër Ariu e shfrytëzoi e tha me cinizëm:

- Paj, ju Balenajt, meqë keni pasur dhe po keni para më shumë, gjithmonë e, edhe sot po i bleni e po i korruptoni shërbëtorët tuaj atje në terren...

- Mos, vallë, vetëm ne e ju jo!?- tha Balena si i përvëlur.

- Paj, edhe ne edhe ne, mirëpo ju pak si më shumë. – tha Ariu duke u qaraveshur si në gaz dhe shtoi me zë serioz:- Pastaj, ne këtu mund të flasim çfarë të duam, por e vërteta është se ata vazalistët, ose transmituesit si i quani Ju, janë nën pushtetin e plotë të administratës që, në emër të OKB-së keni dërguar ju atje. Ju, mos u mundoni të shfajësoheni dhe të hidhni fajin mbi ata që janë vartës atje. Paj, tek e fundit dihet shumë mirë e shumë qartë se kush e ka fjalën e fundit atje dhe cilët janë bartësit e katër shtyllave kryesore pushtetore atje. Ne, po them prapë, mund të flasim çfarë të duam, por e vërteta është se asgjë atje nuk mund të bëhet pa dijen dhe pa pajtimin e organeve policore që janë nën urdhrat e UNMIK-ut dhe të KFOR-it. Apo jam gabim? Paj, më falni, ë, mirëpo ju e dini fare mirë se çfarë përfshin në vetvete rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit...

Në vend të përgjigjes një heshtje djegëse. Ariu, i trimëruar vazhdoi edhe më me guxim:

- Pastaj, të them të drejtën, unë nuk e kam aspak të qartë çfarë na u desh fare ky takim. Përse u jepni rëndësinë që nuk e kanë këtyre ngjarjeve dhe përse ua rritni marrëditjet atyre albërezëve primitivë, në një kafshatë Dardani, atje në Ballkan?

Elefanti, ngriti surlënën e tha:

- Ndoshta ne, atje në atdheun tim jemi edukuar dhe edukohemi në frymën e tolerancës e të respektit të ndërsjellë pavarësisht nga madhësia e popujve, prandaj mua sikur më vranë fort veshin fjalët plot përbuzje, mospërfillje e nënçmim ndaj albërezëve, një popull vërtet i vogël në numër, por me një histori fort të lashtë e të pasur. Dmth. nofkat “PERËNDITË E DHUNËS E TË PARAS”, me të cilat na prozhmojnë turmat nëpër botë nuk qenkan të pabazuara diku. Tash e kam më të qartë përse juve, atje nuk ju duan popujt e vegjël dhe përse ata ngrihen edhe në

kryengritje kundër jush. Tash e kuptoj çfarë ju lidhka juve me regjimin serb i cili bëri tërë ato mizori gjithandej Ballkanit...

- Ah, or zotëri! – thirri Ariu me njëfarë dëshpërimi të shtirur e shtoi: - Nuk i njihni ju as albërezët, as çeçenët, as tatarët, as çerkezët, as gjeorgjianët, prandaj flisni kështu. Ata dhe të tjerët si ata njohin dhe mund të frenohen vetëm me anë të frikës. Ata nuk bëhen zap ndryshe...

- Çfarë prepotence, çfarë vulgariteti, çfarë vrazhdësie! – thirri Majacteku, pa marrë leje për të folur, - e shtoi – Me politika të këtilla ne nuk do të mund të vazhdojmë gjatë me pushtetet tona mbi turmat...

...ndërhyrja e luani...

- Ka ndodhur gabim fort i madh! – ndërhyri Luani me nxitim që të ndërpriste nxehtjen e mëtejshme të gjakrave. – Ne, këtu, këta që jemi e kështu si jemi, shihemi e njihemi, disa me shekuj e disa me dhjetëra vjet, jemi sikur lisat e malit në shpat të bjeshkës, me rrënjë të ngulura në Tokë e me kurorat që fugojnë gjithnjë e më lart drejt rrezeve të Diellit. Çdonjëri nga lisat mundohet që rrënjët e veta t'i shpjerë sa më thellë e sa më gjerë në tokë, kurse kurorën ta çojë lart e më lart drejt Diellit. Toka jonë janë turmat që pa to nuk bën, mirëpo që edhe ato pa ne shumë shpejt do të shndërroheshin në plëngprishës, në kriminelë të shfrenuar dhe do ta shndërronin botën në një kaos anarkist ku nuk do ta njihje as qeni të zonë! Dielli është liria jonë e plotë e veprimit, është e drejta jonë e plotë për të qeverisur me turmat, sepse pa ne ato do të mbeteshin si mizat pa kokë dhe shumë shpejt botën do ta bënin hi e pluhur! Ne, këta që jemi e kështu si jemi, ia kemi njohur njëri-tjetrit këto të drejta. – Luani ua hodhi të gjithëve një shikim fort domethënës e vazhdoi. – Ne, ia kemi njohur njëri-tjetrit këto të drejta, sepse sa herë që gjatë historisë së njerëzimit ia kemi mohuar njëri-tjetrit këto të drejta si pasojë jemi përleshur midis nesh dhe në fund ne kemi mbetur të humbur, kurse në të vërtetë kanë përfituar turmat e verbuara nga lakmitë e babëzitetë e shfrenuara. Ndërkaq, ne na janë zvogëluar liritë dhe të drejtat e qeverisjes mbi to. Apo s'është kështu? – pyeti Luani dhe partnerëve të vet ua hodhi edhe një shikim panoramik. Të gjithë, vetëm ulën kokat në shenjë pohimi. – Luani vazhdoi.- E gjithë historia e njerëzimit, prej se u krijuan shtetet e para e deri në përplasjen e fundit gjatë Luftës së Dytë Botërore është përplot me luftëra të tmerrshme e të përgjakshme të cilat i udhëhoqën të parët tanë nga fisi i perëndive. A ka dikush nga ne që dëshiron të harrojmë leksionet e panumërta e të hidhura që kemi marrë deri më sot? A ka DIKUSH PREJ NESH dëshirë që ta kthejmë prapa rrotën e historisë dhe, falë armëve e mjeteve të hatashme që disponojmë sot, të bëhemi hi e pluhur e definitivisht si ne perënditë, si turmat të zhdukemi nga faqja e dheut?!...

Të njëmbëdhjetë perënditë mbetën të heshtura. Pas një copë here të gjatë e të ethshme, Gjeli çoi kokën lart e pyeti?

- E, ç'të bëjmë, pra?

- E, kjo është pyetja mbi të gjitha pyetjet! – tha Latini e vazhdoi. – Ne po hyjmë në një fazë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në të cilën dita-ditës po bëhet më i vështirë sundimi ynë mbi turmat. Derisa para disa vjetësh e andej, ne, me një gisht zinin dhjetë pleshta, disa vjet e këndeje as me dhjetë gishta nuk po e zëmë dot vetëm një plesht!...

- Duhet, domosdo, patjetër, gjithsesi, deshëm s'deshëm, të merremi vesh midis nesh dhe ta vazhdojmë më tutje qeverisjen me turmat. – ndërhyri Elefanti.

- Tjetër shteg e tjetër rrugë nuk ka! – foli Hunja për herë të parë.

- Gjithë fajin e kanë prometejt që tradhtuan perënditë dhe u vunë në shërbim të turmave.-tha Ariu.

- Fajin e kemi ne që gjithmonë fisin e prometejve e keqtrajtuam dhe e mbajtëm larg vetes. – tha Hunja.

- Fajin sikur e kanë ata vetë që nuk deshën të shijonin të mirat e bukuritë e jetës... – tha Latini.

Fjalët e Latinit ishin fort cytëse për të qeshur, mirëpo atmosfera ishte tepër e zymtë për ta bërë një gjë të tillë...

...thirrje për pajtim me prometejt...

-Prometejt janë fis i zgjedhur i Zotit dhe me këto vrasje në Dardani ne kemi hyrë në rrugë pa krye. - tha Dielli e vazhdoi. – Ne duhet patjetër, domosdo e gjithsesi të gjejmë mënyrën e rrugën e pajtimit me ta sa nuk është bërë tepër vonë për ne...

- Ne, kemi inauguruar vetë të drejtën e turmës që të kërkojë gjithçka me mjete paqësore e tani, kemi rënë në kundërshtim të mprehtë me qëndrimet tona, me rregullat e me ligjet që kemi nxjerrë ne vetë...-tha Elefanti dhe ngriti surlen përpjetë.

- Paj, mos vallë, po doni të thoni që ne tani u dashka ta fajësojmë veten tonë?! – tha Ariu duke shtrënguar dhëmbët.

Asnjëri nga perënditë nuk tha gjë. Ariu, i trimëruar nga heshtja e të tjerëve, vazhdoi:

- Nëse, ne, turmave ua japim ato që kërkojnë: lirinë, pavarësinë, të drejtat e barazinë, atëherë, ju pyes juve, të nderuar, çfarë do të mbetet për ne?

Të gjithë ulën kokat përveç Kulshedrës. Të gjithë pritën që ai të thoshte një fjalë, por ai vazhdoi me heshtjen e vet duke mbajtur kokën lart. Ariu foli prapë:

- Ta prangosim Albin, ta fajësojmë Albin sa nuk është zgjuar turma kundër nesh!

- Ta fajësojmë e ta prangosim - tha Latini se përndryshe na mori lumi dhe ramë të gjithë përtokë!

Të gjithë ia hapën sytë njëri-tjetrit përveç Kulshedrës, i cili vetëm rrudhi vetullat e tha me zë të prajshëm:

- Të gjithë mund t'i mashtrujmë e manipulujmë, por vetëm të VËRTETËN E DREJTËSINË – jo!...

Sallën ovale e pushtoi një heshtje plumbi. Pas një pritjeje rrëqethëse foli Majacteku:

- Fjalët që tha Kulshedra janë të vërteta dhe me vend, mirëpo ne nuk mund të qëndrojmë në një vend se do të rrëzohemi, prandaj duhet të bëjmë diçka. Sa për fillim, po e prangosim Albin, por nuk po ngutemi me dënimin. Po shkojmë të gjithë, një nga një e po flasim me të dhe po përpiqemi ta bindim që të bëhet me ne...

- Që të kthehet te ne, sepse ai yni është, por ka humbur rrugën. – tha Keopsi duke matur të tjerët me sy e vazhdoi: - Unë desha të ju marr pak kohë duke shtruar disa mendime që janë fryt i gabimeve dhe pësimeve të arabëve në konfliktin, që ende po zgjat me izraelitët. Edhe Izraeli ishte fare i vogël kur ne arabët e hëngrëm në sy dhe, historia e provoi, u pozicionuam fort gabimisht ndaj këtij populli dhe ndaj vetes sonë. Sikur ne të mos ushqenim urrejtje e mospërfillje ndaj këtij populli vërtet të vogël në numër, po me histori të lashtë e të bujshme, me cilësi të larta e me kulturë të rrallë, ne, si komb arab, nuk do të dëmtoheshim kaq shumë në historinë tonë më të re. Prandaj, ju thërras, zotërinj të nderuar, që të mos nënçmojmë e të mos përbuzim popullin e vogël albërez sepse mund të na hapet edhe një vatër e padëshiruar dhe e pashërueshme lehtë mu në qendër të Ballkanit. Ne, e njohim shumë mirë popullin albërez, sepse çdo i shtati qytetar i shtetit tim është me prejardhje albëreze. Ata janë një popull fort vital dhe shumë lirisdashës. Pastaj, më falni që po abuzoj ndoshta me kohën tuaj, por në këtë moment të historisë botërore nuk është këtu vetëm çështja albëreze, por është çështja që me këtë rast të bëjmë përpjekje për një kthesë thelbësore, që duhet ta bëjmë në politikën botërore.

Balenës, pas këtyre fjalëve të Keopsit, sikur iu largua paksa zyrtësia nga fytyra dhe meqë pa se askush tjetër nuk po kërkonte fjalën, foli:

- Faleminderit, zotëri i nderuar, për fjalët Tuaja kuptimplota dhe fort të rëndësishme në këtë moment të historisë njerëzore, Pra, po e prangosim Albin përkohësisht, por ku dhe kush po shkon i pari prej nesh tek ai për të filluar radhën e bisedave për bindje? – tha Balena dhe lëshoi një vrushkull të madh avulli.

- Le ta prangosim diku në bjeshkët e Albërisë, kurse për të shkuar po shkoni ju i pari, sepse albërezët sikur juve ju besojnë më shumë se neve të tjerëve. – tha Dielli dhe paloi sytë.

- E pastaj, me cilin rend do të vazhdojmë?-pyeti Gjeli.

- Sipas rangut, apo do të shohim.– tha Ariu.

- Pra, në këtë frymë po i jap urdhrat. Të gjithë, brenda pak ditësh, do ta keni historinë e hollësishme të Albërisë që nga koha e pellazgëve e deri në ditët e sotme dhe jetëshkrimin e detajuar të Alb Prometeut. Por le të veprojmë shpejt, sepse turmat po turbullohen e po valëzohen. – tha Balena dhe shtoi: - Kurse tash, po dalim në kopsht dhe po hamë e po pimë diçka se na u tha goja...

... pushteti e dhuna në aksion...

Ishte gjysma e natës kur Dhuna nxori Alb Prometeun nga burgu dhe e vuri para helikopterit "KORBI I ZI". Nga dritat e forta të helikopterit, që i binin drejt në sy, Albi nuk shihte asgjë para vetes.

-Përse, o djalë, përzihesh në punë që nuk janë të tuat. - dëgjoi zërin e Pushtetit.

-Punët e vulgut janë edhe punët e mia...- tha Albi.

-Ashtu?! – tha Pushteti që nuk dukej dhe iu drejtua Dhunës: - Vazhdoje e përfundoje procesin!

- Si urdhëroni! – tha Dhuna.

Albit ia vunë hekurat në duar e prangat në këmbë. U hap barku i helikopterit dhe ai u rrëmbye nga truprojat e Dhunës e sakaq u gjet brenda. U nisën në drejtim të panjohur për Albin.

Pas një kohe helikopteri gjigand u zdorgj në një lartësi të madhe, mbi një patalog të gjerë rrethuar me kreshta të bardha malesh. Vartësit e Dhunës, hoqën hekurat nga duart e prangat nga këmbët e Albit, e zbritën nga helikopteri dhe e skajuan larg makinës fluturuese. Nga kabina drejtuese doli stafi i pajisur me lloj-lloj veglash e instrumentesh. Pastaj, nga barku i helikopterit me ashensor u ulën një numër i madh pakosh të mëdha e të gjata. Ekipi i mori një nga një dhe i vendosi nja njëzet hapa larg dritave të fuqishme që lëshonte helikopteri. Ekipi filloi punën pa bërë asnjë fjalë. Pas një kohe jo fort të gjatë, mbi patalogun shkëmbor, mbuluar me akuj e me borë, u ngrit një si barakë, me dimensione dhjetë pashë në gjatësi e pesë pashë, në gjerësi e lartësi, krejt e ndërtuar nga plastmasë i pathyeshëm... Mbi kulmin e barakës u vendos një fuçi e madhe dhe një parabolë edhe më e madhe. Rreth e rrotull barakës, në borë e në akull, u vendosën tubacione të trasha e të holla nga plastmasi i zi. Se ç'bënë brenda në barakë nuk u pa. Në fund, në këmbën e majtë të Albit montuan unazat me zinxhirin e gjatë skajin tjetër të të cilit e ngallmuan thellë në shtrojën e në shkëmbijtë brenda barakës. Njëzet hapa larg barakës dominonte një shtyllë e lartë, me tri helika që nga veriu i fortë silleshin me shpejtësi të madhe.

Pas të gjitha këtyre veprimeve, njëri nga ekipi iu afrua Dhunës e i tha diçka në vesh. Dhuna, rrëmbeu Albin për krahu, e shpuri para derës së madhe të barakës e i tha me të sertë:

- Krejt për çka ke nevojë i ke brenda në barakë. Ushqimet e Serbisë i refuzove, prandaj në frizin e madh i ke bukën kollomoqe të Dukagjinit, specat djegës të Mamushës, qumështin "VITA" dhe ujin e Rugovës. Që të gjitha prodhime të Dardanisë. Kërkove liri për të gjithë? Ja, ku e ke lirinë absolute, me zinxhirë në këmbë! Kërkove pavarësinë nga civilizimi për të gjithë? Ja, ku i ke Bjeshkët e Nemuna të kullosësh sytë mbi to e nëpër to! Kërkove barazi për të gjithë? Ja, ku i ke kreshtat e bardha të bjeshkëve, barazohu me to!...

Zëri pushoi. Dhuna u largua. Pas pak, helikopteri i zi u ngrit në ajri e u zhduk.

Ishte acar i madh e veriu frynte me tërbim, prandaj Albit nuk i mbeti gjë tjetër vetëm, nën përcjelljen e cingërrimit të zinxhirit, të merrte qëndrimin prapaktheu dhe të futej në barakën që ishte përgatitur për të.

...befasia e parë për albin...

Albi, në e parë u gjet fort i befasuar. Para tij e rreth tij ishte vendosur një elektronikë e teknikë e fjalës së fundit.

Drita, qumësht e bardhë, tashmë kishte ndriçuar barakën e madhe. Muret e barakës ishin veshur me piktura e ngjyra shumë tërheqëse që të pushonin sytë e nervat. Tavani fort i lartë i barakës kishte ngjyrën e kaltër qumështore.

Baraka, me një rrethojë deri në shokë, ishte ndarë në dy anekse. Në të djathtë të derës së madhe ishte një si dhomë, në të cilën ishte vendosur një si trapazan me dërrasa shumë të trasha. Mbi dërrasa ishte vendosur një si shtrojë e zezë me një kablo të hollë te këndi pranë këmbëve me skajin e vet të lidhur mbi një rrotë me priza të shumta e mbi shtrojën e zezë ishte vënë një mbulesë tjetër e kuqe gjithashtu me një kablo të hollë e lidhur tutje për një prizë mbi rrotë.

Albi, nga lodhja, nuk pati kohë që të shikonte edhe gjërat e tjera rreth e rrotull vetes. Porsa u shtri mbi shtrojën e zezë dhe u mbulua me mbulesën e kuqe ato vetvetiu nisën të ngroheshin. Drita që vinte nga tavani, dalëngadalë filloi të zbutej derisa u shua fare. Se prej nga vinte një erë fort e këndshme, Albi nuk e përcaktonte dot. Ai, shumë shpejt, u përfshi nga një gjumë i thellë dhe fort i ëmbël...

....te mrizi i zanave gjallëri e madhe...

Nëna Zanë, brofi në këmbë e befasuar dhe e gëzuar. Shikoi rreth vetes të shtatë bijat e veta se si nën hijen e shtatë rrapave me kurora të bashkuara sikur koteshin të shtrira në dushk e fier.

-Çohuni bijat e Albërisë se, sipas një ëndrre që pashë, në malet tona na ka mbërri, trim mbi trimat, Alb Prometeu!

Të shtatë vajzat-zana, brofën në këmbë dhe rrethuan nënën e tyre. Nëna-Zanë vazhdoi:

-Ëndrra më tha se në patalogun midis Kreshtave të Bardha që mbrëmë është prangosur Alb trimi dhe ç'prej një jave është pa hëngër e pa pi!...

Zanat-bija, gapërruan sytë e mëdhenj dhe nga gojët lëshuan një ofshamë të gjatë. Nëna-Zanë, vazhdoi me zë të butë:

- Tash, të ulemi e të kuvendojmë se çfarë të bëjmë, si ta ndihmojmë e si t'ia lehtësojmë hallet Albit tonë?

Zanat e malit u ulën në lëndinën bleroshe dhe filluan kuvendin. E fundit foli nëna-Zanë:

- Bijat e mia, ne Albin e kemi të fisit tonë, prandaj kini kujdes e mos bini në dashni me të. Unë atë e kam djalë...

- Djalë?!- shprehën habinë e tyre të madhe zanat-bija...

-Po, - vijoi Zana e madhe,- unë e kam djalë e ju e keni vëlla!...

- Vëlla! - thirrën zanat-bija e nga gëzimi rrahën shuplakët...

- Do të shkojmë që tash te Kreshtat e Bardha, por atje, - tha nëna-Zanë, - në fillim, vetëm unë do të shfaqem e do të rri me të.

- Po, si të çmallemi ne me vëllain tonë? – iu hodhën të gjitha njëzëri nënës-Zanë.

- Ngadalni, bijat e lokes! Të gjitha, gjatë javës, do ta kalojmë nga një ditë të plotë me Albin tonë. Një ditë në javë unë do ta mëkoj me gji, kurse ju, për çdo ditë, me radhë, ashtu si i keni emrat do t'ia bëni shërbimet tjera trimit tonë. Çdonjëra prej jush, sipas degëve e dijenive që keni, ashtu si thatë edhe ju vetë, do ta njoftoni trimin tonë...

- Po, a do të na besojë ai neve? – pyeti Diella, më e reja e zanave.

- Paj, bija ime, ne detyrën tonë ndaj kombit e ndaj njerëzimit duhet e do ta kryejmë më së miri. Kush na ka besuar dhe kush na ka dëgjuar e, kush nuk na ka besuar e kush nuk na ka dëgjuar ju e dini si kanë kaluar. Ju e dini si kanë kaluar dhe si kemi kaluar të gjithë gjatë historisë, sepse shumica syresh nuk na besuan dhe nuk na dëgjuan...Sa na takon neve, ne Albit i besojmë dhe duhet t'i besojmë dhe me të gjitha mundësitë e aftësitë tona, duhet ta ndihmojmë e ta bindim që të na besojë e të na dëgjojë. Duhet ta ndihmojmë nëse e do ndihmën tonë. Duhet ta ndihmojmë derisa të jetë në shërbim të vegjëlisë, të lirisë, të pavarësisë, të barazisë e të drejtësisë për të gjithë...

-Paj, nënë, fisi i prometejve gjithmonë ka qenë i tillë...- tha Hana, bija më e moçme e zanave.

- Ka qenë edhe është, prandaj edhe ne kemi qenë e jemi në shërbim të tyre. Ju e dini fare mirë se sa përpjekje janë bërë dhe po bëhen që prometejt të shmangen nga rruga e vegjëlisë dhe të marrin anën e perëndive...Ju, sot, derisa unë të jem me Albin, do të vëzhgoni dhe do të merrni masa që të mos konstatohemi nga mjetet gjurmuese të perëndive dhe njëkohësisht do të përgatiteni që prej nesër, ditë e hënë, sipas emrave që keni e degëve që u takoni, t'ia bëni Albit të gjitha shërbimet

që i duhen atij personalisht dhe ato që i duhen në shërbim të kombit e të njerëzimit... Pra, punë, veprim e saktësi! Shkojmë! – tha nëna Zanë dhe sa çel e mbyll sytë u zhduk. Edhe zanat e tjera një e nga një u kthyen në drejtim të saj dhe u zhdukën.

Mrizi blerosh i zanave mbeti i qetë...

...mëngjesi i parë mbi kreshtat e bardha...

Albi i kishte dalë gjumi që herët, por nuk hapte sytë e nuk lëvizte nga vendi nën mbulojë. Priste që si përditë të dëgjonte hapat e cingërimën e çelësave të gardianëve të burgut, por kot. Më në fund, ai u kujtua se ç'kishte ndodhur me të, prandaj hapi sytë, i dha zor e u ngrit ulur. Në moment dritat në barakë u ndezën. Albi, hodhi shikimin mbi murin në aneksin prapa rrethojës së ulët dhe sytë iu ndalën mbi një ekran të madh plazmatik. Ktheu kokën prapa dhe pa telepilotin në raftin mbi kokën e tij. Kapi telepilotin dhe shtypi nja tre numra, ashtu pa shikuar. Papritmas, në ekran dolën dy gra lakuriq, njëra zeshkane e tjetra bardhoshe, të cilat ekstazoheshin duke ledhatuar gjinjtë dhe duke i fërkuar seksin njëra-tjetrës...

“Këto qenkan të fisit të Safos, nga Lezbia”, mendoi Albi...

Qëndroi pak kohë i menduar dhe pastaj shtypi sustën e telepilotit për më tutje. Në ekran dolën dy burra, njëri i bardhë e tjetri i zi, duke bërë seks anal...

“Këta qenkan të fisit të dylberajve”, mendoi Albi...

Edhe një herë ai shtypi sustën për më tutje dhe në ekranin e madh dolën një grua dhe dy burra të cilët njëkohësisht bënë seks vaginal e oral... Albi, shtypi edhe një herë sustën për më tutje. Kësaj here në ekran doli një prift katolik, i cili në anglisht, predikonte mësimet e Librit të Shenjtë. “Eu, - mendoi Albi, - vetëm një numër po i ndaka dy botëra”!...

Urata predikonte me aq pasion sa që i shkonin djersët...

Albi, qëndroi edhe ca kohë duke dëgjuar predikimin në anglisht dhe shtypi prapë sustën për më tutje. Kësaj here doli një hoxhë me një mjekër të kuqe, i cili fliste me një zë të thekshëm duke lëvizur fort duart, mirëpo nga arabishtja e tij Albi merrte vesh vetëm kur përmendej emri i Profetit Muhamed, aleihi selam!... Albi, shikoi tastaturën e telepilotit dhe pa të shkruar në të “Internacional-dixhital”. Mendoi:

“Maje këtyre kreshtave tona ku jam e marrkam krejt botën. Por, të shoh nëse kapen programet nga hapësira e Albërisë”?...

Dhe, shtypi numrin një. Doli “ALSAT” e pas këtij, me radhë, shikoi programet e paradites në të gjithë programet televizivë në gjuhën shqipe. Kureshtja e madhe e mbajti lidhur për ekranin televiziv, por në fund të paradites, nga lajmet nga hapësira e Albërisë koka iu bë dhallë dhe i lodhur e i dëshpëruar i ra ndërmend se kishte uri...

Mirëpo, pikërisht në këtë moment, në orën dymbëdhjetë sipas orës së madhe përballë, jashtë barakës, u dëgjua një alt i ëmbël, por i fortë:

- O, Alb Prometeu! A do miq, he burrë?!...

“Pale, pale! – mendoj Albi ende i shtrirë. – Çfarë miqsh në këto kreshta e në këtë kohë, o i madhi Zot”?!...

E njëjta thirrje u përsërit edhe një herë.

Albi, vrik kërcëu në këmbë, largoi zinxhirin anash dhe hapi derën e madhe. Bardhësia e madhe për një çast ia lëbyri shikimin, por kur iu përshtatën sytë dritës së madhe kishte se çfarë të shihte. Para tij qëndronte e buzëqeshur një grua edhe një herë më e madhe e më e gjerë se Albi. Flokët e saj të verdhë e të gjatë sa nuk preknin tokën. Në fytyrën e madhe rrumbullake e faqekuqe spikateshin hunda shkabë dhe dy sy të mëdhenj, të mëdhenj e të blertë. Lart kishte të veshur një xhaketë flakë të kuqe, në përmjetin e ngushtë kishte të lidhur një shokë të bardhë, kurse poshtë për trupin e gjerë vareshin diçka si ca kule të zeza, të shkëlqyera. Mbi atë krijesë bukuria e fuqia e pastër ishin bërë bashkë...

Albi, fërkoj sytë e tha si me vete:

- O Zot, a jam ëndërr a zhgjëndërr?!

- Je edhe në ëndërr edhe në zhgjëndërr. – i tha me një zë plot dashuri gruaja e bukur shtatmadhe dhe me disa hapa të matur iu afrua Albit trup më trup, lëshoi pëllëmbët e saj të mëdha e të buta mbi shpatullat e tij.

Pranë saj Albi kishte mbetur si një çunak, kishte ngritur kokën lart, kishte gaprruar sytë, por nuk e thoshte dot asnjë fjalë. Gruaja e madhe dhe e bukur e kapi Albin hopa dhe bashkë me të hyri brenda në barakë dhe pasi që shikoi në të katër anët, u ul mbi trapazan duke mbajtur Albin si nëna beben. Afroj gojën e vockël e buzëhollë te veshi i djathtë i Albit e i tha me zë të butë, të vogël e si në besim:

- Bir, kur ke hëngër e ke pirë herën e fundit dhe çfarë ke hëngër e ke pirë?

Albit, në moment iu lirua goja dhe gjithashtu me zë të butë, të vogël e si në besim e buzagaz tha:

- Me më pre nuk di as kur kam hëngër e kur kam pirë e as çfarë kam hëngër e çfarë kam pirë...

Nëna-Zanë, e puthi me butësi në ballë dhe shpejt shpërthekoi xhaketën e kuqe, nxori sisën e vet të bardhë e të madhe sa një shakull dhe thithin e kuq sa një mjedër ia lëshoi Albit në gojë...

Në fillim, Albi edhe nga hutimi edhe sepse kishte harruar, nuk diti të thithte. Nëna-Zanë, buzëqeshi dhe shtrëngoi lezëm gjirin e vet. Albit goja iu mbush qumësht e ëmbëlsi dhe sakaq iu ngjall instinkti fëmijëror. Mbylli sytë e nisi të thithte me afsh...

Kaloi një orë e sa ndërsa Albi qëndronte në prehrin e nënës-Zanë e me gjirin e saj në gojë. Në një moment atij i krisi një pordhë e madhe...

- Hej, pordhaç!- thirri nëna-Zanë me gëzim dhe me pëllëmbën e saj të madhe goditi lehtas Albin në prapanicë. Ai, i turpëruar, mbuloi fytyrën e vet me dorë. Nëna-Zanë shtoi me një zë që arsyetonte:

- U bë mirë, sepse kjo tregon se zorrët e tua filluan të punojnë. Ato janë tharë e janë tkurrë tash sa ditë pa ushqim e pa lëngje. Por, dëgjo! – foli nëna-Zanë me ton prindëror, - gjiri i djathtë sikur më është lehtësuar tepër; duhet të pish pak edhe nga gjiri i majtë që të barazohen peshat. – Dhe, ajo futi shpejt gjirin e djathtë brenda xhaketës, rrotulloi Albin në krahun tjetër dhe nxori edhe më shpejt gjirin e majtë të fryrë fort dhe thithin e kuq e futi në gojën tashmë të hapur të Albit. Ai, mbylli sytë e nisi të thithte edhe më me afsh. Nëna-Zanë e shtrëngoi fort Albin për trupin e vet, lëshoi shikimin mbi fytyrën e tij prej çunaku dhe filloi të përkundej nga kënaqësia e lumturia...

Pas një copë here të gjatë, i ngopur me qumësht, Albi hapi sytë. Shikimi i tij i turpshëm u ndesh me shikimin plot ngrohtësi të Nënës-Zanë. Ajo foli e para:

- U ngope?

- U ngopa dhe po më duket vetja se u bëra krejt tjetër njeri.

Nëna-Zanë, buzagaz largoi Albin nga prehri, e vendosi mbi shtrojën e zezë nja një krah larg prej vetes e tha me seriozitet:

- Tash, për një javë nuk do të jesh bebja ime, por do të jesh burrë i Kreshtave të Bardha...

Edhe Albi, mori qëndrim serioz dhe ia nguli sytë Nënës-Zanë pa ditur si të hapte muhabetin më atë mysafire të çuditshme. Duke parë këtë situatë të kurthuar, Nëna-Zanë, hapi muhabetin:

- Më thuaj, - tha Nëna-Zanë, - ke besuar ti se ka zana të malit?

- Kam besuar e nuk kam besuar, por është e sigurt se nuk kam besuar se do të takohem ndonjëherë me to. Si i vogël gjyshi më fliste për trimëritë e Mujit e të Halilit. Në ato ndodhi ai përmendte shpesh zanat e malit...

- Paj, edhe Muji e Halili kanë pirë gjirin tim...

- Ti, Nëna Zanë, - ndërhyri Albi fort i habitur, - nuk po tallesh me mua?!...

Nëna-Zanë, shpërtheu në gaz dhe ngriti pëllëmbën e saj të madhe sikur deshi të godiste Albin, por vetëm përfundoi me një ledhatim të ëmbël të faqes së tij. Nga kjo përzemërsi Albit iu lirua goja dhe duke buzëqeshur i tha Nënës-Zanë:

- Ndodhitë e Mujit e të Halilit sikur janë shumë të moçme...

- Të moçme, të moçme, por unë jam edhe më e moçme.

Albi, i çmeritur fort, pëshpëriti si për vete:

- O Zot i madh, a jam unë në ëndërr a në zhgjëndërr?!...

- Të pata thënë që në fillim se je edhe në ëndërr edhe në zhgjëndërr. – tha Nëna-Zanë fare seriozisht. – Gjithësia është e përbërë nga ëndrrat e zhgjëndrrat – nga jomateria e materia...

- Po, a bën ta di, Nëna-Zanë, sa vjet ke?

- Një mijë e pesëqind. – tha Nëna-Zanë pa të keq.

- Sa, sa?! – klithi Albi dhe kapi kokën me duar.

- Aq, pra, sa të thashë...
- Po, sa jetoni ju zanat? – pyeti Albi tepër i habitur.
- Ne jetojmë sa duam...
- Si, moj Nëna-Zanë, sa të doni...
- Ashtu, jetojmë sa të duam dhe kur të lodhemi nga jeta, ne zhdukemi.
- Albi, mbuloi fytyrën me pëllëmbët e bardha. Nëna-Zanë vazhdoi:
- Nëna ime ka jetuar dy mijë vjet... Kur bullgarët patën pushtuar tokat tona, ajo qe mërziur fort dhe prandaj vendosi të zhdukej...
- E, përse u mërziu aq fort? – pyeti Albi si të ishte ndonjë vogëlush.
- Sepse bullgarët bënë kërdi fort të madhe mbi popullin tonë. Faruan të gjithë ata që shtinë në dorë. Shpëtuan vetëm bishat e malit dhe mbijetuan vetëm ata ilirë, që ia dolën të kapnin majat, shkrepat e thepat e bjeshkëve të larta. Por, ata mbetën aq pak dhe aq të shpërndarë saqë harruan edhe emrin e vet...
- Kur i pushtuan bullgarët tokat tona?
- Që nga shekulli i nëntë dhe na mbajtën nën pushtim deri në mbarim të shekullit të dhjetë. Të gjithë këta emra sllavisht të maleve, fushave lumejve, qyteteve e fshatrave, që përdoren edhe sot në hapësirën albëreze janë trashëgimi e asaj kohe...
- Të ka treguar nëna jote Zanë për ato dy mijë vjetët e saj...
- Më ka treguar shumë dhe shpesh...
- Përputhen rrëfimet e saj me historinë tonë të shkruar?
- Paj, fare, fare pak, sepse historinë tonë e shkruan, e lakuan, e shtrembëruan e falsifikuan dhe e shkarravitën të huajt sipas interesave të tyre...
- E, përse ne nuk e shkruam historinë tonë?
- Sepse ne nuk ditëm të shkruanim...
- E, përse ne nuk ditëm të shkruanim?
- Sepse të parët tanë nuk patën nevojë për të shkruar...
- Si? Përse?! – pyeti Albi fort i habitur.
- Sepse ishin aq të lirë saqë edhe organizimin në formën e shtetit e përjetonin si një shtrëngim, si një barrë tepër të rëndë mbi shpatulla, si një ngufatje të padurueshme. Ata ishin mësuar të organizoheshin vetëm brenda fisit, kur kishte ndonjë konflikt midis fisesh dhe kjo zgjaste vetëm pak ditë, derisa konflikti gjente zgjidhjen e vet. Aq të hidhura, të rënda e të vështira u dukeshin ato pak ditë nën rregullat e organizimit derisa zgjidhej konflikti, saqë për ato pak ditë ata flisnin me vite të tëra...
- Mirëpo, nuk kuptoj përse ishte aq e vështirë të ndërtohej shteti e të sajohej një shkrim...
- Sepse kishin pas përtuar t'ia hynin asaj pune...
- Çfarë përtese? Nuk e kuptoj, nuk e kuptoj...

Nëna-Zanë, buzëqeshi me dhimbje, shtriu dorën dhe me pëllëmbën e madhe ledhatoi faqen e majtë të Albit e tha me pikëllim:

- Edhe nëna ime e të gjithë ilirët kishin pas përtuar ashtu, por pas përvojave fort të hidhura dhe tepër vonë ishin penduar të gjithë...

- Ndoshta më ka trullësuar qumështi yt, Nëna-Zanë, por unë nuk jam duke kuptuar asgjë...

- Dëgjo, bir i nënës! – Nëna-Zanë, u lëkund nga vendi e vijoi me një zë pak më të fortë. – Nuk fituan romakët mbi ne se ishin më trima se ilirët. Ilirët ishin si thonë trima të çartur, mirëpo e keqja ishte aty se ata nuk kishin ndonjë organizim të përhershëm ushtarak e policor. Ata ndiheshin mase të sigurt brenda fisit, sepse të gjithë ishin të një barku. Ata, organizoheshin vetëm me rastin e ndonjë konflikti ndërfisnor dhe si të thashë, ato konflikte zgjasnin fare shkurt. Pastaj, e keqja tjetër e madhe ishte se kur filluan pushtimet romake, çdo fis luftonte vetëm për vete. Ndoshte shpesh që ndërsa njëri fis zhvillonte luftime të ashpra e të përgjakshme me romakët, fiset tjera bënë sehir duke mos qenë të vetëdijshëm se pas një kohe edhe ata do të ishin objekt i pushtimeve romake. Lidhjet fisnore ishin aq të mefshta sa që jo rrallë ndodhte që ndonjë udhëheqës ilir edhe mashtrohej e kalonte në anën e romakëve kundër fisit tjetër ilir. Pastaj, çka ishte fort me rëndësi, romakët ishin të përgatitur për luftë të gjatë dhe me të gjitha format e saj, kurse ilirët ishin të gatshëm për luftë fort të rreptë, por të shkurtër. Ti e di se pushtimi i Ilirikut, me gjithë përçarjet e degëzimet fisnore, falë guximit e trimërisë së pashoqe të ilirëve, zgjati një shekull e sa...

- Këtë tash e kam fare të qartë, por përse ilirët të mos kishin shkrimin e vet, ose të paktën të mos përdornin shkrimet e të tjerëve?

- Sepse, pra, nuk kishin shtet dhe nuk u duhej shteti. Atdheu i tyre përfundonte me fisin dhe brenda fisit ata ndiheshin të sigurt dhe të mjaftueshëm. Ata, atje nuk kishin përse të shkruanin se i dinin të gjitha dhe të gjithë njiheshin midis tyre...Por, biri im, ti nesër do ta kesh këtu Hanën, bijën time më të madhen, një mijë e katërqind vjeçe e cila është e dhënë pas shkencave politike dhe ajo ka për të të dhënë sqarime më të hollësishme dhe më të argumentuara. Mua, tash më duhet të ik, sepse unë, përveç teje kam edhe bebe të tjera për të mëkuar...

Albi u ngrit në këmbë, kapi me dashuri duart e Nënës-Zanë dhe i puthi me dhjetëra herë. Ajo, u kërrus, puthi Albin në ballë, hapi derën e madhe të barakës dhe u zhduk.

Albi mbeti vetëm. Pasi u mendua paksa doli edhe vetë jashtë, para barakës së zezë, në patalogun e Kreshtave të Bardha. Nën qiellin e kaltër, në cegmin e madh u dëgjuan vetëm cingërimat e zinxhirit të lidhur për këmbën e tij. Kapi me dorë zinxhirin e lidhur për këmbën e majtë. U bind se nuk ishte në ëndërr. Shumë gjëra iu sqaruan, por edhe shumë të tjera i mbetën ende në mjegull. Ndjeu një etje të madhe dhe një ëmbëlsi prej mjalti. U fut përsëri në barakë duke tërhequr zinxhirin zvarrë.

Shkoi drejt e te aneksi i frizeve dhe i frigoriferëve. Aty pa shisjet e rreshtuara me “Ujë Rugove”. Kapi të parën, e hapi e nisi të pinte me shishe. Pasi shoi etjen, u shtri mbi shtrojën e zezë dhe u mbulua me mbulojën e kuqe. Vetëm sa pati kohë që të mendonte se nesër e priste ditë e re e nafakë e re, – takimi me Hanën dhe e zuri gjumi...

...zana- hanë thërret vëllain...

Kishte aguar, por tani Albi e dinte fare mirë se ku ishte. Po mendohej a ta hapte televizorin, kur një zë i ëmbël ia ndërpreu mendimet:

- O, vëlla! Këtu e ke motrën Hanë...

Albi, brofi në këmbë dhe me kureshtje të madhe, ndonëse u pengua për zinxhirin e mallkuar, hapi derën dhe kur pa Zanën-Hanë, mbeti me njëren këmbë brenda e me tjetrën jashtë. Po të mos ishte përvoja e djeshme, sot Albin do ta lëshonin këmbët. Bukuria që qëndronte e buzëqeshur para tij e pushtoi dhe e dehu të tërin. Fshiu sytë, ua hodhi një shikim kreshtave të bardha rreth e rrotull, por prapë shikimi iu ndal te ajo. Ishte Zana-Hana, motra e tij e gjirit...Ajo vazhdonte të qëndronte e buzëqeshur dhe pa lëvizur nga vendi. Me trup ishte sa Nëna-Zanë dhe me të njëjtën veshje. Mirëpo fytyra e saj ishte rrumbullake si hëna pesëmbëdhjetëshe. Kishte flokët deri në tokë e ngjyrë lajthie. Vetullat krah dallëndyshe, sytë, gjithashtu ngjyrë lajthie, por fort, fort të mëdhej. Hundë-shkabë, nën të cilën goja e vockël me buzët e holla e të kuqe si fletët e trëndafilut. Ajo, prirej në gaz. Në dy faqet e kuqe dhe në mjekër vetëm sa lëviznin lehtas gropëzat mahnitëse. Vetëm një hap larg Albit ajo lëvizte vetëm qepallat me rremba. Albit, më në fund i erdhi zëri.

- Më thuaj moj motër, a jam në ëndërr, apo në zhgjëndërr?

- Je edhe në ëndërr edhe në zhgjëndërr, o vëlla i motrës! – tha Hana dhe ra në gjunjë para këmbëve të Albit. Albi u shtang. Ajo e kapi të tërin, e shtrëngoi fort dhe e puthi në të dy faqet. Albi, për një çast mbeti pa frymë. Hana u ngrit në këmbë dhe duke i bërë Albit me dorë kah dera e madhe e barakës, tha:

- Na prij, o vëlla, he ty të priftë e mbara!

Albi, kapi me dorë zinxhirin dhe hyri brenda. Pas tij hyri edhe Hana. Ai foli:

- Ulu motër ku të duash e si të duash dhe mirë se të sollti Zoti i Madh!

Hana u ul te këmbët, ndërsa kryet e vendit ia la Albit. Albi, pasi që u ul, mori frymë thellë e tha:

- Po më duket se po e ndiej erën e luleve të livadheve të dajave...

- Atyre luleve, në Llap e Gallup u thonë lulet e Xhenetit, apo jam gabim?

- Pikërisht ashtu u thonë. Sa herë shkoja atje, tezja Feride mblidhte për mua nga një dorëz të madhe lulesh të Xhenetit. Asnjëherë nuk ngopesha me erën e

tyre, por sot po më duket sikur e gjithë baraka është mbushur me erën e luleve të Xhenetit dhe sot po ngopem me këtë erë fort të këndshme.

- Edhe unë – tha Hana duke larguar nga balli i gjerë flokët e gjata – sot po e ndiej dhe sot po ngopem me erën vëlla!...

- Paska vëllau erën e vet?!- pyeti Albi i habitur.

- Po. - tha Hana bindshëm e vazhdoi: - Nëna e ka erën e vet, baba e ka erën e vet, vëllau e ka erën e vet dhe motra e ka erën e vet...

- Po, mirë, motra e paska erën e luleve të Xhenetit, po vëllau çfarë ere paska?...

- Dëgjo, - ndërhyri Hana, - çdo motër e ka erën e vet, ti do të bindesh për këtë që po të them, por era e vëllaut, era e vëllaut nuk përcaktohet dot, sepse ajo është një, dhe ajo ta çon zemrën peshë!...

- Pale! Pale! – tha Albi si me vete.

- Ja, edhe kjo “pale-pale”, nuk përcaktohet dhe nuk përkthehet në asnjë gjuhë tjetër. Ne e kuptojmë, por nuk e përkthejmë dot. Kështu, nuk përcaktohet as era vëlla, por ajo ekziston...

- Po, për zanat e malit çfarë të themi? – i doli Albit kjo pyetje fare e pakontrolluar.

- Paj, *ZANAT JANË DIJA, VETËDIJA, MBAMENDJA E DASHURIA E KOMBIT NDËR SHEKUJ.* – tha Hana duke lëvizur paksa nga vendi e shtoi me zë fare të qetë:- *ZANAT JANË MBROJTJA E SHPIRTIT DHE E TRUPIT TË KOMBIT.* Natyrisht, për ata që besojnë...

- E për ata që nuk besojnë? – ndërhyri Albi trembshëm si ta kishin zgjuar nga gjumi.

- Për ata që nuk besojnë, - u përgjigj Hana qetas, - vaj halli!

- Vaj halli! – klithi Albi si i përvëlur dhe brofi në këmbë.

Hana vetëm largoi flokët nga fytyra rumbullake dhe buzëqeshi.

- Ti, motër po buzëqesh, por ne i paskemi punët fort keq! Sa ka prej kombit tonë që besojnë?

- Fort, fort pak. – tha Hana qetas.

- Fort, fort pak, po thua? - pyeti Albi i çmeritur dhe iu rras Hanës në fytyrë.

- Shumica dërrmuese as nuk i besojnë Zotit, as nuk i besojnë shkencës. – tha Hana përsëri fare e qetë.

- Paj, ti, moj motër, je duke folur pa asnjë fije brengje sikur të mos kishe fare zemër...

- Zemrën e kam kur shfaqem si njeri, - ndërhyri Hana, - por jo për t'u brengosur...

- Ja, unë, falë Dhunës, pata rastin, i pashë zanat dhe u binda, por çfarë të bëjmë me ata, që nuk i kanë parë? Si të besojnë ata?...

- Ata le të të besojnë ty...

- Paj, ata, moj motra ime e dashur, si the edhe vetë, nuk po i besojnë Zotit e ku të më besojnë mua?! – klithi Albi me dëshpërim të madh.

- Ata nuk meritojnë që ti të dëshpërohesh për ta. Sa prej tyre janë duke u dëshpëruar e duke u brengosur për vuajtjet e tua?

- Shumë pak...

- Pra, vetëm ata që i besojnë Zotit, ose që njohin shkencën bashkëndiejnë me ty...

- Po vijmë te fjala jote “vaj halli për kombin tonë” ! Çfarë të bëjmë? – pyeti Albi dhe u ul.

- Të presim *DUKE PUNUAR*. – tha Hana ftohtas.

- O, mos ma thuaj atë fjalë, të lutem! Çfarë të presim? – klithi Albi duke rrahur gjunjët.

- Të presim *DUKE PUNUAR DERISA PAKICA TË BËHET SHUMICË...*

- Do të presim shumë?

- *SA MË SHUMË QË TË PUNOJMË AQ MË PAK DO TË PRESIM...*

- Po, mirë,- foli Albi qetas,- si e përjetoni ju, zanat kohën?

- Në jetojmë jashtë kohe...

- Paj, po, po... Një mijë e pesëqind vjet! Dy mijë vjet... As atëherë nuk besonin?

- As atëherë...

- Për shembull?

- Për shembull Leka i Madh. Ti e di se ai ishte i biri i Olimpisë, prej një fisi ilir...

- Dhe, çka Leka i Madh? – pyeti Albi pa të keq.

- Po, ja që sipas fjalëve të gjyshes sime e të tregimit të Nënës-Zanë, ajo e kishte pas këshilluar Lekën që të mos nisej për në Lindje se atje e priste vdekja, por në fillim të orientohej kah Perëndimi që të bashkonte fiset ilire. Ishte disa qindra vjet përpara pushtimeve romake. Ishte rasti ideal që të thyheshin lëvozhgat e të shqyheshin mëshikëzat fisnore, por të mos shkatërroheshin e asgjësoheshin pjesëtarët e fiseve. Këtë mund ta bënte vetëm Leka i Madh, sepse ai jo vetëm që ishte me gjak ilir, por ai fliste rrjedhshëm gjuhën e nënës. Pasi që do të krijonte një shtet të fuqishëm me ilirët ai do të mund të mësynte edhe Lindjen i siguruar nga përçarjet e lakmitë e gjeneralëve dhe duke thithur qumështin e gjyshes Zanë do të sigurohej edhe nga sëmundjet, të cilat në atë kohë bënin kërdi. Mirëpo, ai nuk i kishte pas dëgjuar këshillat e gjyshes sonë, nuk kishte pas dashur që të pinte qumështin e gjyshes sonë, por i kishte pas dëgjuar këshillat e mësuesit të vet Aristotelit. Aristoteli ka qenë një filozof i madh dhe ka korrë suksese të mëdha në fushën e arteve e të shkencave. Mirëpo, politika është maza e shkencave dhe e arteve. Aristoteli u ka besuar vetëm pesë shqisave të veta. Mirëpo, politika nuk është

vetëm ajo çfarë mëson e çfarë sheh me pesë shqisat, por ka edhe diçka tjetër që nuk mësohet, por që për çdo ditë hulumtohet e zbulohet dhe kur shfaqen rrethanat e kushtet politikani realizon synimet e veta. Leka i Madh ka qenë prijës ushtarak fort i zoti, por jo edhe politikan aq i zoti...Ai humbi shansin për ta bërë Ilirinë shtet të fortë e të pathyeshëm. Mbetëm në lëvozhgat fisnore. Romakët, më vonë erdhën dhe, një nga një, jo vetëm që thyen lëvozhgat e shqyen mëshikëzat fisnore, por edhe shkatërruan një pjesë të madhe të përmbajtjeve njerëzore. Nga gërmadhat e mbeturinat e përmbajtjeve të shkatërruara ilire romakët krijuan legjionet e armatave të veta pushtuese...

- E, përse ilirët nuk krijuan vetë shtetin e tyre?- ndërhyri Albi.

- Sepse nga brenda nuk ishin shfaqur forcat e duhura për të shpërthyer mëshikëzat e më vonë lëvozhgat fisnore. Fisi i ruajti ilirët nga fekondimi për t'u shndërruar në shoqëri skllavopronare si kishte ndodhur e ndodhte me popujt rreth e rrotull Ilirisë. Ilirët, robërit e luftës nuk i bënë skllavë. Ata, robërit ose i vrisnin, ose i lëshonin, ose i bënë pjesëtarë të fiseve të veta. Prandaj tek ilirët nuk u shfaq nevoja e domosdoshme e brendshme për t'u organizuar në shtet çka nënkuptonte krijimin e ushtrisë e policisë së përhershme, bashkë me administratën përkatëse. Allahçe, krerët e disa fiseve më të mëdha kishin dofarë shpurash rreth shtëpive të tyre, por kjo ishte shumë larg nga ajo që të mund të luante rolin e shtetit, që do të kontrollonte territorin dhe rrjedhat ekonomike brenda tij. Lëvozhgat fisnore, me vetëmjaftimin e tyre, ishin ato, që pengonin një zhvillim të tillë. Ta marrim një shembull praktik. Përse ne bluajmë kokrrat e të lashtave? Për të shkatërruar mbështjellësit e kokrrave përkatëse, që ato të mund të gatohen. Prandaj. Nesër do ta kesh këtu motrën pas meje, Martën e cila është e dhënë pas shkencave ekonomike. Ti e di se ekonomia është shprehje e koncentruar e politikës dhe anasjelltas...

- Ka politika ndonjë definicion të vetin sipas teje?

- Politika është të vepruarit duke pasur parasysh sa më shumë faktorë që veprojnë në shoqëri e në natyrë. Në veprimet tona sa më shumë faktorë që të kemi parasysh aq më frytdhënëse dhe më e saktë do të jetë politika jonë. Ky është definicioni më i përgjithshëm. Ka politikë ekonomike, politikë arsimore, politikë kulturore, politikë shëndetësore, politikë ndërkombëtare...

- Ilirët kishin vetëm politikë fisnore...

- Vetëm politikë fisnore. Kjo politikë, për kohën e vet ishte shumë demokratike, sepse mbështetej në lidhjet e gjakut midis pjesëtarëve, mirëpo ishte shumë e kufizuar dhe asnjëherë nuk u shndërrua në faktor tejlokal...

- Mirë, motër, ma ke kthjelluar kokën dhe m'i ke sqaruar e zbardhur rrënjët e disa çështjeve tona që më kanë munduar kokën. Por më intereson të ma sqarosh këtë: si ilirët u shpartalluan si fise nga romakët, si u mobilizuan si ushtarë të tyre, si u romanizuan...

- – E, jo të gjithë u zhdukën e u romanizuan! Jo të gjithë u helenizuan! Jo të gjithë u sllavizuan! Jo të gjithë u turqizuan!...Ne jemi pikërisht pasardhësit e atyre ilirëve, që iu veshëm maleve të lartë, shkrepave, gërxheve, thepave e të cilët nuk pranuan as shtetin e pushtetin romak, as shtetin e pushtetin helen, as shtetet e pushtetet sllave, as shtetin e pushtetin otoman! Ne, nuk u lagëm, nuk u zbutëm dhe nuk u sivetuam nga kulturat shumë më të përparuara politike, ekonomike e gjuhësore të popujve që pushtuan e përmbytën hapësirat tona. Por, ne, mbetëm të pakët në numër, të vetmuar dhe me dije fort të kufizuar...

- Me ne ishin e mbetën vetëm dhitë...- ndërhyri Albi duke ngritur duart e sytë lart.

- Po, ne mbetëm vetëm me dhitë e me vështirësitë e tejme natyrore, në varfëri të hatashme, të cilat na kalitën me energji e forcë të pathyeshme. Mirëpo, - shtoi Zana-Hanë me dëshpërim, - përka dija e vetëdija e organizimi mbetëm shumë mbrapa krahasuar me romakët e me popujt tjerë rreth e rrotull nesh...

- Si edhe sot...- ndërhyri prapë Albi me dëshpërim të madh.

- Po, por sot është i pranishëm një faktor i ri...

- Cili faktor, motër? – ndërhyri Albi si i mbyturi që donë të kapet për rrënjët shpëtimtare.

- Është faktori i depërtimit e përhapjes së shpejtë të vetëdijes kuantike dhe i mekanikës kuantike, që po i shpejtojnë proceset me shpejtësi marramendëse...

- Mendon, motër se kjo shkon në të mirën tonë? – pyeti Albi me shpresa të ngjallura.

- Gjithsesi...

- Motër, nëse nuk të lodha, po më intereson të di, nëse edhe ndonjëherë tjetër gjatë historisë sonë u paraqitën rastet për të thyer lëvozhgat e për të shpërthyer mëshikëzat tona fisnore?...

- Paj, ishte edhe një rast, nëse mund ta quajmë rast, kryengritja e shqiptarëve kundër otomanëve nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Mirëpo, në atë kohë lëvozhgat fisnore ishin shndërruar e forcuar edhe më dhe ishin bërë principata...Hapësira shqiptare ishte pushtuar e tëra nga njëra prej fuqive më të mëdha të kohës, prandaj dhe Gjergji pati një detyrë pothuajse të pamundshme. Edhe rrethanat ndërkombëtare të asaj kohe nuk shkonin shumë në favorin tonë. Mirëpo, për të bërë punën edhe më pus ishte fakti se as ai nuk ka dëgjuar dhe nuk u ka besuar zanave...

- As ai?!

- As ai. Nënës-Zanë i vjen keq të të tregojë, por ne na ka treguar se si ka bërë përpjekje që ta këshillonte, por as ai nuk kishte pas dëgjuar. Siç e di edhe ti Gjergji ka qenë ushtarak fort i zoti dhe kryengritja e tij kundër otomanëve pati rëndësi vendimtare për kombin tonë. Mirëpo, sikur ai të kishte dëgjuar këshillat e Nënës, sot, gjendja e kombit tonë do të ishte shumë më ndryshe dhe larg më e favorshme. “O,

Gjergj!” i kishte pas thënë Nëna. “Mos i dëgjo fort lajkat e këshillat e Venedikut, të Papës e të Raguzës, sepse ata i kanë qëllimet e tyre dhe janë duke të shfrytëzuar ty për hesapet e veta. Me otomanët ti lufto, por lere edhe shtegun hapur për armëpushime, për marrëveshje të shkurtra, për paqe të kushtëzuara e bashkëpunim me interes të ndërsjellë...Ti e ke gjetur çelësin e qëndresës ndaj otomanëve, por ti nuk do të mund të qëndrosh gjatë vetëm dhe i izoluar. Nëse do të dalësh nga izolimi duke nënshkruar një armëpushim me sulltanin, atëherë Venediku, Papati, Raguzë dhe Perëndimi do të jenë të detyruar që të angazhohen materialisht e financiarisht më shumë në anën tonë. Ti je bërë mburojë e Perëndimit, por ti nuk bën të kënaqesh vetëm me kaq! Për interesin tonë e të Evropës edhe më mirë do të ishte, që ti të bëhesh edhe faktor drejtpeshimi midis Lindjes e Perëndimit. Dhe, në këto rrethana si janë tash, ti mund ta bësh një gjë të tillë...” Këto kishin qenë fjalët që ia kishte pas thënë Nëna Gjergjit...

- Paska pasur mundësi të atilla dhe paska pasur oferta të kësaj natyre nga sulltani?

- Ka pasur oferta shumë të favorshme, mirëpo Venediku, Papati dhe Raguzë i prishnin punë. Ata e nxisnin Gjergjin për luftë të pakompromis dhe të pandërprerë me sulltanin, ndërsa vetë, prapa shpinës së tij, bënë njëqind kompromise e dallavere me të...Pastaj, Nëna e kishte pas këshilluar që të rrinte larg nga viset me kënetë e me malarie...E kishte pas lutur gjithashtu që ta mëkonte për hir të shëndetit, mirëpo ai i kishte pas thënë Nënës-Zanë me përbuzje: “Nuk jam kërthi me më dhanë ti gj!”... Qemë mërzitur fort për këtë qëndrim të Gjergjit, mirëpo nuk ishte në dorën tonë që të ndryshonim gjë...Pasi që ndërroi jetë Gjergji, hapësira shqiptare mori tatëpjetën e gjatë e të mundimshme...

- Me këto që më the më ndihmove shumë, motër, he ty të lumtë goja! Mirëpo, midis kohës heroike të Gjergj Kastriotit dhe luftërave ballkanike pati ndonjë figurë, që ti mendon se e vlen të bisedojmë për të?

- Paj, varet nëse duam që të hyjmë në imtësira, apo të ndalemi vetëm tek ato figura që luajtën rolet e tyre me rëndësi kombëtare. Dihen përpjekjet e Kara Mahmut Pashë Bushatit dhe të Ali Pashë Tepelenës për t'u liruar nga zgjedha otomane. Mirëpo, ato, me efektet e tyre megjithatë mbetën në shkallë regjionale...

- Po, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit a ke ti mendimin tënd? – ndërhyri Albi.

- Paj, o vëlla, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit është shkruajtur mjaft, por askush deri më tash nuk mori guximin që të jetë objektiv deri në fund. Pas Marrëveshjes së Shën Stefanit e cila e dëmtoi perandorinë otomane edhe në dëm të tokave shqiptare, Evropa, duke parë se Rusia cariste ishte në prag të realizimit të planeve strategjike të Pjetrit të Madh për të dalë në Mesdhe, me Kongresin e Berlinit, kërkoi revidimin e Traktatit të Shën Stefanit. Në këto rrethana, Perandoria Otomane, në njërën anë, ua bëri të ditur shqiptarëve se pazarllëku po bëhej edhe për territoret

shqiptare. Porta, kështu, duke mbyllur njërin sy, bëri të mundur që shqiptarët të ngriheshin në këmbë dhe të fillonin të organizoheshin për mbrojtjen e trojeve të veta. Kjo ishte loja e otomanëve tashmë të ligështuar që të aktivizonin për hesape të vetat energjinë e shqiptarëve. Kjo dyfytësi otomane u pa në fund të lojës, kur Rusia nguli këmbë që Mali i Zi të zgjerohej në kurriz të tokave shqiptare, ajo mori anën e fuqive të mëdha dhe me ushtrinë e vet ndihmoi thyerjen e forcave vullnetare shqiptare që mbronin tokat e veta e pas luftës arrestoi, vrau e syrgjynosi me mijëra atdhetarë shqiptarë... Vetëm vlimet në Mexhlisin turk dhe kryengritjet e 1910 – tës, të 1911-tës dhe përfundimisht çlirimi e bashkimi i tokave shqiptare në tetor të 1912-tës ishin lëvizje të përgjithshme autentike çlirimtare antiturke. Në këto ngjarje dramatike u shquan figurat politike të Hasan Prishtinës e të Ismail Qemalit. Në planin ushtarak u shquan figurat e Isa Boletinit, Idriz Seferit, të Bajram Currit e shumë të tjerëve. Pikërisht në këtë kohë, në tetor të 1912-ës, pasi që tokat shqiptare tashmë ishin çliruar e bashkuar, Aleanca e Fshehtë Ballkanike e përbërë nga Serbia, Mali i Zi, Greqia, Bullgaria e Rumania kallën Luftën e Parë Ballkanike me qëllim që të pengonin daljen në skenë dhe stabilizimin e shtetit shqiptar në Ballkan dhe të copëtonin e përndanin tokat shqiptare...

...hasan prishina e ismail qemali...

- Dhe, i ndanë, i copëtuan e pushtuan dy të tretat e tokave shqiptare... Po Hasan Prishtina e Ismail Qemali ç'bënin?

- Hasan Prishtina e Ismail Qemali ishin demokratë të vërtetë dhe politikanë të formatit evropian. Mirëpo të tillët atëherë Evropës Anglo-Franceze nuk u duheshin. Këto dy fuqi kishin plane tjera. Edhe Gjermania e Austro-Hungaria kishin planet e veta... Po përgatitej rrëmuja e kasaphana e Luftës së Parë Botërore. Të dy taborret po mundoheshin të bënin aleatë gjithandej Evropës. Hasan Prishtina e Ismail Qemali u munduan të bënin diç me diplomaci. U munduan që të përfitonin përkrahjen anglo-franceze në favor të pavarësisë së tokave shqiptare, por interesat e këtyre shteteve ishin drejtuar tjetërkah. Pastaj, diplomacia, që nuk e ka forcën mbrapa dhe që nuk ka çfarë të ofrojë si kundërvlerë për përkrahje nuk jep rezultate... Ndërsa po zhvillohej Lufta e Dytë Ballkanike midis Serbisë e Bullgarisë lidhur me tokat e Maqedonisë, Nëna jonë u mundua të vendoste një lidhje me Hasan Prishtinën në fshatin Fletë. Tregon Nëna. Kishte pas qenë natë me hënë të plotë. Nëna ishte shfaqur mu para dritares së dhomës në të cilën Hasan Prishtina po bëhej gati të flinte. Ai nuk duronte as duhanin, as gërhamën e të tjerëve, prandaj flinte vetëm. Nëna kishte pas trokitur lehtas në dritare. Hasani ishte ngritur vrik me allti në dorë dhe kishte hapur dritaren. Nga habia i ishte marrë goja dhe vetëm kishte pas shikuar duke fshirë sytë. Nëna i kishte pas thënë: "O Hasan beg, mos i fshij sytë kot e mos u friko se unë jam nëna jote." Atij i ishte lëshuar goja. "Çfarë nëne moj?! Paj,

nëna ime ka vdekur para dhjetë vjetësh!...” “Jo, jo, unë jam zana e malit dhe kam ardhur vetëm me të thënë diçka...” “Pale,pale! Pa, fol moj fisnike se nuk po u besoj as syve, as veshëve të mi!” “Hasan beg, largohu prej Austro-Hungarisë e Italisë se ato kanë për ta humbur luftën. Bashkohu me Anglinë e me Francën se ato kanë për ta fituar luftën.” “Ah, moj fisnike, aq thellë kam hyrë me Austrinë e Italinë sa që nuk tërhiqem dot prej tyre. Por, a di çka? Hajt, shko e shiko punën tënde se nuk janë këto punë për gra e për zanat e malit! He, lum bëfsha për ty e kuku për ne!...” “Hasan beg”, ishte munduar Nëna edhe një herë ta vazhdonte muhabetin, por ai kishte pas mbyllur dritaren me rrapëllimë dhe kishte shkuar në kënd të odës, ishte shtrirë mbi sixhaden e kuqe dhe ishte mbuluar me plafin e zi... Nëna, pasi që po shihej se si do të përfundonte Lufta e Parë Botërore, pati bërë edhe një përpjekje për të këshilluar Hasan Prishinën...Kjo, pati ndodhur në fshatin Kolaj, të Gallapit. Pasi që burrat shpërndahen për të fjetur dhe kur Hasani mbetet vetëm në një dhomë, Nëna prapë i shfaqet para dritares. Hasan Prishtina kishte pas kapur kokën me duar dhe i ishte pas ngërmuar Nënës: “ Po, a je ti dreq a melaqe, bre, që e kishe pas ditë aq mirë se si do të përfundojë lufta?...” “Jo, Hasan beg, nuk jam as dreq, as melaqe, por jam ajo zana e malit, që të pata dalë në fshatin Fletë. A të kujtohet?” I kishte pas thënë Nëna Hasanit. Mirëpo ai i ishte pas përgjigjur rreptas: “Hajt, bre, fisnike, shiko punët e tua se zanat e malit janë vetëm nëpër përralla fëmijësh!”...Nëna ishte pas munduar edhe një herë: “ O Hasan beg, besomë, he burrë, se zanat nuk janë vetëm në përralla, por janë prej se njerëzit kanë zbritur nga degët e druve të malit.“ Kot. Ai i ishte pas përgjigjur si në vaj: “Hajt, bre, fisnike udhëve tua, se kam filluar që të mos i besoj as vetes sime e jo më t’i besoj një gruaje dy herë më të madhe se vetja e me flokët e gjatë deri në tokë. Ik, se edhe pa ty veç që nuk po më dalin mëndët prej kreje!” E kishte pas mbyllur dritaren, e kishte pas rrokur kokën me të dyja duart dhe bërë gullumuç mbi lëkurën e ogçit...

- Po, - tha Albi si vetmevete - kur humb besimi, humb edhe shpirti, edhe koka, edhe atdheu, edhe dashnia...

- Ashtu është, o vëllau i motrës, por unë kam ardhur edhe me një porosi të Nënës-Zanë...

- Fol, moj motër! – tha Albi dhe shtoi - Sa bukur tingëlluaka fjala motër!

- Po, -tha Hana-Zanë - fjala motër tingëllon, por ama fjala vëlla ushton gjithandej hapësirës. Por Nëna më ka porositur që të të njoftoj se perënditë frik do të vijnë në vizita tek ti...

- Mund të ndodhë që edhe të vijnë...

- Ata po përgatiten dhe do të vijnë të bisedojnë me ty e, edhe të të kontrollojnë. Ata po të kontrollojnë nga satelitët vazhdimisht, por ne kemi marrë masa teknike që hyrje-daljet tona të mos mund të kapen. Mirëpo, ata do të kontrollojnë edhe ushqimet e tua...

- Paj, le të kontrollojnë...

- Çfarë ke nga ushqimet, këtu?
- Unë kam pirë vetëm ujë të Rugovës e Dhuna më ka thënë se kam bukë kollomoqe të Dukagjinit, qumësht të pakeluar VITA dhe specia djegës të Mamushës. Të gjitha prodhime të Kosovës se pata refuzuar të haja prodhime të Serbisë...
- Ti duhet të hash ngapak nga kjo buka këtu që të mos biesh në dyshim se si e mban shpirtin gjallë. Kupton?
- Albi pohoi me kokë.
- Pa, dale të shikojë motra si duket ajo bukë e Dukagjinit. – tha Hana dhe shkoi në pjesën e frizeve dhe të frigoriferëve. Pasi që hallakati pak, Hana foli prapë - Buka qenka e pakeluar shumë mirë. Qenka e mbështjellë me varak që të mbahet ftohtë e të mos ngrijë. Këtu qenkan edhe mjetet për zierje e pjekje. A të ta përgatitë motra një përsesh të vogël të përvëlur me qumësht të valë?
- Paj, nuk jam i uritur fare, mirëpo meqë po do, por me kusht që të hamë bashkë...
- Ani. – tha Hana dhe filloi nga puna.
- Ajo, shumë shpejt e vloi qumështin dhe i përvëloi thërmiat e bukës kollomoqe. Pastaj thirri Albin:
- Eja, vëlla, te motra jote!
- Albi, me zinxhirë nëpër këmbë u afrua te tavolina e vogël e përgatitur për të. Shikoi pjatën prej nga ngrihej avulli erëmirë.
- Bah, - tha – çfarë ere e këndshme! Eja, motër të hamë bashkë, por si po shoh unë këtu qenka vetëm një lugë...
- Prandaj, o, vëllau i motrës, ha ti e pas teje unë ia bëj edhe vetes një përsesh të ngjashëm.
- Albi u ul pa fjalë dhe futi në gojë nja dy lugë përsesh. U ndal e tha si duke qeshur:
- Kush thotë se bukës kollomoqe i ka dalur fala?
- Thonë vetëm kollomoqat o, vëllau i motrës! – i tha Zana-Hana e cila qëndronte pip në këmbë pranë tavolinës.
- Albit, me gojën plot përsesh i plasi gazi. Por një gaz që shpërthen si vullkan. Gjithë çfarë pati në gojë ai kërceu dhe u shpërnda mbi tavolinën e vogël dhe mbi fytyrën e flokët e Hanës. Ajo, vetëm largoi paksa flokët dhe me të dy duart e saj mblodhi nëpër fytyrë thërmiat e përseshit, i futi në gojë dhe vazhdonte të lëpinte buzët.
- Albi, duke vërejtur se çfarë po bënte Zana-Hana, u trand si prej kllapie e tha:
- Motër, më fal se me këtë shpërthim të papritshëm gazi të stërpika edhe ty...
- Më kënaqe e më gëzove, o, vëlla, he ti qeshësh gjithmonë. – Tha Hana buzagaz e shtoi: - A nuk vërejte se bashkë me ty qeshën edhe Kreshtat e Bardha?
- Kreshtat e Bardha, the?! Qeshkan bjeshkët?!

- Po, o, vëlla! Kur qesh ti, brenda teje krijohet një proces kimik, i cili shpërbën helmet dhe ajo frymë merr malet, bjeshkët, fushat e luginat e atdheut...

- Aq fuqi paska gazi, motër?

- Gazi i vërtetë është bashkëdyzim i energjisë me dashurinë e gjithësisë, prandaj edhe ka efekt shërues e forcues...

- Po vaji?

- Vaji është lirim nga helmi i zemrës...

- Domethënë, qenka mirë edhe kur qeshim edhe kur qajmë?...

- Mirë është edhe kur qeshim edhe kur qajmë edhe kur hamë me shije.

Vazhdo të hash përseshin! – tha Hana.

Albi, shikoi me evari motrën e vet të gjirit Zanë-Hanën dhe mbushi lugën e rinisi të hante. Hana e shikonte duke qëndruar pip në këmbë, me duar të paluara para vetes si të ishte nuse. Kjo pamje i ra në sy Albit. Ai, kapërdui sasinë e përseshit që kishte në gojë e iu drejtua me butësi vëllazërore:

- Përse moj motër e dashur po rri ashtu si nuse para meje? As mosha, as cilësia jote nuk e kërkojnë një sjellje të tillë nga ti...

Zana-Hana, vetëm sa u prirë në gaz, mori frymë thellë e tha:

- Ah, o, vëllau i motrës, ti tashmë e di se ne zanat jemi mishërim, trupëzim, shfaqje fizike njerëzore e dijes, vetëdijes dhe dashurisë sonë kombëtare. E, kush më mirë se ne mund ta dijë dhe e di vlerën tënde? Ti, nuk e di dhe nuk mund ta marrësh me mend se sa jemi gëzuar ne se, më në fund ia arritëm që, deri më sot, të paktën njëri nga fisi i prometejve ka arritur të bashkëdyzohet me dijen, vetëdijen e dashurinë tonë kombëtare. Ne jemi gëzuar pa masë jo vetëm për ty, por ne jemi gëzuar se e dimë që pas teje nuk do të vonojë dhe numri i të këtillëve si ti do të rritet, do të shumëzohet dhe kombi ynë do të zgjohet e do të shpëtojë përgjithmonë nga narkoza e nga hipnoza e mallkuar politike...Prandaj gëzimi ynë që me ty po fillon pranvera jonë e zgjimit kombëtar nuk ka fund...

- Vallë, kaq i rëndësishëm qenkam unë? – tha Albi me ironi.

- Ti, vëlla i motrës, je i rëndësishëm si kumtar, si paralajmërues i një procesi që në mënyrë të pandalshme po vjen.

- Paj, ku po e dini ju këtë? – pyeti Albi me mosbesim.

- Paj, po tregojnë vetë ata që po frikohen aq fort nga përfshirja prej këtij procesi.

- Si, më fal motër, por unë nuk e kam të qartë?

Zana-Hana, qeshi për aq sa zbuloi dhëmbët e bardhë margaritar. Ajo tha:

- Shumë lehtë është për të kuptuar këtë të vërtetë. Pa shiko një herë se me çfarë ngulmimi, me çfarë angazhimi, me çfarë forcash e energjish janë duke u munduar, të gjithë, për të ngulfatur lëvizjen tënde për liri, drejtësi, barazi e humanizëm. Shiko ti, një herë, vëllau i motrës, se me çfarë pasioni, me çfarë

pedanterie, me çfarë saktësie, me çfarë afshi dhe me çfarë paturpësie janë duke u përpjekur që të mbysin lëvizjen tënde paqësore...

- Si duket lëvizjet paqësore janë më të rrezikshme se sa lëvizjet luftarake...- ndërhyri Albi duke lënë lugën mënjanë...

- Ke të drejtë. I kishte pas treguar gjyshja Zanë, nënës Zanë për lëvizjen e krishterimit. Mbi bartësit e lëvizjes krishtere ishin ushtruar të gjitha mizoritë e mundshme, deri te djegiet për së gjalli, por kot...

- Mirëpo, - Albit i dolën si në jermi fjalët – pasi që ai perandori romak pranoi krishterimin, çfarë ndodhi?

Zana-Hana, largoi me rrëmbim në të dyja anët flokët e gjatë e tha me gjysmë zëri:

- Paj, ndodhi që krishterimi hyri nën sjetullën e pushtetit dhe pas një shekulli u bë edhe vetë pushtet...

Albi, goditi me aq forcë tavolinën plastike sa që pjata me përsesh kërcëu përpjetë dhe tha me dëshpërim:

- Dhe erdhi situata deri aty sa që edhe vetë kisha katolike nisi të digjte mbi turrë të druve ata që ia rrezikonin pushtetin. A nuk të duket pak si tepër e çuditshme kjo punë, motra Hanë?

- E çuditshme nëse gjërat shikohen sipërfaqësisht, por nuk kishte si të ndodhte ndryshe nëse gjërat shikohen thelbësisht...

- Përse, motër, ku ishte gabimi?

- Gabimi ndodhi në momentin kur kisha u bë pushtet...

- Nuk e kam të qartë, motër...

Zana-Hana, mori lugën, ia dha në dorë Albit dhe duke i bërë me shenjë që të vazhdonte të hante përseshin i tha me dashuri:

- O, vëllau i motrës, pushteti është artikull që prishet dhe që të prish. Pushteti nuk mund të mbrohet nga prishja, sepse ndodhet pikërisht në duart e atyre që e hanë dhe e përdhosin...

- Motra ime, puna qenka shumë keq. – Ndërhyri Albi. – Të gjithë po e synojnë pushtetin. Si të shpëtojnë njerëzit nga vetvetja?

Zana-Hana qeshi me gëzim dhe vuri duart në bel. Albi, hapi sytë me një pikëpyetëse. Hana Tha:

- Formula është fare e thjeshtë dhe e lehtë, por fort e vështirë të zbatohet.

- Le të jetë e vështirë, por cila është formula?

- Formula është të gjithë ta marrin pushtetin mbi veten e tyre dhe të mos lejojnë që të tjerët të vendosin pushtet mbi ta. Porsa të ndodhë kjo pushteti e humb vlerën e vet. Sikurse ajri që ka vlerë aq të madhe e të pazëvendësueshme për jetën e njeriut, por meqë ka mjaft për të gjithë, atë nuk e kontrollon dot askush dhe ai mbetet i pa prishur dhe njerëzit nuk grinden e nuk luftojnë për të...

- Motër, - tha Albi duke marrë përsëri lugën në dorë,- vërtet, në të njëjtën kohë – lehtë e thjeshtë, por edhe vështirë dhe e ndërlikuar... Njerëzit e duan lirinë, por shumica pret që ajo të vijë prej dikah, prej dikujt...

- Ndërsa, - ndërhyri Zana-Hana, - pakica e ka të qartë se në fillim çdokush duhet ta lirojë vetveten. Me një fjalë, çdokush duhet të bëhet faktor i lirisë në mënyrë që lirinë e gjithanshme ta krijojnë vetë dhe që ajo të bëhet e të gjithëve...

Albi, prapë e la lugën dhe iu drejtua Zana-Hanës me pyetjen:

- E qartë motër, por si t'i shtyjme njerëzit që të hyjnë në procesin e liritimit të vetvetes? Shembulli vetanak është mësuesi më i mirë, mirëpo vetëm mësimi po shihet se nuk po mjafton...

- Janë edhe dy faktorë të domosdoshëm: dashuria e nevoja...

- Mirë, - tha Albi si me nervozizëm,- si t'ia fillojmë, si t'ia fillojmë?

- Shumë thjesht, o, vëlla! Duhet të fillojmë menjëherë të lirohemi nga faktorët më kryesorë e më të afërt që na robërojnë...

- Për shembull?

- Për shembull, më së pari duhet të lirohemi nga frika e vdekjes, sepse kjo frikë paralizon shumicën dërrmuese të njerëzve. E, dihet se vdekje nuk ka...

- Mirëpo, - tha Albi me zë të lartë, - është mosdija, është varfëria, është duhani, alkooli, droga, bixhozi. Krejt këta janë vargoj robërimi...

- Ashtu është, nëse nuk kemi mundësi të lirohemi me një goditje të madhe, atëherë le të fillojmë me goditjen më të lehtë dhe le të lirohemi nga vargoi më i hollë dhe le të përfundojmë me goditjen përfundimtare. Mirëpo, duhet të mos harrojmë se rruga drejt lirisë së plotë është e pafund dhe se ne lirinë absolute nuk do të mund ta sendërtojmë kurrë, sepse vetëm Zoti është absoluti dhe vetëm ai gëzon lirinë absolute.

- Përse kështu?-pyeti Albi padashtas.

- Sepse ne do të shkëpusim një nga një vargoit që na robërojnë sot, mirëpo koha e ardhme do të sjellë vargoj tjerë, të cilët gjithashtu, në njëfarë mënyre do të na e kufizojnë lirinë tonë. Por, - Zana-Hana tregoi me gisht pjatën përgjysmë të mbushur me përshesh para Albit e tha - ti, o vëllau i motrës, mbete pa e hëngër përsheshin!

- Ra përsheshi yt, motër e nga goja jote dolën gjithë ata margaritarë mendimesh. – tha Albi dhe rroku lugën me rrëmbim e nisi përsëri të hante përsheshin tashmë të ftohur.

- Mos harro, o, vëlla se edhe mendimet ecin e duhet të ecin me kohën. Prandaj nëse sot mendimet e mia modeste të duken margaritarë, pas një kohe të caktuar ata mund të mos jenë të tillë...

Albi vazhdoi të hante përsheshin duke përtypur mendimin:

“Sa më e madhe e më e thellë dija aq më e madhe e më e thellë modestia”.

Porsa Albi kreu së ngrëni përsheshin, Zana-Hana, mori pjatën e lugën, i lau, i vendosi në vendin e tyre e tha:

- O, vëllau i motrës!

- Fol, moj e lumja motër!

- Dita na kaloi në bisedë të ëmbël e të ngrohtë. Nuk kam fjalë për të falënderuar për besimin e ngrohtësinë tënde vëllazërore e për dashurinë tënde njerëzore. Nesër do të vijë te ti Marta, e cila është e dhënë pas ekonomisë. Pasnesër do të vijë te ti Mërkura, që është e dhënë pas historisë. Pasnesër do ta kesh këtu Ejten që është e dhënë pas matematikës, fizikës e kimisë. Të premtën e ka radhën Premtja që është e dhënë pas muzikës e letërsisë. Të shtunën memzi po pret që të vijë Shtunja e cila është e dhënë pas endokrinologjisë e imunologjisë. Të dielën do të vijë te ti Diella e cila është e dhënë pas futurologjisë. Nga secila prej nesh ti do të marrësh çfarë ti mendon se të duhet. Motra ime, Diella më tha se të njëmbëdhjetë perënditë janë duke u përgatitur me të madhe që të fillojnë nga java e ardhshme vargun e vizitave, të kontroleve dhe të bindjeve te ti. Për çdo ditë njëra prej nesh ka për të bërë një përshesh për ty që të duket se po han diçka. Tani unë po largohem sepse kam edhe punë të tjera që më presin. Nëna jonë është fort e dashur, por edhe fort e rreptë. Ajo kërkon shumë prej nesh...

Albi, për një hov u step, kapi zinxhirin, u ngrit nga karrigia dhe tha:

- Ah, ndarje e mallkuar!

- Pa ndarje nuk ka as bashkim o, vëllau i motrës! – tha Hana me butësi dhe i bëri shej Albit që të printe kah dera.

Albi doli jashtë para barakës së zezë. Hana doli pas tij dhe me të shpejtë doli para Albit, u ul në gjunjë, përqafoi këmbët e tij, pastaj u ngrit, u kërrus fort, puthi Albin në të dy faqet, u drejtua, ktheu shpinën e u zhduk. Albi, maje Kreshtave të Bardha, mbeti si i ngrafitur duke mos ditur se kah e çka të shikonte. Ajri i ftohtë që e prente në fytyrë e në trup e solli në vete. Kapi zinxhirin me dorë dhe u fut në barakën e zezë...

...thirrja e zanës-martë...

- O, Albi! Jam Marta. A do mysafir, o, vëlla?

Për Albin nuk kishte më befasi. Fërfëlloi tutje mbulesën e kuqe, rroku zinxhirin, u flugë kah dera e madhe e barakës e, në ecje e sipër iu përgjigj thirrjes me zë të lartë:

- O, ardhsh me të mira e me të mbara, moj motër!

Me gjithë përvojën dyditore, Albi, me të dalë para dera u step. Para tij qëndronte një bukuroshe me flokë të gështejmë deri në tokë, me vetulla të gështejme, me sy të gështejmë e të mëdhenj si dy pëllumba, me gojë të vockël e me buzë të holla, me gropëza në faqet e kuqe dhe në mjekër e me hundën shkabë. Ajo

shikonte Albin nga lart pa rrahur fare qerpikët me rremba. Pa qenë në gjendje të thoshte asnjë fjalë, Albi ia zgjati dorën. Ajo në vend se të qokej ra në gjunjë para Albit dhe me krahët e trupin e saj e mbështolli trupin e tij. Albit sakaq i erdhi goja.

- Ty të vika era borzilok, moj motër!

- Vërtet?! – tha Marta duke i vënë dorën mbi shpatull dhe së bashku hynë brenda në barakë.

Albi ngurroi paksa e i tha Martës:

- Ulu, motër ku të duash e mirëse erdhe!

- Ty, o, vëlla të takon kryet e vendit, ndërsa unë po ulem afër teje – dhe duke u ulur afër Albit, tha - më fal që u ula kaq afër teje, sepse nuk po ngopem duke të parë, mirëpo më thuaj, të lutem ku e gjete erën e borzilokut?

- Paj, ty, motër të vije era borzilok! E gjithë baraka u mbush me erën e borzilokut. Nuk e ndien ti?

Zana-Martë mohoi me kokë dhe duke buzëqeshur iu drejtua Albit:

- Prej nga ti, o, vëllau ynë i gjen këto erëra të mira te motrat tua? Hanës i kishe thënë se i vika era lule e Xhenetit, mua më thua se më vjen era borzilok, por çfarë ere i vinte nënës sonë?

- Nënës-Zanë i vinte era mjaltë.

- Pale, pale! Era mjaltë! Paj, ndoshta sepse ne, zanat ushqehemi vetëm me mjaltë...

- Nuk ia ndieni ju erën vetes?! – pyeti Albi me kureshtje.

- Jo! – tha Marta e shtoi, - ia ndien ti, erën vetes?

- Jo. – tha Albi duke rrudhur krahët.

- E, ty, paska të drejtë Hana, ty të vjen era vëlla...

Albi, qiti buzën mbi buzë e rrudhi krahët.

- Prandaj të përqafova krejt trupin dhe të mora erë me krejt forcën time.

–Marta qiti duart në parzëm e shtoi:- Qenka e vërtetë, era vëlla të çoka në hava!

Albi, mori paksa veten nga era dehëse e borzilokut e ndërhyri me ironi:

- Edhe pak e puna e erërave do të bëhet çështje politike...

- Çështje politiko-ekonomike! –tha Zana-Martë- dhe a e di përse, o, vëlla?

- Jo! – tha Albi duke rrudhur krahët.

- Sepse shqisa e të nuhaturit, jo vetëm që nuk është përkah rëndësia e fundit nga pesë shqisat, por është e para...

- E para! – e ndërpreu Albi, duke kërcyer nga vendi.

- E para, e para! Ja përse. Në politikë e në ekonomi po nuk i nuhate herët e me kohë, ngjarjet, gjërat, ndryshimet e proceset që sapo lindin e që janë duke ardhur do të vonohesh e, po prite derisa ata të shihen, të dëgjohen, të preken e meazall-llah edhe të shijohen, atëherë i lamë specat!.

- Ja, - tha Albi me dëshpërim, - këta ishin të parët tanë e, këta jemi edhe ne. Ata kanë menduar e shumica prej nesh edhe sot mendojnë se vetëm qeni duhet ta ketë të zhvilluar shqisën e të nuhaturit. He, ty të lumtë ajo gojë, moj motër, po fort më gëzove e, po fort më dëshpërove me këto fjalë!

- E, po, gëzimi e dëshpërimi shkojnë bashkë o, vëllau i motrës. Ti e di fare mirë këtë të vërtetë...

- Këtë po e di, moj motra ime, por nuk po e di përse ne mbetëm përjashtim nga rregulli i përparimit evropian?

- Mbetëm të fundit, o vëlla, sepse ishim të parët sa i takon humanizmit pas shpartallimit të matriarkatit. Dhe, si zëvendësim për ngrohtësinë e dashurinë e grumbullit, kur të gjithë silleshin rreth nënës dhe njiheshin sipas nënës erdhi bashkësia fisnore. Përveç kësaj, lindjes, forcimit e kohëzgjatjes së fisit i ndihmoi fort edhe konfiguracioni tokësor i Ilirikut. Në Iliri, me male të shumta e fort të pasura me të gjitha; të përshtatshme për jetesë e siguri; me shumë lumenj, lugina, fusha të pëlleshme, kullosa të pafund e, të gjitha këto të ndara e të copëtuara midis tyre me shumë kufij natyrorë; me dalje të gjerë e me shumë ujdhesa në det ishte kënaqësi e lumturi të jetohej. Të gjitha këto kushte e rrethana natyrore sikur ishin bërë e gjetur për një jetë të vetëmjaftueshme brenda mëshikëzës e pastaj lëvozhgës fisnore. Klima, atmosfera, rrethanat, kushtet e marrëdhëniet e brendshme fisnore dhe ato ndërfitnore nuk e bënë të nevojshme dhe për më tepër nuk lejuan që tek ilirët të lulëzonte, ose më mirë të themi të shpërthenin marrëdhëniet skllavopronare. Marrëdhëniet fisnore ishin aq të ngushta e aq të forta saqë, kishin pas treguar gjyshja e gjyshes sonë e gjyshja e gjyshes së gjyshes sonë, që menjëherë vihej para tundimit të pakalueshëm: kush kënd ta skllavëronte, kush të bëhej skllav e kush skllavopronar? Prandaj ilirët, kur me rastin e konflikteve ndërfitnore zinin robër, ata ose vriteshin atypëraty, ose lëshoheshin të ktheheshin në fisin e vet, ose i pranonin si anëtarë të fisit të tyre. Fiset ilire nuk ishin, të themi kushtimisht, të fekunduara nga virusi i skllavërimit të njëritjetrit as me mekanizmin e dhunës së luftës, as me mekanizmat ekonomike siç ishin borxhi, kamata, mosshlyerja e borxhit, që nënkuptonte prangimin e borxhmarrësit dhe shndërrimin e tij në skllav të borxhdhënësit. Prandaj ilirët, në të vërtetë, nuk patën qytete të mëdha as në kontinent, as buzë detit. Të gjitha qytetet, që ne tash i njohim dhe i quajmë si qytete ilire, në të vërtetë ato nuk ishin ilire aspak. Ato qytete, në të vërtetë qenë qytete ose helenë, ose romake. Ato ishin e mbetën në territorin e Ilirisë, mirëpo ato ishin themeluar, mbajtur e drejtuar ose nga helenët, ose nga romakët. Allahçe, atje kishte plot skllavërorë ilirë, ose punëtorë të lirë, të cilët, derisa ishin të tillë, ishin rrogëtarë, a punëtorë të skllavopronarëve helenë, ose romakë. Prandaj tek Ilirët mungoi nevoja e brendshme, ose shtrëngimi i brendshëm për t'u ndarë në klasa skllave e skllavopronare...

Zana-Martë, u ndal paksa, por Albi i tha krejt i kthjellët:

- Vazhdo, vazhdo, motër se jam duke të përcjellë me vëmendje...
- Po, po, por sikur e zgjata pak si tepër...
- Jo, jo, motër, ti po më nxjerr nga mjegulla. Vazhdo!
- Megjithatë, motra jote po ngritët e po ta përgatit një përshesh. Po pushoj edhe unë pak e pusho edhe ti pak...

Ajo u ngrit e shkoi tek orenditë e nisi të rangonte diçka. Albi nisi të fliste me Zanë-Martën nga larg:

- Sa thjesht po më flet, moj motër! Sa kuptueshëm po më flet, moj motër! Sa pa përtesë po më flet, moj motër!...
- Për çfarë përtese flet o, vëlla? Po, a jam motra jote, apo s'jam? Pastaj, a jetojmë për kombin, apo për çfarë jetojmë, ne?!
- Eh, sikur të gjitha gratë tona të ishin zana të malit! – thirri Albi.
- Ah, sikur të gjithë burrat e kombit tonë të ishin të fisit të prometejve! – iu përgjigj Marta duke përvëlur përsheshin me qumësht të valë dhe thirri, -Eja, vëlla, he ti ardhsh me të mira se u bë përsheshi me kollomoq të Dukagjinit e me qumësht të Kodërvërrinit.

Albi, me zinxhir në dorë u ngrit e erdhi e u ul pranë tavolinës së shtruar duke thënë si në gaz:

- Prapë erdhëm te përsheshi...
- Te përsheshi erdhëm, por nuk do të ndalemi te përsheshi. Ti do të hash, ndërsa unë do të vazhdoj atje ku e lashë...
- E, ku e le, motër?
- E lashë mu në kurriz të kodrës, atje ku ndahet pika dhe ku ndahen kufijtë.

Albi, vetëm kapi lugën e hapi sytë në drejtim të Martës e cila, si Hana dje, qëndronte pip në këmbë para tavolinës së Albit, me duar të paluara para vetes si nusët. Ai, mbushi gojën përshesh e mendoi:

“I njëjti brumë, e njëjta shkollë, vetëm stilet po ndryshojnë paksa“.

Ajo, nisi të fliste urtë e butë:

- Mbetëm te pika kryesore: përse ilirët nuk deshën dhe nuk qenë të detyruar që të krijonin shtetin e tyre të fortë - Ilirinë? Helenët e romakët kishin hyrë thellë në sistemin e skllavopronarisë. Ata merrnin mbipunën e skllavëve dhe me atë mbanin ushtrinë, policinë dhe administratën e tyre. Me mbipunën e skllavëve mbretërit e perandorët e helenëve dhe të romakëve mbanin në oborret e tyre dijetarët, poetët, shkrimtarët e filozofët e kohës...

- Edhe budallenjtë e oborrit. – ndërhyri Albi me gojën plot përshesh.
- Po, pra! Edhe budallenjtë edhe falltorët, edhe magjistarët edhe laviret edhe dreqin e të birin...Mirëpo, ilirët nuk i patën skllavërit. Ata, vetë punonin dhe mbanin veten e fëmijët. Kaq u mjaftonte. Merreshin nga pak me hajni e me plaçkitje, mirëpo me hajni e plaçkitje nuk mbahet shteti...

- Të lumtë goja, moj motër, se ma bëre pasqyrë Ilirinë! – tha Albi duke lënë lugën...

- Jo, jo, - tha si duke urdhëruar Marta, - lugën mos e lësho, por vazhdo të hash he, ty, të bëftë mirë përsheshi!

Pasi që Albi përfshiu tërë përsheshin dhe pasi që Zana-Martë lau pjatën e lugën dhe i vendosi në vendin e tyre i tha Albit me butësi:

-A dalim, o, vëlla atje ku ishim?

- Dalim - tha Albi duke tërhequr zvarrë zinxhirin, la kuzhinën e kaloi në pjesën tjetër të barakës dhe u ul në krye të vendit. Marta, me dy lëvizje të shpejta hodhi flokët përshpinë, u ul përballë Albit dhe e pyeti:

...më thuaj o, vëlla, a të krenohemi me të parët tanë...

- E tash, më thuaj o, vëlla, a të krenohemi me të parët tanë të cilët ishin aq të mirë dhe që nuk deshën ta poshtëronin njëri-tjetrin, nuk deshën ta skllavëronin njëri-tjetrin, nuk deshën ta shfrytëzonin njëri-tjetrin, apo të turpërohemi me ta që mirësia e tyre bëri që ne të mbetemi të fundit e Evropës?

Albi u step dhe iu murr goja. Ia nguli shikimin Martës e cila qëndronte e qetë, me duar në prehër dhe priste përgjigjen. Edhe sytë si dy pëllumba të Martës prisnin me ngulm përgjigjen. Pritja u zgjat më shumë sesa do të ishte normale. Më në fund, Albi hapi me zor gojën dhe mezi tha:

- Motër, me këtë pyetje më ke zënë fort ngushtë. Por, meqë unë jam njeri, që nuk dorëzohem kurrë, do t'i përgjigjem pyetjes sate ashtu që të duket se nuk e mora vesh mirë pyetjen tënde...

- Pa, he, vëllau i motrës!

- Unë krenohem me të parët tanë që, pavarësisht nga përmbytjet e gjata dhe superiore, as nuk u romanizuan të gjithë, as nuk u sllavizuan të gjithë e as nuk u turqizuan të gjithë...

- Ah, vëllau i motrës! – thirri Marta duke rrahur shuplakët e shtoi: - Ke dalë nga ngushtica me shkathtësi të madhe. Me këtë, ti, në të vërtetë, në një mënyrë fort origjinale, iu përgjigje edhe pyetjes sime origjinale. Të kaluarën, ne, nuk mund ta zhbëjmë, por për mbetjen e të parëve tanë, pikërisht falë mirësisë së tyre, jashtë proceseve shoqërore-ekonomike të kohës, as nuk mund të krenohemi, as nuk mund të turpërohemi. Ajo që një zbrazësi, një vakuum që forcon rregullin e përgjithshëm të shoqërisë evropiane...

- Por, çfarë të themi, motër e dashur, për vakuumin më të ri që na e la digresioni i fazës së diktaturës komuniste në zhvillimin shoqëror-ekonomik të kombit tonë? – tha Albi i qejflisur nga që iu lirua goja.

Zana-Martë, u mendua paksa dhe shtoi me një sasi dëshpërimi në zë:

- Po, ke të drejtë vëlla. Faza komuniste e ecjes sonë e pengoi në mënyrën më drastike lindjen, rritjen e zhvillimin e klasës kapitaliste brenda kombit tonë. Dhe kur dihet se klasa kapitaliste është bartësja kryesore dhe më e rëndësishme e idesë dhe vetëdijes kombëtare brenda popullit, atëherë është e qartë përse ne edhe në këtë çështje thelbësore ende jemi fort të sakatosur...

- Fjalët e tua janë plotësisht të sakta, motër. Sot, pas dështimit katastrofik të projektit të komunizmit në raporte globale e parciales, në hapësirën tonë po na krijohet një klasë e egër, e vonuar kapitaliste, e cila e ndodhur nën rrethimin e kapitalizmit fort të zhvilluar botëror, nuk po ka nge që të zhvillohet në mënyrë organike e shkallë-shkallë, por po zhvillohet me hope e me theqafje të rrezikshme që po i kushtojnë fort shtrenjtë ekonomisë së popullit e po pengojnë dukshëm kristalizimin e vetëdijesimit tonë kombëtar....

Zanë-Martës i qeshi fytyra dhe sytë sikur i qitën shkëndija nga gëzimi. Ajo, me të dy duart e veta kapi dorën e djathtë të Albit, e puthi me butësi e tha:

- Po gëzohem shumë, o, vëlla që ti, në fushën e ekonomisë nuk paske çfarë të mësosh shumë nga unë. Vetëm ndoshta duhet të ta përkujtoj e të të porosis që të mos harrosh kurrë se prapa të gjitha lëvizjeve politike, qofshin ato të mëdha, apo të vogla, gjithmonë fshihen interesat ekonomike. Nesër e ka rendin motra ime Mërkura. Ajo është e flaktë pas historisë e mezi po pret që të piqet me ty. Unë tash po largohem, - tha Marta duke u ngritur në këmbë dhe duke i bërë me shenjë Albit që të printe kah dera. Atje jashtë Albi kapi duart e Martës dhe i puthi. Ajo u ul në gjunjë dhe përqafoi trupin e Albit. Pastaj, vrik u ngrit në këmbë, ktheu shpinën dhe u zhduk në ajri. Albi, shtrëngoi fort zinxhirin në këmbën e vet, u kthye ngadalë dhe hyri brenda duke rrapëlluar fort derën e madhe të barakës.

...thirrjet e hershme të zanave të mërkurën...

Albi, ndarjet i përjetonte fort rëndë, kurse takimet me zanat e malit i priste me gëzim fort të madh. Këtë të mërkurë nuk priti thirrjen e orës dymbëdhjetë, por u ngrit që herët, në orën shtatë të mëngjesit dhe ashtu ulur po rikujtonte bisedat e takimet e kaluara e po mendonte për takimin e sotëm me Zanën-Mërkurë, historianen, të cilën do ta takonte për të parën herë.

Pikërisht në orën tetë, ndërsa Albi kishte kapur me dorë zinxhirin dhe po lozte me të u dëgjuan disa zëra të gëzueshëm grash para derës së barakës. Njëra tha:

- Thirr ti!

Tjetra tha:

- Thirr ti!

E treta tha:

- Jo, po thërrasim që të tria përnjëherë...

Albi, ashtu si ishte me zinxhir në dorë, me shpejtësi të rrufeshme hapi derën e madhe dhe u gjet para barakës. Të tria zanat, pushuan fjalët dhe vrik ranë në tehat para këmbëve të Albit. Nisi Albi e po i shikonte me radhë. Të parës, leshverdhë e sykaltër i tha:

- Cila motër je ti?

- Unë jam Mërkurja. - u përgjigj ajo dhe pasi që ia puthi Albit dorën, ia puthi edhe këmbët.

- Po ti, cila motër je? – i tha Albi tjetrës leshkuqe e sykuqe.

- Unë jam Ejtja.- tha ajo duke përçafuar këmbët e Albit.

- E, ti je sigurisht motra Premte – iu drejtua Albi asaj me sy të shkruar e flokë të përhimët...

- Po, unë jam Premtja. – tha ajo dhe rroku me të dy duart kokën e Albit dhe e puthi në të dy faqet.

Ato ende qëndronin të ulura në tehat me shikim të përqendruar kah Albi. Albi bëri dy hapa në të majtë dhe u ndal para Mërkurës. Mori frymë thellë e pas pak tha:

- Era menekshe...

Pastaj bëri një hap në të djathtë. U ndal para Ejtës e mori frymë thellë. Pas pak tha:

- Era jargavan...

Albi bëri edhe një hap në të djathtë e u ndal para Premtes. Edhe këtu mori frymë thellë e tha:

- Era shebojë...- Pastaj ngriti shikimin kah qielli si pasqyrë e tha:

- O, Zot i madh! Ty të qofsha falë, që ma gëzove zemrën! Maje këtyre kreshtave, midis kësaj bore e mbi këta akuj m'i çove tri zana, tri motra e tri lule dhe ma qetësove shpirtin!.. Pastaj, ai iu drejtua tri zanave: - Mirë se erdhët motrat e mia dhe ejani të hyjmë brenda. -Ato, pa fjalë, vrik, u ngritën në këmbë dhe e ndoqën Albin mbrapa. Ato po qëndronin në këmbë pa ditur se si do uleshin. Albi, duke kaluar në pjesën e kuzhinës mori në dorë karrigen e vetme e u tha tri zanave:

- Motrat e mia të dashura, ju uluni mbi shtrojën lart, kurse unë po ulem në karrigen përballë jush...

Të tri zanat u shikuan ndërvete dhe bënë ashtu si u tha Albi. Ai u ul i fundit në karrigen, që ishte tamam për të dhe çeli muhabetin:

- E, pra, motra, mirë se erdhët dhe mirë se u solli Zoti!

- Mirë se të gjetëm, o, vëllau ynë! - thanë ato njëzëri.

- Unë prisja motrën Mërkurë, ndërsa ju erdhët tri! Çfarë ndodhi kështu?

Foli Mërkura:

- Diella, motra jonë më e reja, na njoftoi se perënditë sikur nuk janë duke u marrë vesh midis tyre se si të vijnë te ti. Të gjithë po insistojnë që të vijnë te ti së bashku...

- Përse ashtu?! – shprehu Albi habinë e vet.

- Sepse, - vazhdoi Mërkurja – si duket nuk po i besojnë njëri-tjetrit. Plani paraprak ishte që të vinin një nga një te ti duke filluar nga Balena, Ariu, Kulshedra, Gjeli, Hunija, Dielli, Latini e kështu me radhë të njëmbëdhjetët...

- Pale, pale! – bëri Albi dhe shtoi: - Po, a është kjo situatë e krijuar më e mirë për ne, apo më e keqe?

- Diella po thotë se është më e mirë, sepse autoriteti yt dhe i Lëvizjes sate midis turmave dhe në qarqet ndërkombëtare, përkundër angazhimit maksimal të perëndive e të dallkaukëve të tyre, dita-ditës po rritet.

- Pale, pale! – bëri Albi e shtoi:- Edhe çfarë më tutje?

- Propozimet e projektet po i ndërrojnë çdo ditë. Të gjitha mundësitë janë mbi tavolinë. Ka mundësi që të vijë te ti vetëm tre të mëdhenjtë. Ka mundësi që të të bartin ty prej këtu e të të çojnë në ndonjë vend ku të ishte një sallë e madhe e ku do të kishte vend për të gjithë perënditë përnjëherë...

- Eu, eu! – bëri Albi duke luajtur kokën.

- Prandaj, ne të tria u ngutëm e erdhëm sot.

- Mirë paski bërë! Çkado që të ndodhë le të ndodhë, por vetëm për kombin tonë le të bëhet mirë. Po, çfarë po thonë ata në Tiranë?

- Ata po i përsërisin ato që po i thonë perënditë... – prapë foli Mërkurja.

- Sikur ata, ashtu po bëjnë edhe ata në Ulpianë. – ia ktheu Albi dhe shtoi buzagaz e duke iu drejtuar Mërkurës: - Po, moj motër, më thuaj të lutem, a do të hyjnë të gjitha këto në historinë tonë, apo dallaveraxhinjtë do të arrijnë që të gjitha këto t'i mbulojnë me harresë?

- Po i mbulojnë e do t'i mbulojnë, mirëpo harresa është sikur mjegulla, qëndron do kohë, por më në fund ajo çohet e gjërat dalin përfushë. – tha Mërkurja dhe goditi gjurin e vet me grusht.

- Unë, motra nuk jam historian, por më duket se ç'prejse u formuan shtetet e para të gjitha luftërat e konfliktet i nxitën dhe i bënë egot në pushtet...

- Oh, lum bëftë motra për ty e të lumtë ajo gojë se me të parën fjalë ia qëlllove thelbit të problemit! – klithi Mërkurja.

- Mërkurja pati da mendjen që të ta bënte ty këtë pyetje, por ti, o, vëllau ynë, e vure vetë pikën mbi i... – Ndërhyri Premtja me zjarr.

- Me dijen tënde ti, o, vëllau ynë, po na gëzon pamasë. – Tha Ejtja.

- Mos u ngutni të më lavdëroni, - ndërhyri Albi buzagaz, - se kjo nuk është dija ime. Këtë e kam mësuar nga Maharishi dhe nxënësi i tij Çopra, dy dijetarët e mëdhenj hinds. Ata e shpjegojnë shumë qartë fenomenin e egos.

Të tri zanat vetëm ia hodhën nga një shikim njëra tjetrës, por nuk bëzanë fare. Albi vazhdoi:

- Egot, nuk janë të natyrshëm. Ata fshihen prapa maskave. Ata luajnë rolin e babait, rolin e dashnorit, rolin e drejtorit, rolin e gjeneralit, rolin e kryetarit etj. etj. Vetëm rolin e njeriut të natyrshëm nuk e luajnë dot, sepse kanë dëshirë që të

dominojnë mbi të tjerët. Pikërisht sepse kanë dëshirë që të dominojnë mbi të tjerët, ata nuk i besojnë askujt, ata dyshojnë tek të gjithë. Prandaj mundohen të kontrollojnë gjithkë dhe kurrë nuk ngopen me informata. Prandaj bëjnë ç'mos që të vendosin kontrollin mbi të gjithë, afër a larg qofshin. Këta shtien në duar të veta të gjitha levat e rëndësishme të shoqërisë: bankat, mediat, industrinë e armatimit, industrinë e zbavitjes, bastoret e të gjitha llojeve të mundshme, etj. Të gjitha. Deri edhe sportet, artet, veshmbathjet i kanë komercializuar dhe i kanë shndërruar në hipnoza të përgjithshme shoqërore. Këtë e bëjnë me qëllim që qytetarët të hyllen në rrugë të gabuara, që ata të merren me vetveten dhe që t'i lënë egot të pakontrolluar dhe që nga piramidat e tyre të llojlojshme pushtetore të mund të manipulojnë me qytetarët e hipnotizuar. Këta kanë arritur që të indiferentojnë e të depolitizojnë në shkallë aq të madhe qytetarët sa që ka vende ku në zgjedhjet politike të marrë pjesë pakica e qytetarëve në një përqindje vetëm prej 20-25%. Këta ego janë ata që shkaktojnë konfliktet e vogla e të mëdha, këta shkaktojnë luftërat e vogla e të mëdha. Këta luajnë me fatin e individëve e të popujve si me goglat e bilardos...

Albi u ndal dhe këtë ndërkohë Mërkurja e shfrytëzoi që të ndërhynte në bisedë.

- Ne, nëna e motrat i përcjellim me shumë kujdes të gjitha burimet e dijes që veprojnë në gjithë rruzullin tonë, ndër këto edhe –Universitetin e Hapur të Maharishit, që jepet përmes televizionit 24 orë rresht dhe këtë në shumë gjuhë të botës, përveç në gjuhën tonë. Çdonjëra prej nesh është e specializuar për një fushë të caktuar, mirëpo ne, rregullisht shkëmbejmë dijet tona midis nesh. Ne po gëzohemi shumë që ti, vëllau ynë, ushqehesh nga burime të shëndosha dhe të paanshme të dijes...

- Unë, - ndërhyri Albi, - kërkoj ndjesë që paskam shpenzuar kot kohën tuaj, por me këtë rast nuk po durohem pa e pyetur motrën Ejtë, meqë kjo është e dhënë, nëse nuk kam harruar, pas matematikës, fizikës e kimisë...

- Nuk paske harruar fare, o, vëlla! Vetëm pyet! – ndërhyri Ejtja me gëzim.

- Ai që nuk e njeh si duhet një fushë as nuk di të bëjë as pyetje me mend, por unë nuk jam nga ata që rrudhen e mundohen të fshehin padijen e tyre...

- Fol, fol! – tha Ejtja.

- Derisa unë kam pasur nge që të përcjell atë fushë, gjatë përpjekjeve për të zbërthyer atomin në pjesët e veta përbërëse, shkencëtarët kishin arritur që të izolonin 21, si u thonë, grimca-valë brenda tij. Ka ecur puna në këtë drejtim?

- Ka ecur, ka ecur, mirëpo hulumtimet në fushën e pafund të atomit nuk kanë për të përfunduar kurrë.

- Përse, vallë?! – pyeti Albi me habi.

- Sepse, ajo që shkencëtarët për shkaqe praktike e quajnë grimcë-valë, nuk është as grimcë, as valë, por është varg i pafund i energji-informatave dhe e *FUNDIT DUHET TË JETË SHPIRTI...*

- Dhe? – bëri Albi.

- Dhe, njeriu nuk do të mundet kurrë të zbulojë shpirtin e vet, sepse edhe vetë është pjesë e shpirtit kozmik...

- E ne, ç'bëjmë? – pyeti Albi duke ngritur duart lart.

- Ne, - tha Ejtja duke buzëqeshur, - *BËHEMI E ZHBËHEMI*, sikurse që edhe e tërë gjithësia që *BËHET E ZHBËHET...*

- Po të mos ishte puna për afate kohore prej dhjetëra miliarda vjetësh, kjo e vërtetë do të ishte fort dëshpëruese dhe do të duhej që të fillonim të qanim...- tha Albi duke rrahur shuplakët e duke qeshur...

- Jo, o, vëllau ynë, përse të qajmë kur mund të këndojmë. – ndërhyri Premtja e vazhdoi me pyetjen: - Të ka marrë malli për ndonjë këngë?

Të gjithë sa ishin ia plasën gazit. Nga gazi i fuqishëm kumboi baraka e zezë... Kur u fashit gazi të tri zanat drejtuan sytë e tyre të mëdhenj kah goja e Albit. Për disa çaste qetësia pllakosi barakën...

- Eu, motra Premte, sa ngushtë më zure!

- Nuk e ditke asnjë këngë? – pyeti Premtja.

- Jo, di mjaft këngë, por...

- Po, për cilën këngë të ka marrë malli që ta dëgjosh? – ndërhyri Premtja me padurim.

- Paj, - filloi Albi, - duke nxjerrë fjalët zhagaz, - paj, më ka marrë malli për të dëgjuar këngën e Pjetër Gacit "*PËR TY ATDHE*", por kush do ta këndojë si Gaço Çako?...

Të tri zanat këmbyen shikimet midis tyre, ndërsa Premtja vrik nxori nga shoka e bardhë që ia mbështillte permjetin një kuti të vogël e tha me gëzim:

- Mos ki merak, o vëllau i motrës, për këtë ka menduar motra jote.

Dhe, pasi që shtypi disa susta, në barakën e zezë, maje Kreshtave të Bardha, jehoi kënga... Albi, pa vetëdije, u ngrit në këmbë dhe mori qëndrim gatitu. Ashtu vepruan edhe tri zanat. Atij, nisi fytyra t'i skuqej e t'i nxehej, dikur filluan t'i dridheshin edhe buzët derisa filluan t'i rridhnin edhe lotët...Kur përfundoi kënga, Albi erdhi në vete dhe duke u ulur në karrigen e vet i shkuan sytë tek sytë e tri motra-zanave të veta. Ai u prek fort që u bë fajtor për këtë gjendje të tendosur. Por, kujt i takonte përveç atij që ta shqyente këtë tis pikëllimi. Mori forcë e duke buzëqeshur me zor tha:

- Edhe zanat qajkan?!

- Kur qan vëllau atdhetar, - tha Mërkurja, - motrat qajnë edhe kur janë zana...

- Por, desha të ju them se si po e nuhas, takimeve tona të mrekullushme sikur po u vjen fundi...

...gëzimi i pafunf i Albit...

- Jo! – tha Premtja duke kërcyer nga vendi. – Takimet tona, tash e tutje, nuk do të ndërpriten kurrë më...

- Mirë e ka Premtja, - ndërhyri Ejtja e shtoi: - Vështirësia më e madhe dhe kjo vonesë e kobshme mijavjeçare ka qenë që të vendoset besimi, kuptimi dhe vërtetësia midis ëndrrave e zhgjëndrrave, midis jomateries e materies, -midis nesh. Tash e përgjithmonë, kudo që të ndodheni në vetmi ti e të besuarit e tu, dikush prej nesh do të jetë aty. Bashkëpunimi ynë i përjetshëm do të bëjë që shumë shpejt të krijohet kombi ynë me vetëdijen e tij të fortë dhe mijëvjeçarët e humbur kemi për t'i rikthyer shpejt...

Albi u bë sy e veshë dhe sikur nga një çunak u rrit. Ejtja vazhdoi:

- Vetëm ti dhe të besuarit e tu duhet ta keni parasysh që herëpashere të qëndroni kalli vetëm e pa dëshmitar, pavarësisht në qytet a fshat dhe do ta keni praninë tonë të plotë e të vazhdueshme...

- Tash e tutje, populli ynë e nesër kombi ynë, -ndërhyri Mërkurja-, nuk do të jetë më si kojrrilat në mjegull, si mizat pa krye, si bletët pa amën e tyre...

- Domethënë, – ndërhyri Albi fort i ngashëruar,- perënditë paskan gabuar që më izoluan dhe që më sollën maje Kreshtave të Bardha?

- Po! – tha Mërkurja. – Kanë gabuar fort që pikërisht ty që pate kapacitet të besosh e të kuptosh dhe të vendosësh këtë kontakt midis nesh, të izoluan këndeji pari duke bërë të mundur lidhjen tonë të domosdoshme... Ti, vëllau ynë, si duket ende nuk je duke kuptuar se çfarë gjëje madhështore ka ndodhur në hapësirën e Albërisë. Nesër do të vijë te ti Shtuna e Diella. Shtuna, tashmë e di se është e dhënë pas mjekësisë, ndërsa Diella pas futurologjisë. Gjirin e nënës sonë dhe ndihmën e Shtunës e të Diellës keni për t'i pasur gjithmonë. Tash e tutje, ti, vetëm qesh e bëhu i mirë me të gjithë...

- Edhe me ata që më burgosin dhe që eksperimentojnë kaq vrazhdas me popullin tim?! – pyeti Albi, duke u ngritur në këmbë nga sikleti.

- Po, vëllau ynë, - vazhdoi Mërkurja, - pikërisht me ata të qeshësh dhe ta dish se ata janë miqtë tanë të vërtetë. Ata janë duke punuar për ne pa ditur se po punojnë për ne. Ti e ke thënë edhe vetë me qindra herë se njerëzit tanë për politikë janë kalamaj. Prandaj ata mund të edukohen e shkollohen vetëm në këtë mënyrë. Kjo është teknologjia e përpunimit të popujve që kanë fuqi e energji të hatashme, por që nuk kanë dije e vetëdije politike. A nuk u ke thënë ti vetë shokëve të burgut si edhe jashtë burgut se po të mos e merrte pushtetin Millosheviçi Jugosllavia ende nuk do të zhbëhej? Vallë, a s'jemi ne të gjithë faktorë veprues në duart e Zotit për

përparimin e njerëzimit. Ti pak më parë, vëllau ynë, i përmende dhe i shave egot. Ata, nuk do mend janë të këqij, mirëpo po të mos ishin egot edhe sot e kësaj dite njerëzit do të ishin në matriarkat e në kohën e gurit...

Albi u ul, u qetësua në karrigen e vet dhe nga gëzimi i madh se si i erdhi e u tall:

- Moj motrat e mia, a jam unë, këtu duke biseduar me zanat e malit, apo me filozofët e dynjasë?

Të gjitha ia plasën gazit. Edhe Albi pas tyre... Pasi ra fasha në barakë, Premtja tha:

- Prit, ti, prit, vëllau ynë sa të piqesh nesër me Diellën e do të dëgjosh filozofi e mbi filozofi!...

- Motra, - foli Mërkurja duke vështruar të motrat – edhe pak e duhet të ikim, por cila prej nesh, para se të shkojmë, po ia përgatit një përsesh vëllaut tonë?

- Jam më e vogla dhe mua më takon. – Tha Premtja, u ngrit në këmbë dhe u drejtua kah pjesa e kuzhinës...

...A ka burra në këto bjeshkë, more, hej?!..

Nga gëzimi i madh Albi nuk kishte fjetur tërë natën. Tamam sa e kishte marrë një kllapë, kur i erdhi në vesh një thirrje e thekshme si në malësi:

- A ka burra në këto bjeshkë, more, hej?!

“Do të jenë Shtuna me Diellën”. – mendoi dhe u përgjigj:

- O, ka more, ka! - Fërfëlloi mbulesën e kuqe, kërceu në këmbë dhe me zinxhirin në dorë hapri derën e madhe.

Çfrejt e lartë të borës kishin rrethuar barakën. Këndeje çfrejve, të ulura në tehjat e të buzëqeshura qëndronin dy zanat.

- Ngrehuni, ngrehuni! – u tha duke u bërë shenjë me dorë - Hyni brenda!- dhe vetë u flug i pari e ato pas tij. Pasi që u mbyll dera u bëri shenjë që të uleshin mbi trapazan dhe iu avit asaj me flokë të gështenjtë.

- Ti duhet të jesh motra Shtunë, apo jo?

- Unë jam vetë! – tha ajo duke mbështjellë Albin me krahët e vet.

- Albit i rrektoi zemra me forcë e tha:

- Ty të vika era trëndafili. – i tha Shtunës dhe iu qas Diellës. – Ti je, Motra Diellë që thirri malsorçe?

Ajo rroku kokën e Albit e puthi në të dy faqet e tha:

- Po, vëllau i motrës. Kështu thirreshin dikur të parët tanë, bjeshkë më bjeshkë...

Albi shikoi flokët e saj të zi futë, ballin e gjerë, nën të cilin vetullat zinxhirë mbulonin sytë fort të mëdhenj e të zi si nata, mori frymë thellë e tha:

- Ty të vika era ftua...

Dy zanat-motra, shkëmbyen shikimet, ndërsa Albi shkoi në pjesën e kuzhinës, mori karrigen e plastmasit dhe u vendos para Shtunës e Diellës. Ai vuri duart e vockla mbi gjunjë e tha:

- Njëpër burgjet e Serbisë kur më binte në dorë ndonjë roman i mirë dhe kur i afrohesha fundit, nisja të mërzitesha. Mendoja, përse ai libër nuk ishte më i gjatë?

- Jo, o, vëllau ynë, libri ynë, mos ki merak, nuk do të mbarojë kurrë. Sa të jetë jeta me jetue ne do të vazhdojmë takimet tona, por në vende të tjera...

- Mbase edhe shumë më të përshtatshme se këtu. – ndërhyri Shtuna e vijoi: - Këtë ta kanë thënë motrat tona dje. Ti, vetë duhet të zgjedhësh vetminë sa më shumë e sa më shpesh... Puna jonë është t'i shërbejmë kombit dhe njerëzimit liridashës...

- E di se jeni kuantë, por nuk po e di sesi ju motrat e mia, fituat aftësinë që të trupëzoheni dhe të merrni këto forma kaq të bukura dhe kaq dobiprurëse?

Të dy zanat-motra buzëqeshën, por Diella vazhdoi:

- Vëlla, mundësitë e Zotit, apo të Universit, krejt një, janë plotësisht të pakufishme. Në fillimet e veta njerëzimi na besonte dhe vepronte sipas porosive tona. Përndryshe si do të tejkalonin njerëzit ato rrethana e kushte tejet të vështira gjatë lëvizjes drejt zhvillimit e përsosjes së globit tonë dhe të njerëzimit në të. Mirëpo, gjatë pavarësimit të tyre nga natyra e egër njerëzit nisën gjithnjë e më pak të na besonin neve. Dikur, harruan fare se ne ekzistojmë. Prandaj ndodhën gjithë ato kataklizma, madje ato po ndodhin edhe sot.

- Mirë, mirë, motër, por si po ia dilni që nga kuantet të shndërroheni në materie e anasjelltas?

- Kjo është puna më e lehtë, o vëlla. E gjithë bota materiale e ka prejardhjen nga kuantet. Edhe trupi i njeriut është i përbërë nga elementet që ka toka jonë. Puna qëndron aty se ne jemi të bindura dhe kemi besëlidhjen me Zotin...

- Unë, nuk mundem. – tha Albi me dëshpërim.

- Jo, ti nuk mundesh sepse fisi yt që në fillim është përcaktuar për të qenë me njerëzit e në shërbim të njerëzve. A nuk është kështu?

- Ashtu është. – tha Albi dhe uli kokën.

- Mirëpo, Zoti i madh ka krijuar lidhjet e ndërmjetme me faktorët lëvizës të natyrës dhe të shoqërisë njerëzore. Këtë lidhje ne e kemi pritur shumë gjatë. Prandaj ne u gëzuam kaq fort kur hasëm në një njeri, i cili ka kapacitet që të lidhë materien me kuantet, si të ka thënë Nëna jonë, mbamendjen historike, dijen, vetëdijen me organizimin e trupave njerëzore në veprim. Ti je i pari, por nuk do të jesh i fundit...

- Më fal, motër se unë po kërkoj shumë prej jush, por meqë po e dini se nuk e kam për veten time ju nuk po zemëroheni në mua.

- Krejt çfarë i duhet kombit tonë në këtë moment është vetëdija e kristalizuar kombëtare. - tha Diella dhe drejtoi shikimin kah Shtuna, që dëgjonte me durim. Albi e kuptoi këtë shikim dhe iu drejtua Shtunës:

- Po, mirë motra Shtunë, a ka kapacitet populli ynë të sendërtojë proceset e endokrinologjisë dhe të imunologjisë?

- Nuk duhet këtu ndonjë kapacitet i madh për të kuptuar se çfarë po kërkohet. Qysh para disa mijëra vjetësh dijetarët e Lindjes e para disa qindra vjetësh ata të Perëndimit kanë thirr turmat që t'i ktheheshin natyrës. Mirëpo, kjo thirrje kaq e thjeshtë e kaq gjeniale për shkak të turrit të industrializimit hasi dhe po has në veshë të shurdhër. Por sot, gjërat po ndryshojnë shumë. Ndikimet e theksuara klimaterike për shkak të ndotjes serioze të atmosferës po bëjnë që edhe perënditë të rishikojnë qëndrimet e sjelljet e tyre. Njerëzit, gjithnjë e më shumë e më me vendosmëri po kërkojnë pastërtinë e natyrës, të ajrit, të ujit të tokës e të ushqimit...

Albi u tall me një ndërhyrje:

- Si duket ata për këto arsye më paskan sjellë maje Kreshtave të Bardha...

Të gjithë qeshën.

Albi kësaj here i foli seriozisht Shtunës:

- Vallë, motër, nuk të duket se me këto ndotje, perënditë kanë tejkaluar pikën që nuk ka më kthim prapa?

- Jo, sepse sot teknika ka përparuar aq shumë sa që po të shpenzoheshin gjysma e të hollave që harxhohen për armatim e për luftëra të panevojshme, do të krijoheshin mjete të afta teknike për mbledhjen e miliarda e miliarda tonëve të grimcave karbonike, sulfurike e të tjera në atmosferë e për të cilat do të mund të gjendeshin destinime produktive për njerëzit.

- Domethënë, krejt puna qëndruaka aty që perënditë të disiplinohen deri në atë shkallë sa që ata të vënë në rend të parë interesin e njerëzimit...

- Paj, po, o, vëlla, por edhe njerëzimi duhet të vërë interesat e njerëzimit para e mbi interesat e veta individuale e grupore..

- Vallë, do të arrihet kjo sa nuk është bërë tepër vonë? – pyeti Albi me një zë si të dëshpëruar.

- Në shikim të parë duket sikur kjo pikë është tepër larg, mirëpo ne, kurrë, kurrë nuk i shohim, as nuk do t'i shohim të gjithë faktorët që janë të pleksur brenda ligjeve të jetës që çojnë jetën përpara. Ka plot faktorë që ne, si njerëz që jemi, meqë shumica dërrmuese prej nesh shërbehemi vetëm me pesë shqisat tona, nuk i njohim, sikurse që nuk i njohim, bie fjala, ilaçet shërues, që i kemi fare pranë vetes, ndërsa robtohemi duke i kërkuar gjithandej botës së gjerë. – tha Shtuna me butësi të ëmbël.

Albi, me duart e veta të bardha e të vockla, fërkoj si me njëfarë nervozizmi fytyrën e bardhë e tha me një zë si të ngjirur:

- Motrat e mia të dashura, shpejt u mësova me ju, prandaj qysh tash kam filluar të mërzitem për kohën kur do të mbetem pa ju...

- Jo, vëlla! – kërceu Diella nga vendi e tha:-Ti, kurrë më nuk do të jesh pa ne! Ti gjithnjë do të na kesh me vete. Por - ajo u ndal paksa, mendoi e tha, - ti, me të vërtetë, aq shumë e aq fort u mësove me ne saqë harrove fare se kush jemi ne, në të vërtetë...

Albi, hapi gojën me habi dhe filloi të shikonte motrat-zana me pabesi. Ai tha:

- Domethënë, ju nuk qenkët ato me të cilat unë po bisedoj?!

- Edhe jemi edhe s'jemi. – ndërhyri Shtuna me shpejtësi.

- Kur të duhemi dhe do të kemi mundësi të të qasemi, - ndërhyri Diella me zë më të prajshëm, - ne jemi dhe do të jemi në këtë format që po na sheh, sepse në gjendjen tonë kuantike ti, nuk ke mundësi që të na shohësh...

- E qartë. – tha Albi me zë të qetë, pleksi gishtat e duarve dhe iu drejtua Diellës: - Mirë, motër, më thuaj të lutem, kah po shkojmë ne dhe bota?

- Ne, ende jemi në procesin e vonuar të kombësimit, kurse sa i takon botës çështja është ende amorge dhe e papërcaktuar...

- Po, pavarësia e Dardanisë kur do të bëhet?

- Do të ketë shumë lloj pavarësish për Dardaninë, por pavarësia e saj e vërtetë do të ndodhë atëherë kur populli i Dardanisë të piqet dhe ty, bashkë me ithtarët e tu do t'ju sjellë në pushtet...

- Atëherë, - tha Albi me dëshpërim, - me sa di unë kjo punë nuk do të bëhet aq shpejt ashtu si kanë dëshirë Dardanët...

- Dardanët, o, vëlla, dëshirën e kanë të madhe, por vullnetin e kanë ende të vockël. Kur ta rrisin vullnetin aq sa dëshirën do ta kenë edhe lirinë, pavarësinë e sovranitetin e plotë...

- Bah! – bëri Albi dhe mbylli gojën me të dyja duart.

Barakën e pllakosi një qetësi e pakëndshme. Zanat, Shtuna e Diella, këmbyen shikimet. Shtuna foli:

- O, vëlla, a ta përgatis një përshesh?

- Paj, - ia priti Albi si të zgjohej nga gjumi,- sikur u mësova me përsheshin e zanave...

Shtuna u ngrit e shkoi në aneksin e kuzhinës. Albi, sa për të çelur muhabetin pyeti:

- Motra Diellë, vallë, a shihni Ju ndonjë ndryshim midis perëndive?

- Ndryshimi qëndron në formën e veprimit e të rezultateve të veprimit. Në gjysmëshekullin e fundit perënditë e parasë u shtuan shumë dhe u bënë dominuese. Perënditë e dhunës, me anën e forcës thyejnë, shkatërrojnë dhe eliminojnë kundërshtarët e vet politikë e ushtarakë. Kurse perënditë e parasë përmes instrumenteve e mekanizmave financiare nxjerrin mbivlerën nga ato shtete e vende që janë ekonomisht inferiore dhe që kërkojnë ndihmë. Perënditë e dhunës

përdorin vetë, ose shesin armët e veta me para të gatshme, ndërsa perënditë e parasë, shesin kapitalin e vet financiar me kamata...

- Motra Diellë, meqë edhe pak ditë sikur do të shihemi pak si më rrallë, sepse adresa ime nuk do të dihet, ke ndonjë porosi për vëllaun tënd?

- Kam. – tha Diella. Kapi dorën e vockël të Albit, e mbështolli me të dyja pëllëmbët e saja të mëdha e tha butësisht: - Të gjithë, - edhe ata që të duan edhe ata që nuk të duan, ti, duhet t'i duash njësoj, sepse të gjithë janë pjesë e procesit, sepse të gjithë janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e tërësisë...- Ajo u ndal paksa e shtoi: - Pa plus e minus nuk do të kishte matematikë...

...aq shumë e do dijen saqë nuk turpërohet ta zbulojë padijen e vet...

- Aq shumë e dua dijen saqë nuk turpërohem të zbuloj padijen time. – tha Albi dhe pasi u kërrus, puthi me dhjetëra herë pëllëmbët e Zanë-Diellës e vijoi: - Nuk e kam të qartë, ku ta gjej atë dashuri për ata, që nuk na duan e nuk më duan?

Diella, përsëri me pëllëmbët e saj i mbështolli duart e vockla të Albit dhe pasi që i puthi me limonti, foli:

- Vëllau i motrës, meqë i takon fisit, i cili është përcaktuar që të flijohet për të mirën e njerëzve, atëherë duhet të jesh i gatshëm që të paguash çdo çmim. Dhe, ku do ta marrësh atë forcë e atë energji që të bësh një gjë të këtillë? Duke u bashkuar me energji-informatat e gjithësisë, duke u bërë pjesë e pandashme e gjithësisë kuantike. Universi çon përpara, drejt përsosjes duke ndarë, duke bashkuar, duke cakërruar e duke ngjizur të kundërtat e kundërthëniet...

- Tani jam edhe më larg nga të kuptuarit. – tha Albi duke mbuluar fytyrën me duar.

- Tash, me shembuj, do ta zbardhim këtë që duket si e turbullt. –tha Diella.

Albi luajti paksa nga vendi dhe gapërroi sytë. Zana-Diellë vazhdoi:

- Matriarkati, kur nëna ishte qendra e grupit, shënoi një përparim të madh, mirëpo pasi që arriti një shkallë të caktuar, shoqëria e tillë u lidh nyje, u ngujua dhe u ngulfat. Për të ecur përpara ajo shoqëri duhej që të shpartallohej e të kalonte në patriarkat me ç'rast baba u bë qendra e kreu i grupit. Edhe kjo shoqëri, ndonëse prore në luftë me natyrën, shënoi përparim të dukshëm, mirëpo edhe kjo shoqëri pas një periudhe u bllokua. Për të shpërthyer bllokadën shoqëria filloi që, në fillim, të ndahej në shtresa e pastaj edhe në klasa dhe arritëm deri te shoqëria skllavopronare. Marrëdhëniet në këtë shoqëri ishin fort të egra, mirëpo siguria e jeta e individit ishte larg më e mirë sesa gjatë bashkësisë primitive. – Zana-Diella u ndal e pyeti: - U mërzi vëlla?

- Jo, jo, po të përcjell me vëmendjen më të madhe.- tha Albi.

- Edhe shoqëria skllavo-pronare, me gjithë egërsinë e vet, shënoi përparim të madh, derisa pas një kohe të gjatë edhe ajo ra në krizë të madhe...

- Shkaqet e arsytet e krizave, të lutem? – ndërhyri Albi.

- Ja disa nga shkaqet e arsytet më kryesore: skllëvërit nuk i ruanin mjetet e prodhimit; skllëvërit nuk interesoheshin për zhvillimin e përsosjen e mjeteve të prodhimit; skllëvërit nuk ishin të interesuar për të shtuar e rritur prodhimtarinë; skllëvërit po vdisnin pa lënë pas vetes trashëgimtarë, sepse ata nuk kishin të drejtë që të martoheshin dhe si pasojë hapësira gjithnjë e më të mëdha tokash po mbeteshin të papunuara; për këto shkaqe kishte mungesë të madhe ushqimesh e prodhimesh tjera bujqësore. Prandaj, skllavo-pronarët u detyruan që të ndërronin marrëdhëniet skllavo-pronare në prodhim me marrëdhëniet feudale në prodhim, që solli një përmirësim të dukshëm të gjendjes së ish skllëvërve, të cilët fituan statusin e bujkrobërve dhe një përparim të hovshëm të të gjithë shoqërisë së asaj kohe. Ishskllëvërit fituan të drejtën që të kishin një copë tokë dhe shtëpi të vetën, të kishin të drejtë të martoheshin dhe të merrnin përqindjen e caktuar nga toka e punuar e feudalit, ose e bujarit. Skllavi, në këtë mënyrë u bë bujkrob. Ai, nuk mund të qitej e të shitej në Pazar, por mund të shitej vetëm së bashku me tokën; ai nuk mund të rrehej e keqtrajtohej pa ndonjë faj të madh. Domethënë bujkrobi, në këtë mënyrë, u motivua shumë që të punonte më shumë, të ruante e të përpiqej për përsosjen e mjeteve të prodhimit dhe të krijonte trashëgimtarë...

Albi, nga nervozja fërkoj duart, por Zanë-Diella ndërhyri shpejt:

- Nëse nuk u lodhe dhe nëse po më përcjell me vëmendje, po e sheh se si, në periudha të ndryshme, shtypësit e të shtypurit, shfrytëzuesit e të shfrytëzuarit, skllavopronarët e skllëvërit, feudalët e bujkrobërit jo vetëm që bashkëjetojnë, por edhe bashkëpunojnë. Kjo ndodh deri në shkallën kur shoqëria është në ngjitje, mirëpo në momentin kur shoqëria fillon të bjerë, nis të futet në krizë, bashkëjetesa e tyre fillon e prishet, deri në shkallën e antagonizmit kur nuk mund të qëndrojnë më bashkë dhe bëhet e domosdoshme që të ndodhin ndryshime rrënjësore. Edhe pas periudhës së gjatë të lulëzimit të feudalizmit, me lindjen e embrioneve të para të shtresës së hollë tregtare, fisnikëve fillojnë e u dridhen themelet. Me lindjen e forcimin e klasës së re kapitaliste nisin konfliktet midis klasës kapitaliste e asaj feudale në krye me mbretërit përkatës të vendeve përkatëse. Varësisht nga shkalla e zhvillimit, ky proces fillon në Angli e vazhdon më tutje, gjithandej Evropës. Kapitalistët u ofronin kushte më të mira pune e shpërblimi bujkrobërve dhe kështu filloi shpartallimi edhe i feudalizmit. Me forcimin e kapitalizmit filloi edhe kolonizimi i kontinenteve të tjera të botës. Bashkëjetesa e kolonizuesve dhe e të kolonizuarve vazhdoi derisa kjo bashkëjetesë shënonte ngjitje. Kur bashkëjetesa midis shteteve kapitaliste, me rastin e Luftës së Parë Botërore ra në krizë edhe metropolet kolonizatore e kolonitë ranë në krizë. Erdhëm kështu deri te shthurja e pjeshme dhe shpartallimit të disa nga perandoritë botërore, si Perandoria Austrohungareze, Perandoria Otomane, Perandoria Spanjolle e ajo Portugeze. Vazhdimisht po shikon se si faktorët pozitivë e negativë po ndahen e po bashkohen, po pajtohen e po hyjnë

në luftë midis tyre. Po lindin faktorë të rinj e edhe këta po fillojnë e po vazhdojnë me procesin e pajtimit e të ngatërrimit...

Albi fërkoj fytyrën, ndërsa Diella vazhdoi edhe pak:

- Po e sheh, vëllau i motrës, sesi për të ecur përpara janë të domosdoshëm jo vetëm faktorët pozitivë, por edhe ata negativë. Prandaj duhet t'i duam edhe ata që na duan edhe ata që nuk na duan. E kuptoj se për mendjen njerëzore është fort e vështirë t'i duash edhe ata që nuk të duan, mirëpo ata që seriozisht e njohin Zotin dhe janë në shërbim të njerëzimit mund ta bëjnë këtë pa ndonjë vështirësi të madhe... - tha Zanë-Diella dhe ia nguli shikimin Albit të rrudhur fare.

- Duhet. – tha Albi me gjysmë zëri dhe vazhdoi me plot zërin: - Po, ndonjë parashikim afatgjatë mund të ma thuash?

Zana-Diella, u mendua paksa e tha.

- Në këtë fazë të zhvillimeve njerëzore janë duke u bërë matje e çmatje të mëdha. Në këtë fazë janë duke u bërë përcaktime, seleksionime e përzgjedhje nga më të ndryshmet. Janë duke u matur e zgjedhur mjetet. Janë duke u bërë grupime e grumbullime forcash gjithfarësh e gjithandej globit. Tash, parashikimet nuk mund të jenë të sakta. Vetëm pasi që forcat të jenë renditur, rreshtuar dhe vënë në lëvizje, vetëm atëherë mund të parashikohen efektet dhe rezultatet. Për këtë, që me të drejtë interesohesh ti dhe ithtarët e tu, do të jeni me kohë të paralajmëruar dhe të informuar. Për mënyrën e thjeshtë të kontaktit tonë ne u morëm vesh. Ti, për këtë punë mos e lodh mendjen fare. Ti, vetëm të jesh mirë dhe në kontakt me të gjithë! Ti, me ithtarët e lëvizjes sate vetëm duhet të jeni të pranishëm në çdo vend dhe në çdo kohë...

- Përsheshi është gati! – thirri Shtuna duke qëndruar para tavolinës me duar të paluara si nuset...

- More, mirë përsheshi, por perënditë si i kanë hallet në këtë moment? – tha Albi pasi që u ul pranë tavolinës së vogël e duke marrë lugën në dorë.

- Paj, - tha Diella duke marrë qëndrim përmbri Albit, - perënditë, o vëlla, kanë shumë telashe. Më së pari kanë punë me vetveten, pastaj kanë punë me njëri tjetrin e në fund kanë punë me turmat...

- Po, mirë përse me vetveten?!- shprehu habinë Albi dhe futi në gojë një lugë përshesh.

- Paj, - vazhdoi Diella, - problemet më të mëdha njerëzit i kanë me vetveten, por kur hypin në shkallë perëndish atëherë problemet dhjetëfishohen, qindfishohen, mijëfishohen...

- Përse? – pyeti Albi me habi të madhe.- Çfarë rreziku u kanoset atyre nga ato lartësi të mëdha?

- Problemi i tyre është që si e si të qëndrojnë atje dhe që të mos rroposen poshtë, në fund, te turmat...

- E, përse problemet midis tyre? – pyeti Albi si të ishte ndonjë çunak.
- Paj, dyshimet, mosbesimi, droja, frika që ushqejnë ndaj njëri-tjetrit kanë shkaktuar luftëra tragjike midis tyre, kurse pesëdhjetë vitet e fundit ata luftojnë tërthorazi me njëri-tjetrin duke shtyrë në luftëra shtetet satelite të tyre. Por – Diella, ndryshoi zërin sikur t'i ishte kujtuar diç dhe duke iu afruar Albit dhe duke e shikuar nga lart, iu drejtua me një zë gati si qortues, - përse ti, o, vëlla, pyet për gjëra që ti gjithashtu i di fort mirë?

Albi la lugën, ngriti shikimin drejt fytyrës rrumbullake të Zanë-Diellës e tha sikur të fliste vetmevete:

- Paj, motra Diellë, vetëm kur dëgjoj nga ata që u besoj dhe që i vlerësoj mendimet e ngjashme ose identike me mendimet e mia, më hiqet çdo dyshim dhe bindem se e kam mirë. Unë nuk guxoj të gaboj sepse jam në shërbim të njerëzve dhe me fatin e tyre nuk bën të luhet...

Zanë-Shtuna, rrahu shuplakët dhe u shkreh në vaj, ndërsa Zanë-Diellës nga sytë e mëdhenj e të kuq iu rrokullisën dy lotë e ranë mbi fytyrën e Albit. Ajo, ra në gjunjë, ngriti Albin në këmbë e puthi në të dy faqet, u ngrit shpejt dhe doli nga baraka. Pas saj edhe Shtuna, ra në gjunjë para Albit, iu avit dhe e puthi në të dy faqet e përflakura, u ngrit shpejt e doli nga baraka. Derisa Albi mori veten, kapi zinxhirin dhe doli me rrëmbim para barakës së zezë, motrat e tij, zanat, ishin zhdukur. Iu duk sikur mbeti pa të gjitha ato që kishte brenda kraharorit. Hodhi shikimin mbi kreshtat e larta rreth vetes. Një gëzim i madh, bashkë me një pikëllim të hollë ia pushtuan trupin. E kuptoi se ai tash e tutje nuk do të ishte më i vetmuar me tundimet e veta. Iu duk sikur kreshtat e larta e të bardha u përkulën paksa dhe sikur prej andej, në veshët e tij erdhi një ushtimë-jehonë me fjalët bariton:

“Na ke ne! Na ke ne! Na ke ne!...”

Albit, sikur iu kthyen zemër e mushkëri në kraharorin deri para pak çastesh të zbrazët. Uli shikimin poshtë dhe e gjeti veten midis çfrenit të borës deri në shokë. I dha zor dhe me gjithë zinxhirin e ftohtë u fut në barakën e zezë.

...perëndit, më në fund, ranë në ujdi...

Pas shumë grindjesh të vogla e të mëdha, perënditë, më në fund, ranë në ujdi. Në bisedat bindëse me Albin ata do të merrnin pjesë të gjithë, por para tij do të dukeshin një nga një, vetëm tri perënditë më të mëdha. Të tjerët, gjatë bisedës së njëshit përkatës do të qëndronin prapa perdeve të trasha prej nga do të mund të shihnin dhe të dëgjonin “teatrin” e gjallë!...Vendi i ngjarjes do të ishte ujdhesa e Maltës. Perënditë, dy ditët e fundjavës i kishin caktuar për këtë qëllim. Veprimet teknike rreth sendërtimit të këtij takimi misterioz i mori përsipër Latini. Pushteti i padukshëm e Dhuna fort e dukshme u vunë në veprim.

...albin e transferuan urgjentisht për në Maltë...

Ndërsa specialistët ia zhvidhosnin Albit zinxhirin nga këmba, Dhuna afroi turirin pranë fytyrës çunake të tij dhe duke u zgërdhirë i tha:

- Dëgjuam se ishe ankuar për regjimin e keq këtu te Kreshtat e Bardha. Kishe thënë se e ke shumë ngrohtë këtu...

Ndërsa Albi e shikonte me neveri, ai vazhdonte:

- Tash po të çojmë në Polin e Veriut, në shoqëri me pinguinët e me fokat...Ha! Ha! Ha! Aaaa!...

Kabina e helikopterit ku e vendosën Albin dritaret i kishte me qelqe-pasqyrë. Albi, në të katër anët shihte vetveten dhe përcjellësit e vet të veshur me uniformat lara-lara. Albi, mbylli sytë e mendoi:

- Ah, moj zana, ah, moj motra, a po e dini se ku po më çojnë?

U nisën. Dëgjohej vetëm uturima e helikopterit. Pas një kohe të pacaktuar, komandoja përbri Albit e goditi me bërryl. Ai hapi sytë. Uturima e helikopterit nuk dëgjohej. Si dukej ata ishin përtokur. U hap dera e helikopterit dhe një vrushkull ngrohtësie hyri në kabinë. Albi shikoi nëpër derë dhe përtej betonit të bardhë të pistës pa një hapësirë të bleruar. Ishte mësuar me befasi, prandaj nuk reagoi fare. Dy komando, pa thënë asnjë fjalë e kapën për krahësh dhe e zbritën mbi pistën e ngrohtë. Disa hapa më tutje priste një xhip me perde të zeza në të cilin, dy komandot e hipën Albin.

Xhipi, porsa u gjet jashtë aeroportit, mori përpjetë një kodre të bleruar. Pas një kohe xhipi u ndal në maje të kodrës. Kur e zbritën, Albi u gjet përballë një pallati të madh cilindrik, të lartë e me dritare fort të mëdha. Para dyerve automatike qëndronin dy komando. Komandot e xhipit, ua dorëzuan komandove të pallatit Albin dhe u larguan. Komandot e pallatit ishin shumë të sjellshëm me Albin. Ai që ishte pakëz më i gjatë i tha Albit në anglisht:

- Zotëri i nderuar, Ju jeni mysafir i shtetit të Maltës. Nëse nuk keni ndonjë kërkesë, ose pyetje ne do të vazhdonim me procedurën e paraparë.

- Nuk kam asnjë pyetje e asnjë kërkesë.

...albin e futën në pallatin superluksoz...

Komandot e Maltës ia morën patin Albit, pastaj ai më i gjati u nis kah dyert e pallatit duke i bërë me shenjë Albit që ta ndiqte. Albi, pa fjalë u nis pas tij, ndërsa prapa tyre po shkonte komandoja më i shkurtë. Albi, i shoqëruar nga komandot u gjet në një holl të madh, të rrumbullakët, të shtruar me tepihë të trashë e të qëndisur ëmbël. Kolona e vogël shkoi drejt portës përballë dyerve të hyrjes. Komandoja i gjatë hapi portën dhe ata u gjetën në një sallon tjetër fort të madh, të rrumbullakët në mesin e të cilit ishte vendosur një tavolinë e mbuluar me cohë të blertë, mbi të cilën

qëndronte një vazo e madhe me gjithfarë lulesh. Kahdo që të shkonin sytë shihje dhoma me dyer qelqi, me të gjitha nuancat nga e bardha deri tek ylberja. Mbi dhomat ishte një ballkon rrethor i veshur me perde bojëgjake. Komandoja i gjatë u ndal para Albit, ia mori patin e i tha.

- Zotëri i nderuar, kjo hapësirë, në këtë kat, me të gjitha që ka brenda do të jetë në dispozicionin tuaj. Sot e sonte do të keni kohë që t'i shikoni të gjitha dhe të shërbeheni me të gjitha ato që dëshironi. Nesër Ju presin takimet me ata që dëshirojnë t'Ju takojnë dhe të bisedojnë me Ju. - Komandoja i gjatë nxori nga xhepi i përparmë i xhakëtës një telefon me antenë. – Këtë telefon e keni për çdo rast që të shprehni ndonjë kërkesë ose dëshirë tuajën që ne nuk e kemi paraparë... Komandoja ia dha telefonin, ia mori patin dhe bashkë me komandon tjetër u larguan.

...albi filloi nga kontrolli i ambientit...

Albi kishte vapë dhe ndiente etje. Filloi nga dera ylberë. Në dhomë ishte gjysëmterr. Bënte dritë të butë vetëm një abazhur i kuqërremtë përkrye një krevati të gjerë mbi të cilin qëndronte e shtrirë një bukuroshe krejtësisht lakurique. Ajo hapi sytë e mëdhenj e të ëndërrueshëm dhe i bëri me shej Albit që të shkonte te ajo. Ai, fërkoj fytyrën i befasuar dhe tha me zë mirësjellës:

- Faleminderit, faleminderit! – dhe si i përvëluar u kthye prapa e doli jashtë, në sallon.

“Eu, mendoj Albi, kjo dera ylberë paska qenë mesele!”

Tash, sikur i hyri frika të hapte dyert tjera, por nuk kishte çfarë të bënte tjetër.

“Hajt, tha, të vazhdoj me derën e bardhë, atje tutje.”

Hapi derën e bardhë dhe u gjet në një banjë ultramoderne të pajisur me vaskë masazhere, me shampotë e të gjitha llojeve, me të gjitha mjetet e rrojës e të depilatorëve, me ndërresat e të gjitha llojeve dhe krejt e veshur me pasqyra. U zbath e u zhvesh shpejt sikur të kishte frikë se dikush do të vinte e do ta përzinte prej aty, lëshoi ujin dhe u shtri në vaskë. Do ta zinte gjumi po të mos ishte masazhi automatik i vaskës. I lehtësuar doli nga vaska, u fshi, veshi ndërresat e lara dhe vazhdoi me rendin e dhomave. Erdhi te kuzhina ultramoderne. Kuzhinierja bukuroshe i ofroi të gjitha llojet e ushqimeve. Albi nuk kishte uri. Ai kërkoi ujë pa gaz të markës “Rugova”, mirëpo meqë nuk kishte ujë të tillë kuzhinierja i ofroi ujë pa gaz nga Eviani. Albi shoi etjen e vazhdoi me dhomat. Erdhi te dera bleroshe. Brenda ishte ambienti si të ishte në ndonjë oazë buzë ujëvarës gurgulluese. Vinte erë e livadheve pas të kosituri. Albi u zhvesh dhe u fut nën mbulesën e lehtë sipër krevatit të gjerë të vendosur në mes të dhomës. E zu gjumi menjëherë...

...mëngjesi i ditës së shtunë në pallatin e qetë...

Në orën tetë, në dhomën ku flinte Albi, filloi kënga e bilbilave. Ai kishte pushuar mirë dhe kokën e kishte të kthjellët. Menjëherë u kujtua se ku ishte dhe çfarë e priste në ditën e sotme. U la e u shpërta. Uri nuk kishte, prandaj nuk shkoi fare në kuzhinë. Doli në sallonin e madh dhe vërejti se atje ishte bërë një ndryshim i vogël. Vazoja me lule ishte larguar nga tavolina e mbuluar me cohë të blertë dhe në vend të luleve, në të dy anët ishin vendosur nga një mikrofon dhe poshtë, në të dy krahët, nga një karrige shumë komode.

“Domethënë, mendoi Albi, bisedat paskan të bëhen një me një.”

Çoi kokën lart dhe shikimi iu ndal në katin e sipërm, në ballkonin rrethues të mbrojtur nga perde bojëgjake.

“Vallë, a do të ketë njeri dhe kush do të jetë prapa atyre perdeve?” Albi u soll një herë rreth tavolinës me mikrofonin dhe iu kujtua se kishte telefonin që ia dha komandoja i gjatë. Nxori telefonin nga xhepi i xhakaventos, shtypi sustën e blertë dhe pyeti atë që iu lajmërua:

- Ju lutem, në cilën orë do të fillojë takimi?

- Ju lutemi që fiks në orën dhjetë pa një minutë të jeni të ulur në karrigen ngjyrëbardhë.

- Faleminderit! – tha Albi duke shikuar karriget. Vërtet, njëra ishte e veshur me lëkurë të bardhë, kurse tjetra me lëkurë të kaltër.

Kishte edhe një orë deri në dhjetë, prandaj Albi vazhdoi të sillej rrotull tavolinës duke bërë rrahë gjithnjë më të mëdhenj rreth saj e duke bluar me mend:

“A ka mundësi që këta me këto detaje të ma hedhin? Herë më hedhin maje kreshtave me borë e me akuj, herë më sjellin midis Mesdheut. Herë nxehtë, herë ftohtë, herë fort, herë butë, herë errësirë, herë dritë, herë mërrrolje, herë buzëqeshje. Si OZNA, si UDB-ja, si Asfalia, si Sigurimi... Paj, të gjithë ata që shkelin vullnetin e popujve janë njësoj; e njëjta gjellë vetëm pjatat i ndërrojnë; vetëm format e tyre, vetëm emërtimet e tyre ndryshojnë...”

Ashtu duke bluar me mend dhe duke u endur rreth tavolinës koha kaloi shpejt. Në një moment cingëroi telefoni në xhepin e Albit. Ai afroi telefonin te veshi. Nga andej u dëgjua zëri i butë i komandos së gjatë:

- Zotëri i nderuar, ora është edhe një minutë në dhjetë. Luteni që të uleni në karrigën Tuaj të bardhë!

Albi, pa thënë asnjë fjalë, shkoi dhe u ul në karrigen e bardhë, pranë tavolinës në mes të sallonit. Ia nguli sytë mikrofonit, ndërsa në kokë i vinin përnjëherësh gjithfarë mendimesh. Nuk vonoi shumë dhe para tij, i buzëqeshur, u shfaq Balena. Albi, me ngadalë u ngrit në këmbë dhe përkuli kokën në shej nderimi. Balena, duke zgjeruar buzëqeshjen, i disponuar, ia zgjati dorën Albit e i tha në stilin e sherifëve:

- Paj, Ju, atje në Dardani, pushtetarët tanë nuk i njihni, përse ndaj meje tregoni respekt?

- Sepse shumica e pushtetarëve Tuaj në Dardani sillen me ne si me mijtë eksperimentalë, pa respektuar as parimet elementare të demokracisë dhe duke vënë veten e tyre mbi ligjet themelore, kurse me Ju puna qëndron ndryshe...

- Më thoni, Ju lutem, përse me mua puna qëndruaka ndryshe? – tha Balena duke u ulur në karrigen e kaltër, përballë Albit.

- Me Ju, puna qëndron ndryshe, sepse Ju respektoni, ose jeni të detyruar të respektoni parimet themelore të demokracisë dhe u nënshtroheni ligjeve themelore të shtetit Tuaj, njësoj si çdo qytetar i thjeshtë.

Balena, shtrëngoi grushtet, ngërtheu vetullat dhe ia nguli fort sytë Albit. Albi, vetëm u prirë në një buzëqeshje fort të lehtë duke shikuar gjithashtu Balenën drejt e në sytë e kaltër. Balena, liroi grushtet e shtrënguar dhe iu drejtua Albit me të butë:

- Më thoni, Ju lutem, qëkur dhe ku qëndron shkak që ne hymë në grindje me fisin e prometejve?

- Ah, prej fillimit të shoqërisë njerëzore dhe për shkak se ne jetuam e jetojmë me turmën e për turmën, kurse ju jetuat e jetoni larg turmës dhe nga turma...

- Zotëri, unë kam informata se Ju jeni njeri shumë i mësuar e fort mendjehollë. Fisi juaj ua mësoi turmave shkrim-leximin, artet, shkencat, të gjitha mjeshtëritë. A pak Ju duket kjo?

- Pak, sepse të gjitha ato që kanë mësuar turmat, në fund të fundit, shkojnë në të mirën tuaj, sepse ju, me anën e mekanizmave ekonomike, financiare e ngapak edhe me anë të dhunës merrni mazën e fryteve të punës së tyre, kurse turmave u mbeten droçkat...

- Domethënë, jeni duke e pohuar edhe vetë se tash jeni duke i cytur, duke i yshtur e duke i frymëzuar që të na rrëzojnë ne dhe ata ta marrin edhe pushtetin. Vallë, a nuk Ju duket kjo veprimtari pak si e rrezikshme?

- Po, është e rrezikshme për ju, sepse po harroni dhe po jetoni e po silleni si perëndi, ndërsa turmat nuk kanë se çfarë të humbin...

- Paj, Ju lutem, rikujtoni historinë! Sa herë që turmat kanë marrë frenat e pushtetit në dorë kanë ndodhur katastrofat shoqërore. Apo, nuk kam të drejtë?

- Pjesërisht keni të drejtë, por gjakderdhjet më të mëdha i kanë pësuar turmat për shkak të luftërave tuaja të ndërsjella që rrodhën nga dyshimi juaj i ndërsjellë, nga përpjekjet tuaja për të kontrolluar njëri-tjetrin, për të nënshtuar njëri-tjetrin, për të sunduar njëri-tjetrin.

Balena nxori faculetën dhe fshiu djersët e para. Përtypej që të thoshte diçka, por nuk po përcaktohej dot. Albi, pasi priti pak, vazhdoi:

- Nëse doni që të jap argumente për këto që thashë jam i gatshëm, por nuk dua të abuzoj me kohën tuaj të çmueshme.

Balena, lëpiu buzët e thara e tha:

- Jo, zotëri i nderuar, Ju e dini fort mirë që shteti im nuk ka kolonizuar asnjë tjetër. Ne edhe vetë kemi qenë koloni... - sikur ndërpreu fjalinë përgjysmë dhe kafshoi paksa buzën e poshtme.

- Është e vërtetë kjo që thoni, por çfarë jeni duke bërë sot?

- Besoj se nuk keni harruar se shteti im ishte ai që e shpëtoi popullin tuaj nga zhdukja e plotë...

- Ne u jemi shumë mirënjohës për përkrahjen tuaj të pjesshme...

- Si të pjesshme zotëri?! – nuk iu durua Balenës pa ndërhyrë.

- Paj, zotëri i nderuar, Ju duhet ta dini se shteti im i vogël nga të tri anët tokësore kufizohet me trupin e vet të copëtuar e të rrëmbyer nga vasalët ruso-anglo-francezë. Tri të katërtat e territorit tonë na është këputur nga trangu ynë kombëtar.

- Paj, Ju e dini se në atë kohë fjala jonë nuk dëgjohej edhe aq fort.

- Paj, mirë, le të themi se për atë kohë më shumë dëgjohej fjala e Klemansosë se sa fjala juaj, por sot? Ç'bëtë me boshnjakët në Dejton? Si ishte e mundur që ju, njeriun që bëri tri luftëra të përgjakshme, që shkaktoi gjithë ato mizori gjithandej Ballkanit e shpallët paqebërës? Si është e mundur që ju u pajtuat me kërkesën e kasapit të Ballkanit që në Dejton të mos hapej çështja e Dardanisë?...

Balena, nxori faculetën e fshiu djersët e dyta. Me gojën e tharë, mezi tha:

- Paj, nuk ishim vetëm ne në Dejton, zotëri!

- Është fakt se nuk ishit vetëm ju, por fjala juaj ishte kryesorja, zotëri i nderuar. Apo jam gabim? – tha Albi me butësi, duke përcjellë fjalët e veta me një buzëqeshje të matur.

- Paj...- tha Balena duke u munduar që edhe ai të buzëqeshte.

- Unë, nuk jam nga ata që nuk i kuptojnë edhe obligimet tuaja ndaj aleatëve e partnerëve tuaj, mirëpo Ju duhet ta dini se pikërisht këto lëshime që ju partnerët ia keni bërë dhe që edhe sot po ia bëni njëri-tjetrit janë shkaktari kryesor i dy luftërave të mëdha botërore dhe të qindra e qindra luftërave të tjera regjionale e lokale që u bënë dhe që po bëhen sot në botë. Pikërisht, lëshimet e pazarllëqet tuaja të ndërsjella e pollën Musolinin, pikërisht lëshimet e pazarllëqet tuaja të ndërsjella e pollën Hitlerin, pikërisht lëshimet e pazarllëqet tuaja të ndërsjella e pollën imperializmin japonez...

Balena, u sarrakuq, nxori faculetën për të fshirë për të tretën herë djersët, duke u munduar të frenonte sertllëkun e vet e tha:

- Zotëri i nderuar, a bën t'i lëmë leksionet historike?!...

Albi, për një moment u step, por shumë shpejt e mori veten e tha me të butë:

- Kërkoj ndjesë! Po e lëmë historinë edhe pse dihet se çka ndodh me ata që harrojnë historinë, e po kalojmë në të sotmen. Ndonëse shihej sheshazi se si, në mes të Ballkanit, falë taktikave, lëshimeve e pazarllëqeve tuaja e të aleatëve e partnerëve tuaj po lindte shteti terrorist i udhëhequr nga kasapi i lazdruar i Ballkanit, ju nuk morët masat përkatëse. Ju u zgjuat nga gjumi vetëm kur morët goditjen mu në

zemër të Nju Jorkut. Në vend që të neutralizonit përfundimisht dhe komplet shtetin terrorist të Ballkanit, ju përsëri filluat me lëshime, taktika e pazarllëqe në Ballkan...

- Për çfarë lëshimesh, taktikash e pazarllëqesh bëni fjalë, zotëri, - shpërtheu Balena, - po a nuk ishim ne, që bashkë me aleatët tanë me forcë e larguam, siç thoni Ju, kasapin e Ballkanit, bashkë me ushtrinë e policinë e tij nga Dardania?! Mosni, Ju lutem!

- Ne, ju falënderojmë shumë për ndërhyrjen tuaj, ndonëse të vonuar. Por, edhe asaj here ju bëtë eksperiment me ne. Ju reaguat pasi që kasapi i Ballkanit bëri gjithë ato ploja,, mizori e tragjedi gjithandej ish-Jugosllavisë. Pastaj kur reaguat në Dardanië tashmë të masakruar, me vonesë të pafalshme, Ju kumtuat se ndërhyrja juaj do të bëhej me zero viktima! Ju, bashkë me aleatët, bombarduat nga dhjetë kilometra largësi, ndërsa ne na latë në mëshirën e ushtrisë e të policisë së kasapit të Ballkanit. Në ato ditë ushtria e policia e tij dëboi gati një milion albërezë nga Dardania, dhunoi mase njëzet mijë gra e vajza të pambrojtura, vrau mase pesëmbëdhjetë mijë gra e burra, pleq e fëmijë, bëri shkrumb e hi mase dyqind e pesëdhjetë mijë shtëpi...

- Mjaft, Ju lutem, me këto shifra! – klithi Balena.

Albi, duke buzëqeshur, vazhdoi me butësi:

- Zotëri i nderuar, Ju historinë tonë nuk doni ta dëgjoni, shifrat e faktet për të zezat që na i bëri kasapi i Ballkanit nuk po i duroni, përse keni marrë mundimin që të vini e të bisedoni me mua kot. Nëse keni dëshirë që të dëgjoni fjalë që juve jua miklojnë veshin, atëherë ja ku i keni ata vazalistët e sahanlëpirësit që vetë i keni instaluar në atë pushtetin e rremë në Dardani, shkoni dhe flisni me ata...

- Paj, - Balena i zbuti fjalët, - ne kemi ardhur që të pajtohemi me Ju e jo të grindemi...

- Paj, - vazhdoi Albi me butësi, - ne me ju jemi të pajtuar, ne ju duam fort, ne kemi pritur e presim nga ju shumë, mirëpo ju sikur nuk po na bëni hesap ne, albërezëve, sikur nuk po e bëni hesap gjakun që derdhëm e viktimat që dhamë për lirinë tonë, jo vetëm në këtë kryengritjen tonë të fundit, por të kryengritjeve tona pothuaj ç'prej njëqind vjetësh...

- Si, nuk po ju bëjmë hesap, Ju lutem, ma sqaroni këtë që thatë! – tha Balena me butësi të theksuar.

- Paj, - tha Albi edhe më me butësi, - ju me aleatët e partnerët tuaj po mendoni se ne do të mbetemi fëmijë tërë jetën. Ju po mendoni se ne do të jemi të kënaqur me thërrimet që na i vërvitni ju. A nuk jeni ju ata që, bashkë me aleatët e partnerët tuaj që albërezëve të gJORë ua imponuat marrëveshjen e turpshme të Rambujesë?...

- Paj, përse e nënshkruan? – ndërhyri Balena.

- Paj, e nënshkruan sepse mendonin se ashtu duhet dhe për t'jua bërë qejfin juve...

- E, zotëri i nderuar, më falni, por marrëveshjet nuk nënshkruhen për qejfin e askujt, por nënshkruhen për të mbrojtur interesin vetanak...

Albi, nga këto fjalë të Balenës, mbeti si i ngrafitur. Iu mur goja dhe mbeti me sy të ngulur në buzëqeshjen triumfuese të bashkëbiseduesit përballë tij. Ai mendonte t'ia numëronte Balenës edhe lëshimet, që iu bënë ithtarëve të kasapit të Ballkanit lidhur me komunat e pastra serbe, që do të mund të krijohen në Dardani, lidhur me territoret e tokave private, që do t'u faleshin kishave e manastireve serbe, lidhur me të drejtat e Serbisë që të përzihet në mënyrën më të palejueshme në punët e brendshme të Dardanisë, mirëpo çfarë të thoshte tash pas këtyre fjalëve aq brutale, por aq të drejta e aq të vërteta. Albi, prorre kishte ushqyer respekt e dashuri për balenasit përveç tjerash edhe për këtë drejtpërdrejtshmëri të tyre frapante.

"Çfarë të them tash pas këtyre fjalëve me të cilat më çarmatosi fare? Ai pret përgjigjen time. I mjeri unë që jam midis dy zjarreve!" mendoi Albi i turpëruar dhe lëshoi shikimin tek tavolina mbi të cilën, në anën e tij të majtë, në tabakanë e shkëlqyer qëndronin një gotë kristali dhe katër shishe me lëngje e me ujë. Mori gotën dhe e vuri para vetes, pastaj zgjodhi shishen me ujë pa gaz, e hapi, mbushi gotën dhe e piu me shije të madhe. Ai përballë tij, prapa buzëqeshjes së vet triumfuese, po priste shumë i qetë.

- Albi, duke ngritur shikimin drejt Balenës tha:

- Më falni! Dhe, ku e patëm fjalën, është e vërtetë se fajin kryesor e kemi ne, mirëpo edhe ju me aleatët e partnerët tuaj nuk jeni krejt pa faj...

- Përse, o zotëri? Më thoni, ju lutem, ku qëndron faji ynë?

- Faji juaj i pjesshëm qëndron në faktin se ju, midis albërezëve keni përzgjedhur për të bërë pazar me ju dhe me ithtarët e kasapit të Ballkanit pikërisht ata, të cilët ishin më dorëilirët për të mos thënë më të papërgjegjshmit...

- Paj, keni të drejtë, kur Ju thoni shpesh se albërezët për politikë janë kalamaj. Por ta dini se edhe Ju vetë jeni njëri nga këta kalamaj. Vallë, mos pritni ju që të tjerët t'ju duan juve më tepër se sa duan veten e tyre? Është krejtësisht normale se për të bërë pazar të gjithë preferojnë ata që janë më dorëilirë, siç i quani Ju, të papërgjegjshëm, sepse sekush mundohet për interesat e veta...

- Mos doni të thoni se politika qenka tregti?

- Paj, tregti e shkuar tregtisë, interes e shkuar interesit! Po, çfarë mendoni Ju se na qenka politika?...

- Paj, paj...- belbëzoi Albi.

- Çfarë, paj? Nëse politika nuk është lojë për të fituar, mos qenka vallë, lojë për të humbur?- kaloi Balena në sulm.

Albi u sarrakuq, por megjithatë pa humbur nervat shtoi:

- Paj, keni të drejtë. Kur të shikosh se kush merret me politikë këndeje e andej oqeanit del se merren me politikë vetëm milionerët e miliarderët...

- E, pra! Mos vallë kanë kohë që të merren me politikë fukarenjtë, rjepacanët, proletarët e lumpenproletarët? Edhe ju albërezët edhe gati gjysma e botës e pa dhe u bind se çfarë ndodhi kur ky soj njerëzish u mor me politikë dhe madje mori edhe pushtetin në dorë.

Albi kapi gotën e ujit, ndërsa Balena vazhdoi me vendosmëri edhe më të madhe:

- Apo, mos jam gabim? Lenini e Stalini gjatë sundimit të tyre vranë e bënë që të vdisnin më shumë njerëz se sa u vranë e vdiqën gjatë dy luftërave botërore. Të mos përmend ata leninët e stalinët e vegjël që bënë kërdrinë gjithandej Evropës Lindore, në Azi e edhe këtu në Ballkanin tuaj. Apo, nuk kam të drejtë? – Balena hetoi se Albin e kishte sjellë mbi akull të hollë, prandaj nuk po ndalte sulmin e pyetjet.

- Paj, -Albi, me ngadalë mori veten, - nga njëra anë keni të drejtë, por nga ana tjetër nuk keni të drejtë...

- Pa, ma thoni, Ju lutem, atë anën tjetër që nuk paskam të drejtë? – iu drejtua Balena Albit, me një dozë të theksuar ironie.

- Paj, ja ku po jau them, pse jo. – u këndell Albi.

- Më thoni, Ju lutem! Dua ta di edhe unë.

- Paj, ju duke krijuar në një rën anë pasurinë, në anën tjetër po e krijoni varfërinë frapante. Ju e dini se në çfarë gjendje katastrofike, për fajin e milionerëve e miliarderëve, që thoni Ju, kanë ardhur kontinentet e Afrikës, Amerikës Latine dhe Azisë. Janë futur në borxhe deri në fyt dhe nuk po mund t'i paguajnë ato. Për shkak të varfërisë SIDA po bën kërdrinë në këto hapësira. Apo, jam gabim? – ia ktheu Albi Balenës ironinë me ironi.

- Në një rën anë edhe Ju keni të drejtë, por në anën tjetër nuk keni të drejtë. Kush ju tha atyre që të merrnin borxhe aq sa nuk do të mund t'i kthejnë? Pastaj, kush u ka faj atyre zotërinjve, që nuk dinë të menaxhojnë si duhet me parat e marra borxh. Pastaj edhe një herë, kush u ka faj atyre popujve që në krye të shteteve zgjedhin hajnat, kriminelët e të paaftët? Kështu e ka kapitalizmi, zotëri i nderuar, kush është i zoti shkon përpara, kush nuk është i zoti falimenton. Ja, shembujt: edhe hunët, pas Luftës së Dytë Botërore ia filluan nga zeroja, por shkuan përpara dhe janë bërë fuqi ekonomike botërore, sikurse edhe diellajt, kulshedrajt pas reformave, latinët e shumë të tjerë. Tek e fundit, kapitalizmi, si çdo gjë tjetër në këtë botë, i ka anët e veta të mira, por edhe anët e veta të këqija. Dhe, gjeniu njeri, fatkeqësisht, akoma nuk gjeti sistem më të mirë se ky që po dominon prej disa qindra vjetësh. Derisa, në një rën anë të ketë pasuri, në anën tjetër patjetër do të ketë varfëri. Ju e dini se asgjë nuk mund të krijohet nga asgjëja. Ju e dini se jeta përbëhet nga paradokse të panumërt. Pa varfëri nuk mund të ketë pasuri, pa pasuri nuk mund të ketë varfëri. Pa lindje nuk ka vdekje, pa vdekje nuk ka lindje. Pa mosdije nuk ka

dije, pa dije nuk ka mosdije. Ja, këta janë disa nga paradokset më të rëndësishëm. Keni Ju, ndonjë ide më të mirë se sa kapitalizmi, Ju lutem?...

Ishte ky kulmi i ironisë dhe i cinizmit me të cilat Balena e fshikulloi Albin. Albi e humbi drejtpeshimin:

-Paj, si po del nga fjalët Tuaja, njerëzimi duhet të vazhdojë kështu deri në pambarim. Jo, zotëri fort i nderuar, bota sot, falë Zotit, ka arritur atë shkallë të përparimit saqë ka kapacitet të mjaftueshëm për të prishë atë paradoksin e pasurisë dhe të varfërisë që deri tani po shkojnë bashkë...

- Paj, na thoni, zotëri, si, se atë po presim! – e ndërpreu Balena Albin me padurim.

-Më thoni Ju lutem, - iu çel goja Albit, sa qindra miliarda ju kushtoi juve lufta e Koresë? Sa qindra miliarda ju kushtoi lufta e Vietnamit? Sa qindra miliarda po ju kushtojnë luftërat në Afganistan e në Irak? Ku po i merrni e ku po i gjeni gjithë ato miliarda e miliarda dollarë për të mbjellë vdekje, rrënim e mjerime e nuk po i gjeni për të çrrënjësuar një herë e përgjithmonë robëritë, shtypjet, padrejtësitë, varfërinë, mjerimin, prapambetjen e padijen në botë?...

- Paj, padrejtësitë e robëritë jemi duke i luftuar në Afganistan e në Irak, zotëri! – klithi Balena.

- Po, përse një herë nuk e pastruat Ballkanin nga robëritë e padrejtësitë e pastaj të shkonit në Afganistan e Irak?

Balena, vrik dhe plot nervozizëm i hodhi një shikim ballkonit rrethor, pastaj përvoli mëngën dhe shikoi orën. Duke përmbajtur zemërimin, u ngrit në këmbë dhe pa ia zgjatur dorën Albit, tashmë gjithashtu në këmbë, tha me butësi të shtirur:

- Zotëri, më vjen keq, por koha ime mbaroi. Ishte kënaqësi për mua që pata rastin të takohesha e të bisedoja kaq hapur me Ju. – Ai ktheu shpatullat dhe me hapa të mëdhej u nis kah dyert e daljes së pallatit.

Albi, ashtu si ishte në këmbë, shikoi dyert e dhomave, pikasi derën bleroshe dhe me hapa të ngadalshëm u nis drejt saj.

...takimi me ariun...

Pas gjysmë ore pushimi që kaloi në dhomën e qetë bleroshe, kënduan bilbilat dhe cingëroi telefoni, që kishte Albi në xhep. Zëri i komandos ishte i qartë, por i butë:

- Zotëri i nderuar! Edhe një minutë keni kohë për të zënë vendin Tuaj në tavolinën e bisedimeve.

- Ani. – tha Albi dhe menjëherë doli jashtë dhomës bleroshe dhe zuri vendin e vet, në karrigën e bardhë, pranë tavolinës bleroshe, në mes të sallonit.

Pas pesë minutash, hyri në sallon Ariu dhe u drejtua kah vendi i vet, përballë Albit. Kur u afrua Ariu dy hapa, Albi u ngrit me ngadalë në këmbë, me duart lëshuar

përtrupit. Ariu, përshëndeti rusisht duke ia zgjatur Albit dorën. Albi i ktheu përshëndetjen shqip dhe pastaj i tha anglisht:

- Unë kam mësuar dikur rusisht, por anglishten e flas më mirë sepse është më e afërt me gjuhën time të nënës.

- Nuk ka gajle, flas unë edhe anglisht, por në cilin grup gjuhësh bie gjuha albëreze?

- Gjuha jonë ka prejardhjen nga sanskritishtja, dmth. i takon gjuhëve indoevropiane, si edhe rusishtja, por është e vetme dhe e pashoqe.

- Ashtu?! – sikur u habit Ariu e shtoi,- Domethënë, ju edhe me gjuhë qenkët të veçuar nga të tjerët?

- Po. – tha Albi shkurt.

- Po, mirë, zotëri, ju albërezët, sa jam informuar unë, gjatë tërë historisë keni qenë popull shumë i përehatshëm. Më thoni, Ju lutem, sa më shkurt që të jetë e mundur, çfarë kërkonte ju, në të vërtetë?

- Ne, shkurt, kërkojmë që të jemi zotër në hapësirën tonë. – tha Albi dhe ia nguli sytë Ariut.

Ai, megjithëse tharbi fytyrën, tha me zë të butë:

- Ah, zotëri, sa di unë hapësira juaj është bukur e madhe dhe kërkesa juaj do të prekte e madje do të shembte rendin historik e juridik ndërkombëtar që është vendosur e stabilizuar prej kohësh edhe në Ballkan.

- Po, zotëri dhe me sa di unë Rusia ka qenë njëra nga arkitektet kryesore për vendosjen e stabilizimin e këtij rendi historik e juridik ndërkombëtar edhe në Ballkan.

Ariu pohoi me kokë, ndërsa Albi shtoi:

- Por, Ju lutem shumë, që të keni mirësinë e të më shpjegoni nëse këtë rend historik e juridik ndërkombëtar edhe në Ballkan e keni vendosur duke marrë parasysh dëshirën e vullnetin politik të albërezëve, apo këtë rend historik e juridik e keni vendosur me të drejtën e më të fortit, domethënë, me dhunë?

- Perandoria Otomane duhej të shporrej e mund të shporrej nga Ballkani vetëm me dhunë, zotëri! – ngriti paksa tonin ariu.

- Paj, shumë mirë e shumë faleminderit që edhe ju morët pjesë në shporrjen me dhunë të Perandorisë Otomane nga Ballkani, sepse ajo me dhunë e ka pas pushtuar e me dhunë e ka pas mbajtur nën pushtim Ballkanin, por unë Ju pyeta të më shpjegoni se a ndodhi zgjerimi i territoreve të Malit të Zi, të Serbisë e të Greqisë në llogari të territoreve të Albërisë me pëlqimin e me vullnetin e albërezëve, apo kjo u bë kundër dëshirës e vullnetit të tyre, me dhunë e me forcë?

Ariu u shkreh në gaz të zëshëm duke i hedhur një shikim ballkonit rrethor të mbuluar me perde e tha me qesëndi:

- Si? Një burrë kaq i mençur si Ju të mos e dijë se të gjitha ndryshimet e kufijve që përmendët Ju janë bërë me pëlqimin e vullnetin e shprehur me

referendum të albërezëve, nën mbikëqyrjen rigoroze të OKB-së dhe të njëqind OJQ-ve të të shtatë kontinenteve të botës, përfshirë këtu edhe eskimezët e pinguinët?!...

- Jo, po, - u përgjigj Albi flakë për flakë, - si nuk e ditkam kur vetë kam marrë pjesë në banketin, që pati shtruar me atë rast, në sallën Jekaterina të Kremlinit, vetë cari Romanov...

- Ju paskët prirje të madhe për humor, zotëri.- tha Ariu, duke buzëqeshur e duke i hedhur edhe një shikim ballkonit rrethues.

- Humorin e zi e kam mësuar zotëri nga Udbashët e Serbisë të cilët këtë zanat e kishin pas mësuar në shkollat e larta policore të Ruisë...

- Ashtu?! – tha Ariu duke u ngritur në këmbë dhe për habinë e Albit, para se t'ia kthente shpinën për t'u larguar, ia zgjati dorën miqësisht.

Albi, gjeti forcë sa të çokej me të dhe të shkonte në dhomën bleroshe.

...takimi me kulshedrën...

Me të kënduar bilbilat, Albi u ngrit, doli në sallon dhe shkoi e u ul në karrigën e bardhë, pranë tavolinës së mbuluar me cohë të blertë. Nuk vonoi dhe pranë tavolinës ia behu Kulshedra. Albi u ngrit, ndërsa Kulshedra, i qeshur, ia zgjati dorën Albit dhe u ul në karrigen e kaltër, pa thënë asnjë fjalë. Albi po priste që ai ta çelte bisedën. Ai, pasi ngërtheu vetullat e trasha, ia nguli sytë e zi futë Albit, tha si përtueshëm:

- Nga popujt evropianë, ne, albërezët i patëm më të afërtit, por nuk e di përse na u ngatërruan punët?

- Na u ngatërruan interesat pushtetore, zotëri i nderuar, prandaj. – tha Albi duke u prirë në gaz.

- Sot, largësitë midis nesh sikur janë zvogëluar, por nuk di se çfarë po ndodh me interesat?

- Ju, me punë këmbëngulëse, me përpjekje të mëdha e falë reformave në drejtim të duhur që ndërmorët para pesëmbëdhjetë vjetësh, më në fund, u bëtë fuqi e afirmuar botërore, por interesat tona sikur nuk po na afrohen. Ne, ende mbetëm popull i ndarë në gjashtë pjesë, kurse ju po mundoheni të ruani ato që keni. Ne, nuk i harrojmë ndihmat tuaja në kohën kur as për veten tuaj nuk kishit mjaft. Ne, edhe tash kemi nevojë të madhe për miqësinë tuaj, mirëpo, me rritjen e forcimin tuaj të madh, interesi juaj për ne, pa fajin tonë, sikur është zvogëluar. – tha Albi.

- Mos harroni se edhe ne jemi ende të ndarë në dy pjesë. Por kjo është temë tjetër. Pastaj ua rikujtoj se as ne nuk e kemi harruar përkrahjen tuaj të madhe diplomatike për të zënë vendin tonë të uzurpuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ju njoftoj se te ne, me gjithë periudhën e ftohjes së marrëdhënieve që patëm, po rritet interesi për të ringjallur miqësinë me ju, por njëkohësisht duam që të ruajmë miqësitë që kemi krijuar në ndërkohë. Ju e dini dhe e kuptoni se politika e

jashtme e çdo shteti nuk mund të jetë në kundërshtim me politikën e tij të brendshme dhe në kundërshtim me rrethanat e përbërjen e tij të brendshme.

- Të gjitha këto që Ju thoni, ne, në mënyrë të plotë, i kemi parasysh, por ne gjithashtu vërejmë se politika juaj nuk është më e interesuar që të shkaktojë kriza dhe që të nxjerrë përfitime nga krizat në botë...

- Kjo është e saktë, zotëri dhe po më vjen fort mirë që e paskeni hetuar këtë anë të politikës sonë të jashtme. – ndërhyri Kulshedra.

- Pikërisht për këtë, ne mendojmë se ju me peshën tuaj tashmë jo të vogël politike e ekonomike në botë, mund të ndikoni që kriza midis ne albërezëve e serbëve në pushtet të mund të zgjidhet në favor të shuarjes së krizës së fundit politike në Ballkan. – kështu tha Albi dhe me shikim të përqendruar në fytyrën e Kulshedrës, u ndal në pritje që ai të fliste. Pa vonuar shumë, Kulshedra tha:

- Më thoni, zotëri se çfarë mund të bëjmë ne në këtë drejtim?

- Nuk po futem në histori për të kursyer kohën tuaj të vlefshme, por po e them një të vërtetë për ata që kanë mend dhe duan të mendojnë. Bashkëjetesa e dhunshme e Dardanisë me Serbinë faktikisht ka marrë fund.

- Jeni të sigurt, zotëri, për këtë që thoni?

- Po. Shpirtërisht, ushtarakisht, politikisht, ekonomisht e financiarisht Dardania definitivisht është ndarë nga Serbia. Kanë mbetur vetëm edhe disa lidhje formale-juridike e telefonike me Serbinë. Interesi i popullit serb është që të lirohet njëherë e përgjithmonë nga barra njëqindvjeçare e Dardanisë, ndërsa interesi i garniturës në pushtet është që kriza të vazhdojë deri në pambarim për të mbetur ata në pushtet...

- Ne, sikur kemi informata të tjera lidhur me këtë çështje. – tha Kulshedra.

- Ato janë vetëm dezinformata që mund të krijojnë konflikte e gjakderdhje të reja me implikime të paparashikueshme. Ju, atje, edhe pse jeni larg keni mundësi të mjaftueshme që të mblidhni informata të bollshme vetanake, mirëpo, me këtë rast nuk po mund të durohem pa rikthyer vëmendjen tuaj në një fakt fort të madh e të rëndësishëm. – Albi, u ndal pak dhe mori frymë thellë.

Kulshedra përqendroi vëmendjen te bashkëbiseduesi përballë. Albi vazhdoi:

- Pesë popuj sllavë, shumë të afërt me serbët, me të cilët jetuan në një bashkësi shtetërore për shtatë-tetëdhjetë vjet, pasi u ngopën bashkëjetesë me regjimet serbe e disa prej tyre, madje bënë edhe luftëra të përgjakshme për t'u liruar nga përqaftimi i tyre ngulfatës, definitivisht u ndanë prej tyre. Tani pushtetmbajtësit serbë pretendojnë që Dardanët, të cilët janë albërezë dhe nuk kanë asgjë të afërt me serbët, përkundër të gjitha të zezave që pësuan prej tyre, të mbeten edhe më tutje nën sovranitetin e pushtetin e tyre. Kjo kërkesë e këto insistime janë një dhunim i arsyes elementare njerëzore. – tha Albi e u mbështet për karrige.

Kulshedra shikoi orën dhe duke u ngritur në këmbë tha buzagaz:

- Paj, ne, në vendin tonë e kemi një fjalë të urtë që thotë: *ARSYEJA ARSYETON, KURSE VETËM ZEMRA DREJTPLEQËRON...*

- Fjalë e vërtetë! – tha Albi dhe u ngrit në këmbë.

Kulshedra ia zgjati dorën Albit, ktheu shpatullat dhe u largua. Albi u drejtua kah dera bleroshe.

...takimi i vrullshëm i njëmbëdhjetë perëndive...

Në mbrëmjen e së shtunës, komandot e vunë Albin në një xhip me perde dhe e transferuan në një pallat tjetër jo larg nga pallati ku ishte.

Në mëngjesin e së dielës, salloni i djeshëm me tavolinën e mbuluar me cohë bleroshe u shndërrua në një sallon luksoz për bisedime për pesëmbëdhjetë veta.

Tavolina e rrumbullakët në midis të sallonit ishte mbushur përplot me ushqime, sallata, pemë e pije. E gjithë hapësira kundërmonte erë ushqimesh, pemësh e pijesh.

Fiks në orën dhjetë, të njëmbëdhjetë perënditë u mblodhën rreth tavolinës rrumbullake. Në të djathtë të Balenës qëndronte kokëlartë Ariu, ndërsa në të majtë të tij qëndronte Kulshedra vetulltrashë e kokulur. Balena, pasi që shikoi të gjithë të pranishmit një nga një, nisi të fliste me ngadalë:

- Dita e djeshme ishte ditë shikimi, dëgjimi e hetimi. Sot do ta shqyrtojmë gjendjen e situatën në mënyrë sa më të gjithanshme dhe do të marrim vendime. Ne, dje, pamë se kemi të bëjmë me një burrë jashtëzakonisht mendjehollë, të ekuilibruar dhe fort të vendosur. Besoj se ndaj mendimin tim me ju se ne nuk kemi të bëjmë vetëm me një njeri, por kemi të bëjmë me një përfaqësues të tërë një populli. Me të dhe me mendimet e qëndrimet e tij janë të gjithë albërezët e zgjuar dhe do të jenë edhe ata që po zgjohen çdo ditë e më shumë. Sa më shpejt e sa më drejt që të veprojmë, vala e turmave kundër nesh do të jetë më e vogël dhe më e përbalueshme. Turmat po zgjohen, jo vetëm në Albëri, por edhe në pjesë tjera të botës, prandaj, mendoj, ne nuk mund të qëndrojmë më me konceptet e vjetra dhe defensive, por duhet të gjejmë zgjidhje të kohës dhe të jemi aktivë. Duhet, gjithashtu të marrim një vendim se çfarë do të bëjmë personalisht me Alb Prometeun, çfarë do të bëjmë me Dardaninë dhe çfarë do të bëjmë me popujt që nuk po pajtohen më me çfarëdo forme të robërisë? Kaq pata sa për fillim, sa për ta hapur bisedën tonë tejet të rëndësishme. Koha nuk po pret.

Ariu, lëvizi paksa nga vendi dhe i bëri shej me sy Balenës se donte të fliste. Ariu tha:

- Unë e kam vetëm një pyetje të shkurtër e të qartë. Ku qëndron shkaku që ne jemi duke i dhënë kaq rëndësi të madhe Dardanisë së vogël? Si mund të prishim një rend e një rregull historik e juridik kaq të rëndësishëm e kaq të madh për një popull e për një vend kaq të vogël e kaq të parëndësishëm. A nuk po e shihni ju,

zotëri të nderuar, se nëse ne do të prekim vetëm pak në këtë rend e në këtë rregull do të dalim në një fushë të panjohur dhe me plot rreziqe për paqen e stabilitetin botëror? Pastaj, zotërinj të nderuar, unë e pranoj se z. Alb Prometeu është një burrë e trim i paepur, mirëpo, më vjen keq që më duhet të them se ai ishte shumë prepotent, shumë i vrazhdë dhe shumë i paskrupullt. Ai sillej sikur ishte i barabartë me ne duke harruar atë thënien latine se çfarë u ka hije perëndive nuk u ka hije buajve. Mos harroni se çfarë qëndrimi brutal pati ai ndaj z. Balenës. Pastaj, ai, insiston me këmbënguljen më të madhe në dëshirën dhe vullnetin e popujve në përcaktimin e kufijve. Ju mund ta merrni me mend se çfarë rrëmuje e hatashme do të krijohej në Evropë e në gjithë botën zbatimi i këtij parimi. Unë insistoj me këmbëngulje për njohjen e respektimin e territorialitetit e sovranitetit ekzistues të shteteve në botë. Prandaj, unë jam i mendimit se një njeri me qëndrime e pikëpamje si z. Alb Prometeu duhet të dënohet në mënyrën më të ashpër që të mos i bjerë ndërmend askujt në Dardani të organizojë protesta e demonstrata qofshin ato në formën edhe më paqësore. Për Dardanië, jam i mendimit që gjithsesi të mbetet nën sovranitetin e Serbisë, kurse për popujt që nuk pajtohen me robërinë të përdoren, në një rën anë, masa të buta reformuese, ndërsa në anën tjetër të përdoren veprime serioze disiplinuese, në mënyrë që me çdo kusht të ruhen kufijtë ekzistues në botë. Tashpërtash kaq pata.

Luani ngriti dorën dhe mori fjalën. Ai filloi butë e urtë:

- Brenga e z. Ariu nuk është pa baza, mirëpo zotëria nuk ka të drejtë kur shpreh mendimin se *DUHET BETONUAR POLITIKA NDËROMBËTARE DHE ROLI YNË NË BOTË*. Ne, duhet ta kemi fare të qartë se përse është fjala në këtë kapërcyell shekulli. Dardania është vetëm shkas, por, në të vërtetë, nuk është tash fjala vetëm për Dardanië dhe për çështjen e albërezëve, por është fjala për politikën tonë gjenerale, për sot e për të ardhmen. Me fjalë pak më të qarta dua të them: para nesh shtrohet pyetja: *NËSE DO TË VAZHDOJM EDHE MË TUTJE TË MERREMI ME ZJARRFIKJE POLITIKE, APO DO TË NISIM TË MERREMI ME PARANDALIMIN E ZJARREVE E TË KRIZAVE POLITIKE?* Të gjitha krizat aktuale politike me të cilat tash, në një mënyrë ose në një tjetër, po merremi, e kanë parahistorinë e historinë e tyre. Le të mos shkojmë shumë larg në histori, por le t'ia fillojmë nga shekulli i njëzet. Sikur ne, në atë kohë të liroheshim nga koncepti i zjarrfikjeve politike e të kalonim në konceptin e parandalimit të zjarreve e të krizave politike, ne do të silleshim ndryshe me Hunin e me Latinin...

- Si do të silleshim ndryshe? – ndërhyri Ariu pa marrë leje për të folur.

- Ja, vetëm pak durim që të qartësoj mendimin tim. Nëse ne do të kishim dijen politike e vetëdijen e mjaftueshme njerëzore që kemi sot, Hunin dhe Latinin, me kohë e jo me vonesë, do t'u lejonim që të merrnin pjesë në ndarjen botërore të territoreve, të lëndëve të para e të tregjeve dhe nuk do ta kishim Luftën e Parë botërore dhe nuk do të na shfaqej diktatura komuniste në Rusi. Nëse ne, në atë

kohë, do ta njihim të drejtën për vetëvendosje të popujve nën perandoritë Otomane e Habsburge dhe të angazhoheshim për realizimin e këtyre të drejtave, ne nuk do ta kishim Luftën e Parë botërore. Nëse ne, më vonë, do të angazhoheshim për të drejtën për vetëvendosje të popujve nën perandorinë cariste ruse, ne nuk do ta kishim Luftën e Dytë botërore...

- E ku po i le perandoritë anglo-franceze, zotëri Luan? – ndërhyri Ariu prapë pa leje, në mënyrë edhe më të vrazhdë.

- Ja, ja, po vazhdoj, po vazhdoj edhe me veten time. Po të dinte Mbretëria e Bashkuar me kohë dhe pa vonesë që të njihite të drejtën për vetëvendosje për popujt nën sundimin e saj, nuk do të kishim krizat politike me Elefantin dhe me shtetet tjera në Azi, me shtetet në Afrikë e gjetiu. Po të nxirrte mësim Gjeli, nga ato çfarë pësuam ne më herët, edhe ai do të njihite të drejtën për vetëvendosje për popujt në Indokinë, për popujt në Afrikë e gjetiu dhe nuk do të humbiste njerëz, mjete e kohë kot.

Pllakosi një heshtje varri. Asnjëri nuk kërkonte fjalën. Ariu i shikoi kërcënueshëm të gjithë me radhë dhe pastaj i bëri Balenës shej se donte të fliste. Goditi me aq forcë para vetes tavolinën masive saqë kërcyen përpjetë të gjitha gotat e pjatat, që kishte para vetes dhe ato që ishin te fqinjët e tij në të majtë e në të djathtë. Gjysma e pjesëmarrësve u trembën, por nuk çelën gojën. Ariu tha me zë të lartë:

- Domethënë, sipas jush, si po ju kuptoj unë, ne u dashka të kapitullojmë para kërkesave të turmave rreckamane e kokëkrisura?! E, jo! Kurrën e kurrës!

Pas një heshtjeje të shkurtër, ngriti dorën Hunja e tha:

- E, zotëri i nderuar, unë nuk po e kuptoj si duhet e sa duhet politikën tuaj. Para pak vjetësh ju u pajtuat ashtu si ishte me vend me pavarësinë e Estonisë, Letonisë e Lituanisë. Pastaj u pajtuat, ashtu si ishte me vend, me pavarësinë e Ukrainës, Bjellorusisë dhe të disa republikave turanike, atje në kontinentin e Azisë, kurse tani merrni anën e Serbisë dhe jeni kundër pavarësimin të Dardanisë. Para pak vjetësh, të themi kushtimisht, hoqët dorë nga territoret, *TUAJA, NDËRSA TANI MBRONI TERRITORET E HUAJA!* Na thoni, Ju lutem, ç'po ndodh me politikën tuaj?

- Ne, duke mbrojtur interesat e Serbisë, mbrojmë interesat tona dhe paqen botërore. – tha Ariu me vendosmëri.

Gjeli, çoi dorën e tha:

- Ju, si duket, nuk i njihni si duhet e sa duhet albërezët. E dini Ju se çfarë helmetkorporje mbante Gjergj Kastrioti në kokë, udhëheqësi i kryengritjes albëreze kundër otomanëve, në mesjetë?

- E di, e di, janë kokëfortë e inatçi si cjeptë dhe gjatë luftërave të shumta që kemi pasur me otomanët, me ushtarët e tyre arnautë kemi pasur më së shumti kokëçarje... – tha Ariu fare serioz.

- Si, i ditki këto punë dhe nuk pushoni të yshtni aleatët tuaj, serbët, kundër albërezëve?!

- Paj, serbët po duan vetë e, nëse ata duan, ne jemi këtu për t'i përkrahur e mbështetur...

- Vërtet? Po, a ju shkon juve ndërmend se nëse ne do të lejojmë që albërezët të formojnë armatën e tyre e të armatosen me armët tona, serbët do të jenë humbës dhe madje do të detyrohen të paguajnë edhe dëmshpërblimet e luftës? Albërezët kanë motive të forta për të luftuar e për të vdekur, ndërsa serbët nuk i kanë ato motive. – tha Gjeli duke luajtur nga vendi.

- Nëse serbët duan, ne, nuk do të hezitojmë. Kurrë! Kurrë! Kurrë! – tha Ariu duke shtrënguar grushtet.

- Edhe ne patëm thënë në kohën tonë, kështu si po thoni ju tash, kurrën e kurrës, mirëpo, ne e paguam shumë shtrenjtë kokëfortësinë tonë, për të mos thënë mendjemadhësinë tonë. Ne, nuk po kapitulujmë para turmës rreckamane e kokëkrisur, siç po e quani Ju, por po korrigojmë gabimet tona dhe po zëvendësojmë mosdijen tonë me një praktikë të përparuar e humane, ashtu siç i ka hije shoqërisë sonë demokratike. Pastaj qëndrimi Juaj për të dënuar ashpër Alb Prometeun, për kohën tonë është shumë démodé. Ju, duhet ta dini, të paktën aq sa e di edhe unë, se turmat gjithmonë kërkojnë heroin e vet të gjallë ose të vdekur që të mund të bashkohen rreth tij për të vazhduar luftën që të sendërtojnë kërkesat e tyre. Kaq të verbër jeni ju, ose po bëheni të këtyllë. Më lejoni zotërij të nderuar që meqë e kam shtegun të përmend Dë Golin, udhëheqësin tonë të madh në kohën e kryengritjes algjeriane. Si dihet, në këtë luftë, shkrimtari ynë i madh, Zhan Pol Sartri, mbante anën e algjerianëve dhe madje, në rrugët e Parisit, shpërndante gazetën, që përkrahte lirinë e algjerianëve. Shkon ministri i punëve të brendshme të Francës te Dë Goli dhe i sugjeron që të arrestohet Sartri. Dë Goli i madh e kishte pas shikuar rreptas ministrin e vet dhe i kishte pas thënë: "Zotëri, mund të burgoset Volteri?!" Çdo popull e ka nga një Volter të vetin. Prandaj ju këshilloj që ju të modifikoni qëndrimet tuaja politike me kohën...

- E, kush jeni ju, e kush jemi ne? – tha me arrogancë Ariu?

- Ne jemi ata që kemi mbledhë e që do të mbledhim mend, kurse ju jeni ata që mendoni se forca është ilaç për gjithçka e për të gjitha kohët. Ja, nuk po shkoj më larg në kohë, po e marrim shembullin më të freskët dhe më të afërt që kemi edhe ne edhe ju. – Gjeli, pushoi paksa. E, pasi që i shikoi të gjithë me radhë, vazhdoi: Edhe Millosheviçi thonte – kurrën e kurrës! Dhe, çfarë ndodhi?...

- Po, - ndërhyri Ariu pa kërkuar fjalën-, ndodhi ajo çfarë ndodhi pas përzjerjeve e ndërhyrjeve tuaja gjithandej ish- Jugosllavisë dhe në fund, në Dardani, pasi iu vërsulët të gjithë së bashku Serbisë së gjorë...

Edhe Gjeli ngriti zërin, goditi tavolinën para vetes e tha:

- Si, menduat, Ju, zotrote, të shikonim duarkryq ndërsa kasapi i Ballkanit bënte pastrimin etnik të Dardanisë, vriste e dhunonte gra e fëmijë, digjte e shkruibonte fshatra e pasuri?!...

- Paj, - klithi Ariu, - a jemi, apo nuk jemi për respektimin e rendit botëror? A jemi për respektimin e integritetit e të sovranitetit të shteteve? Pastaj, përse ne të mos mund të përkrahim Serbinë njësoj si dikush që mund të përkrahë Izraelin. Përse vetëm ne duhet të modifikojmë qëndrimet tona?

- Ne jemi, për modifikimin edhe të sjelljeve tona edhe të rendit botëror. Ne, nuk do të lejojmë kurrsesi që edhe në Ballkan të na krijohet një Palestinë si po duket se ju po dëshironi. Ne, nuk mendojmë se çdo gjë është e shtangur dhe e dhënë një herë e përgjithmonë. Sferën e lirisë, dalëngadalë, megjithatë duhet ta zgjerojmë – tha Gjeli edhe më me vendosmëri.

- E, zotërij, - Klithi Ariu duke qitur stërpikë nga goja, - nëse mendoni se ne atje në Kremlin jemi budallenj dhe se do të mbetemi tërë jetën budallenj, mashtroheni fort! Zgjerimin e dalëngadalshëm të sferës suaj të lirisë, si po thoni ju, ne po e ndiejmë dalëngadalë si ngushtim të sferës së lirisë sonë, si ngushtim të territorit tonë dhe si ngufatje të frymëmarrjes sonë. Prandaj, ta keni të qartë njëherë e përgjithmonë se nuk do të ketë më lëshime as për Albërinë, as për Çeçeninë, as për Kurilet, as për Polin e Veriut, as për rrotën e samës!...

Atmosfera në sallonin e rrumbullakët u bë e valë. Në e parë, pjesëmarrësit në takim, për fjalinë e fundit të Ariut menduan se ishte ndonjë gabim gjuhësor për shkak të mosdijes së mjaftueshme të anglishtes, mirëpo, pas një heshtjeje fort të tendosur, në vendëse të qetësohej, Ariu bëri edhe një skandal tjetër të palejueshëm diplomatik, kur iu drejtua Kulshedrës, në të majtë të Balenës, me fjalë shumë të ashpra përcjellë me gjeste tepër përbuzëse:

- Po, Ju zotëri, si po mund të qëndroni pa hapur gojën, aq i ftohtë e aq i qetë si ndonjë statujë Bude? Sikur e gjithë kjo dinakëri për të zgjeruar sferën e politikës së Bashkimit Evropian nuk ka fare të bëjë me ju dhe sikur jeni duke jetuar në Mars!...- Ariu u ndal pak e shpërtheu prapë: - Nuk e kuptoni, apo po bëni sikur nuk e kuptoni se ky zgjerim i ngadalshëm i sferës së lirisë për të cilin po përpiqen me të gjitha mënyrat, mjeshtëritë e dinakëritë miqtë tanë perëndimorë, pasi të na zhveshë ne do të ju përfshijë edhe juve?

Kulshedra, buzagaz, ngriti kokën lart, ngërtheu vetullat e trasha e tha:

- Paj, ky është globalizmi, Zotëri, të cilit nuk mund t'i shpëtoni as ju, as ne. Mirëpo, Ju, nuk keni të drejtë të zemëroheni dhe aq më pak të brengoseni për ne. Ne, i dimë vetë punët tona. Mos e harroni historinë! Sa herë që njerëzit janë përpjekur që rezultatet e përdorimit të forcës së tyre t'i kthejnë në ligje të shenjta kanë kaluar fort keq. Historia është plot me shembuj të këtillë. Pastaj, mos e harroni fjalën e urtë të cilën e kanë pothuaj të gjithë popujt e botës dhe e cila thotë se çfarë

të mbjellësh do të korrësh. Ju sot, në një takim fort intern dhe konspirativ, po korrni atë që keni mbjellë prej vitesh...

- Çfarë paskemi mbjellë, ne, prej vitesh? – pyeti Ariu Kulshedrën me zemërim të vrazhdë dhe pa kërkuar leje që të merrte fjalën.

- Ju, po abuzoni me butësinë e tolerancën tonë të tepruar ndaj jush. – Tha Kulshedra me zë prajshëm

- Çfarë po abuzoj unë, o i paturp?! – ndërhyri përsëri Ariu edhe më me mllef.

Salla po kallej flakë nga mosdurimi i të gjithë të pranishëmve, por Kulshedra vazhdoi me maturi:

- Po abuzoni të drejtën për të folur dhe për të ndërprerë të tjerët pa kërkuar fjalën sipas rregullores që kemi aprovuar të gjithë...

- Ah, më falni, më falni! – tha Ariu me cinizëm...

- Ju ka falur Zoti, por Ju po silleni sikur të ishit cari vetë, kurse ne, të pranishmit këtu po na trajtoni sikur dofarë gubernatorësh atje, tek ju. Ne, sot, nuk kemi nevojë për të duruar tutorizmin tuaj...

- Kështu?! Këtë nuk e kam pritur prej jush, kurrsesi...

Kulshedra, nuk çeli më tutje gojën, por vetëm luajti dorën në mënyrë përçmuese. Qetësia e valë u bë e padurueshme.

- Tash po e shoh, ndërhyri Luani duke u munduar ta frenonte nervozizmin e vet, se sa fort paska pasur të drejtë Çerçilli i madh kur, në kohën e vet, këshillonte Evropën demokratike që të mos e fuste Rusinë në institucionet demokratike ndërkombëtare, sepse ajo, siç thoshte ai, ka për t'i krimbur e ka për t'i përdhosur ato...

- Zotëri, zgjidhni fjalët!- klithi Ariu me zë të lartë e goditi tavolinën para vetes me të dy grushtet. Shumë gota e shumë shishe u rrëzuan.

- Për ata që nuk zgjedhin fjalët e veprimet e veta nuk do të zgjedhim më as fjalët as veprimet...

- Ju lutem! – çoi dorën e kërkoi fjalën Hunja. – Sa po marr vesh unë, Ju, zotëri, keni ardhur në një përfundim fort të gabuar. Ju, si po duket hapur, durimin e gatishmërinë tonë për të kooperuar me ju, po e kuptoni si frikë nga ju. Viteve të fundit, ne ju kemi bërë shumë lëshime juve dhe vasalëve tuaj. Ju, me qëndrimet tuaja, tash disa vjet, keni terrorizuar politikën ndërkombëtare...

- Ne?! – klithi Ariu me dëshpërim.

- Po. Ju! – ia ktheu Luani me të njëjtin ton e vazhdoi, - ju po doni që të betononi marrëdhëniet ndërkombëtare duke u thirr orë e qas në rendin ndërkombëtar dhe në të drejtën për integritet e sovranitet të shteteve. Ne, e dimë se si kemi vendosur të drejtën ndërkombëtare bashkë me ju. Ju, me qëndrimin tuaj, po doni përsëri të na ktheni në ligjet e më të fortit e të dhunës. Ju, me qëndrimin tuaj po doni që përsëri të ringjallni epokën e krizave permanente dhe të ngrohni duart tuaja në zjarret e popujve të pushtuar e të okupuar. Jeni zgjeruar në dy kontinente e po

doni të zgjeroheni edhe në kontinentin e Arktikut. Po doni përsëri ta ndizni zjarrin në Ballkan...

Ariu, ngriti dorën për leje e tha me ton çuditërisht të butë:

- Ne, zotërinj, erdhëm këtu me qëllim që të bindim atë farë Alb Prometeun që të bëhet me ne e, si po shoh e po bindem unë, shumica prej nesh qenka bërë me të, prandaj kërkoj gjysmë ore pushim që të këshillohem me qendrën time në Moskë...

Të gjithë u bindën se Ariu donte me çdo kusht të minonte takimin, prandaj nuk e zgjatën më tej dhe u tërhoqën në dhomat e veta. Salloni u zbraz.

...ikja e ariut pa lamtumirën diplomatike...

As pas një ore, as pas dy orësh Ariu nuk u duk më në kolltukun e vet përbri Balenës, rreth tavolinës rrumbullake në sallonin e ndërtesës cilindrike. Pas kësaj kohe, Balena pyeti në zyrën e Bordit të pallatit se mos dinin të tregonin se ku ishte z. Ariu.

Ata të Bordit e njoftuan Balenën se përmes një dere sekondare të pallatit, para dy orësh z. Ariu ishte larguar me një taksì të pallatit në drejtim të aeroportit...

...takimi i dhjetëshes së perëndive pa ariun...

Pa z.Ariun, atmosfera ishte e qetë, por paksa jo aq nxitëse për muhabet si me të.

I pari, ashtu si i takonte, foli Balena:

- Si po e shihni z. Ariu u largua në mënyrë jodiplomatike, pa na thënë as lamtumirë e pa dhënë asnjë sqarim. Vetëm Hrushovi, në kohën e vet, ka bërë skandale të këtilla diplomatike. Unë mendoj se fajin e kemi ne vetë e në rend të parë, më fajtori për këtë është vendi im, sepse ç'prej disa vjetësh jemi treguar shumë durimtarë, shumë tolerantë e tepër lëshimtarë ndaj qëndrimeve e kërkesave të tyre. Unë mendoj se qëndrimet e tij në këto tubime kanë qenë në përputhje të plotë me instruksionet nga qendra e tij dhe largimi i tij prej këtu, në këtë mënyrë, është bërë me dijen e plotë të Moskës. Kjo ishte një përpjekje për të kthyer ethet siberiane në diplomacinë botërore, për të përçarë Evropën, për të krijuar polin antievropian dhe antiatlantik ndërkombëtar. Mendoj se gjatë kësaj kohe kemi qenë mase kooperativ dhe mase lëshimtarë dhe, mendoj se me të gjitha dëmet që i kemi sjellë politikës sonë paqësore-parimore, kemi bërë fort mirë që kemi qenë deri në fund të këtillë. Mirëpo, krejt kjo politikë jona, nga ana e tyre, është vlerësuar si dobësi dhe është konsideruar se ishte koha për shtimin edhe më energjik të trysnive destruktive ndaj nesh.

Ne patëm rast edhe në këtë vend që të bindemi, në mënyrë më të drejtpërdrejtë, për qëndrimet dhe qëllimet e tyre retrograde e fort të rrezikshme për të bllokuar funksionimin e institucioneve me përgjegjësi ndërkombëtare... Prandaj, më lejoni të propozoj që ne, Ariun, që nga dita e sotme, duhet ta konsiderojmë si të vetëleçitur nga grupi ynë që merret me problemet që kanë të bëjnë me qeverisjen e botës, pa obligim që ta ftojme më në mbledhjet tona dhe pa të drejtë që ai, eventualisht, të kthehet më në kolektivin tonë. Zotërinj, e keni fjalën.

Fjalën e kërkoi Keopsi e tha:

- Po të mos kisha qenë tërë kohën dëshmitar okular dhe po të mos kisha dëgjuar me veshët e mi të gjitha ato që dolën nga goja e z. Ariut, nuk do të kisha besuar se politika e tyre ka pësuar një metamorfozë kaq negative dhe se ata janë zhytur kaq thellë në koncepte politike që nuk janë aspak në përputhje me kohën e rrethanat ekzistuese botërore. Ata, po i kthehen politikës imperialiste dhe për më keq po mundohen të na e imponojnë edhe neve politikën e tyre hegjemoniste, me kriza permanente politike e ekonomike. Pajtohem plotësisht me fjalën e propozimin e z. Balenës.

Elefanti, ngriti surlen, kërkoi fjalën e tha:

- Ne kemi interesa të mëdha ekonomike me Moskën. Mirëpo, ne kemi interesin më të madh ruajtjen e paqes sepse vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet parakushti kryesor edhe për zhvillimin tonë edhe për zhvillimin e botës. Në këtë pikë, ne, duhet të jemi të pakompromis dhe unikë. Pajtohem me fjalën e z. Balenës dhe me propozimet e tij. Është koha e fundit që, ne, të korrigjojmë veten tonë dhe gabimet që kanë bërë të tjerët para nesh dhe duke krijuar klimën e kthesave të mëdha politike e ekonomike në botën e sotme, ta lirojmë njerëzimin nga ankthet permanente...

Dielli, kërkoi fjalën e tha:

- Nëse nuk duam që të na përsëritet historia, ne, duhet të bëjmë ndryshime substanciale e humanitare në politikën tonë. Vendi im është një shembull i ndritshëm se çfarë fiton një vend që bën kthesa të mëdha politike e ekonomike.

Majacteku, ngriti dorën, kërkoi fjalën e tha:

- Amerika Latine, më duhet të them hapur dhe pa ekuivoqe, është në ngërçe të mëdha dhe në telashe shumë të rrezikshme. Kriza e Dardanisë është lojë fëmijësh në krahasim me erupcionet e mëdha që po përgatiten te ne. Mirëpo, edhe çfarë do të duhej të ndodhte në Dardani që atij populli t'i njëhej e drejta e merituar për vetëvendosje? Duhet të veprojmë shpejt dhe të pushojmë që edhe më tutje të merremi me armime politike. Pakoja e Ahtisarit ishte për t'ia bërë qejfin Serbisë terroriste e Rusisë imperiale e hegjemoniste. Ne, gjërat politike duhet t'i zgjidhim në mënyrë të pastër e të mos lëmë prapa vetes vatra kanceroze politike të cilat mund të shpërthejnë përsëri. Vetëm kjo është mënyra sesi do të mund të demokratizojmë Serbinë e Rusinë e jo duke u bërë atyre lëshime të njëpasnjëshme. Mjaft më me

hezitime, taktizime e kalkulime! Agresorët duhet të dënohen e jo të përkëdhelen. Kjo është rruga për të qeruar hesapet me regjimet terroriste...

Gjeli, ngriti bishtin, kërkoi fjalën e tha:

- Unë fola mjaft qëparë, mirëpo dua të shtoj edhe këtë: A jemi ne duke ndërtuar një Evropë të bashkuar si model për liri, demokraci dhe prosperitet, si shembull për krejt botën, apo jemi duke bërë pazarllëqe të pafund me Rusinë, që po orvatet të kthejë diktatet e carëve e me Serbinë, e cila nuk po pranon madje as se ka bërë agresion kundër një populli të pambrojtur, por po luan rolin e viktimës. Unë mendoj se Evropa duhet të shndërrohet në protektor të Dardanisë dhe ta përgatisë atë që me vetëvendosje t'i japë fund agonisë së shqiptarëve të pafajshëm dhe të serbëve të lodhur dhe të stërlodhur nga politika hegjemoniste e kralave, të diktatorëve komunistë dhe të pasardhësve e të mbeturinave të këtyre sojeve të Serbisë...

Hunja, lëvizi nga vendi, kërkoi fjalën e tha:

- Ju e dini të gjithë se sa interesa të mëdha ekonomike kemi ne me Rusinë e Serbinë, mirëpo ne jemi të gatshëm që të përballemi edhe me një krizë të madhe të përkohshme ekonomike, por që t'i japim fund një herë e mirë politikës turbulluese, tash gati dyqind- vjeçare të Ruisë e të Serbisë në Evropë e jo vetëm në Evropë. Mirëpo, nëse vendosim, duhet të veprojmë shpejt, me vendosmëri dhe të mos merremi me arrime politike, si tha me të drejtë një parafolës këtu...

Latini u kollit dhe ngriti gishtin për të marrë fjalën. Ai tha:

- Nuk jam për të ndëshkuar Serbinë dhe për ta ngarkuar me barrë politike e ekonomike të cilën nuk do të mund ta bartë, mirëpo edhe Dardanisë duhet t'ia sigurojmë rrugën drejt pavarësisë së merituar...

Luani bëri me shej kah Balena dhe e mori fjalën:

- Pajtohem plotësisht me ato që tha z. Balena. Pajtohem gjithashtu edhe me të gjithë parafolësit. Pajtohem gjithashtu me masat që propozoi ai lidhur me Rusinë; si dhe propozoj që në Daradani të ndërrohet nga themeli stafi i OKB-së dhe të zëvendësohet me njerëz kompetentë dhe të pakorruptueshëm, ose më mirë të themi, minimalisht të korruptueshëm nga Bashkimi Evropian. Po ashtu propozoj që lidhur me Alb Prometeun të veprohet në atë mënyrë që ndaj tij, shkallë-shkallë, të zvogëlohen masat e dhunës dhe një ditë në mënyrë të heshtur, gjatë ndonjë manifestimi të madh popullor në Kosovë, në qetësinë më të madhe, ai të lirohet edhe nga akuzat absurde me të cilat ai burrë është ngarkuar arbitrarisht. Mjaft më me këshillat, sugjerimet e suflimet e dallaverexhijve, që po na lëbyren tash një kohë të gjatë nga hapësira e Dardanisë, por duhet ta dëgjojmë zërin autentik të popullit të Dardanisë e ky është Alb Prometeu. Njerëzit e mençëm, të ndershëm e të vendosur si ky, në të ardhmen, nuk do t'i duhen vetëm popullit të vet, por edhe Evropës edhe Amerikës edhe gjithë botës. Kaq nga ana ime.

Balena i hodhi një vështrim Kulshedrës, mirëpo ai nuk dha asnjë shej që donte të fliste. Atëherë Balena përfundoi fjalën e vet kështu:

- Më duket se vetëm me një abstenim, - ai i hodhi edhe një shikim të shpejtë Kulshedrës në krahun e tij të majtë e vazhdoi, - nga dhjetë veta, sa jemi të pranishëm, nëntë prej nesh u morëm vesh që bashkarisht të punojmë me vendosmëri për sendërtimin e synimeve tona për kthesa të mëdha në politikën dhe ekonominë e Ballkanit, të Evropës e të mbarë botës. Zotërinj, le ta kemi të qartë se qarqet mafioze, kriminale e terroriste në Moskë, viteve të fundit, kanë rritur tej mase ndikimin e tyre mbi pushtetin aktual dhe ka rrezik të madh që ato qarqe ta rrëmbejnë pushtetin e plotë atje. Prandaj, ne, urgjentisht, me veprimet tona të vendosura duhet ta ndërpresim atë proces negativ, atje. Kur një gjë e tillë, para njëzet vjetësh, pati ndodhur në Serbinë e vogël, ne, e patëm nënçmuar dhe nuk patëm marrë masa e nuk patëm ndërmarrë veprimet e duhura që të parandalonim tragjeditë e shumta që shkaktuan mafiozët, kriminelët dhe terroristët shtetërorë të atjeshëm. Përgjegjësia bie mbi ne e në rend të parë mbi shtetin tim. Prandaj, ne jemi kaq energjikë dhe të përkushtuar që të kalojmë në politikën e parandalimit të krizave e të tragjeditë e jo të mbetemi rob të disa formaliteteve, që tentojnë të na mbajnë edhe më tutje peng të politikave zjarrfikëse. Afganistani e Iraku duhet të jenë përvojat tona të hidhura e të fundit të këtij lloji. Po të kishim vepruar me kohë dhe energjikisht kundër politikës së talebanëve në Afganistan e të “kasapit” të Ballkanit, ndoshta nuk do ta kishim “kasapin” e Bagdadit, sepse ai do t’i kishte para vetes leksionet e sakta e serioze. Ju, besoj se e dini, zotërinj, se përshëndetjet e fundit, para se ta varnin, kasapin e Bagdadit, ai, i kishte pas dërguar përshëndetjet e dëshirat e veta më të mira Sheshelit, një kasapit tjetër të Beogradit, i cili, siç e dini, pret të nxirret para Tribunalit të Hagës. Historia na jep, Zotërij, mësim të bollshme se nuk shkohet përpara duke shikuar prapa. Zotërij, faleminderit për angazhimin tuaj të pakursyer dhe konstruktiv. Ju njoftoj se në aeroportin e La Valetës janë të përgatitura të gjitha mjetet e nevojshme që të gjithë ne të udhëtojmë në mënyrë të sigurt në destinacionet e dëshiruara. Udhëtim të mbarë!...

SARANDË. 01.01. 2008